

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2024

Nr. Rendor	Data	Kerkesa	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	11.01.2024	Planin e masave të hartuar nga Ministria e Arsimit sa i përket përgatitjes për testimet ndërkombëtare si PISA e të ngjashme.	31.01.2024	Kthim përgjigje me shkresën nr. 815 prot., datë 31.01.2024 të ministrisë së Arsimit dhe Sportit.	Përfunduar	Jo
2	16.01.2024	Sa është numri i akteve ligjore që keni konsultuar me organizatat jofitimprëse gjatë vitit 2023? Kush kanë qenë format e konsultimit që keni përdorur? Sa është numri i OJF-ve që kanë marrë pjesë në këto konsultime? A ka institucioni juaj koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin. A ka institucioni juaj koordinator për shoqërinë civile? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin. A ka organe këshillimore që funksionojnë pranë institucionit tuaj? Nëse po listojini ato? A janë përfshirë përfaqësues të OJF-ve në organe këshillimore të institucionit tuaj? Nëse po sa është numri i OJF-ve të përfshira në to? Gjatë vitit 2023, a ka patur institucioni juaj grupe të përbashkëta pune me pjesëmarrjen e OJF-ve? Nëse po ju lutem përmendni. A është trajnuar stafi i institucionit tuaj mbi veprimtarinë përfunksionimin e OJF-ve? Nëse po sa punonjës janë trajnuar dhe nga kush? A afroh institucioni juaj licenca për shërbime që ofrohen nga OJF-të, specifikoni llojin dhe lojet e shërbimeve.	30.01.2024	Në vijim të kërkesës tuaj dërguar në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit në ministrinë e Arsimit dhe Sportit ju informojmë si më poshtë: Në përgjigje të pyetjes tuaj të parë ju bëjmë me dije se projektaktet e konsultuara me publikun gjatë vitit 2023 nga ministria e Arsimit dhe Sportit i gjeni në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike në linkun https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Institucioni/2 Metodat e përdorura të konsultimit janë konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik, RENJK, tryeza të konsultimit me ekspertë dhe grupet e interesit. Kontributet janë përcjellë në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektakteve, nga grupet e interesit dhe ekspertë të fushës dhe shkresa zyrtare si dhe në tryezat e konsultimit të zhvilluara kryesisht pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Lidhur me pyetjen 3 informojmë se kanë marrë pjesë në procesin e konsultimit publik të Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030, përfaqësues të biznesit, sindikatat dhe OJF të fushës, konkretisht nga Agjencia për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile, Qendra për Arsim Cilësor, Dhoma e Tregtisë Tiranë, Organizata Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë. Lidhur me pyetjen 4 informojmë se Koordinatorin për Njoftimin dhe konsultimin Publik është detyrim sipas ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit është znj. Nadire Pilavi me adresë nadire.pilavi@arsimi.gov.al . Gjithashtu ju bëjmë me dije se në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritet & Qeverisje të Hapur 2022-2024 OGP, Ministria e Arsimit dhe Sportit sipas kalendarit Teknik Metodologjik të procesit të hartimit të këtij plani organizoi përgjatë vitit 2023, takime me organizata të ndryshme të shoqërisë civile OSHC, të cilat kanë në fokus të veprimtarisë së	Përfunduar	Jo
3	18.01.2024	1.Sa kanë qenë shpenzimet e universiteteve për vitin akademik 2022-2023? 2.Sa kanë qenë shpenzimet e universiteteve për vitin akademik 2021-2022? 3.Sa kanë qenë shpenzimet e universiteteve për vitin akademik 2020-2021? 4.Sa para janë shpenzuar për kërkimin shkencor për vitin akademik 2022-2023? 5.Sa para janë shpenzuar për kërkimin shkencor për vitin akademik 2021-2022? 6.Sa para janë shpenzuar për kërkimin shkencor për vitin akademik 2020-2021?	22.02.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion në lidhje me shpenzimet e realizuara për periudhën 2020-2023, sqarojmë se në zbatim ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit vjetor të buxhetit, si dhe udhëzimeve të Ministrisë të Financave sqarojmë se fondet e buxhetit të shtetit për institucionet e arsimit të lartë shpërndahen në formën e grantit. Ky fond shpërndahet sipas kategorive të mëposhtme: - granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë; - granti i mësimdhënies; - granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese. Fondet publike miratohen, shpërndahen, rishpërdahen, monitorohen dhe realizohen për çdo vitit ushtrimor, kalendarik dhe jo sipas vitit akademik. Të dhënat financiare për fondet e shpenzuara në programin e arsimit të lartë 09450, si dhe programin e kërkimit shkencor 09770, për periudhën 2020 - 2023 gjenden të botuara në adresën https://financa.gov.al/buxheti-faktik-nder-vite/ ; si dhe në faqen zyrtare https://arsimi.gov.al/buxheti-dhe-financat/	Përfunduar	Jo

4	19.01.2024	<p>Statistikat e regjistrimeve të vitit akademik 2023-2024, të cilat përfshijnë programet e studimit, kuotat fillestare, nr. rendor fillestar të të regjistruarit të fundit, pikët, mesatarën e shkollës së mesme, mesatrën e maturës shtetërore, mesataren e VKM për secilin program studimi që ofrohet në IAL-të e vendit.</p>	30.01.2024	<p>Bazuar në nenin 3 të ligjit nr. 80/ 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, si dhe autonomi financiare dhe organizative. Në pikën 4 të nenit 3, të ligjit të sipërcituar, shprehet se IAL-të kanë të drejtë të caktojnë kriteret për pranimin e studentëve në programet e studimit, në përputhje me këtë ligj. Gjithashtu në pikën 1 të nenit 101, shprehet se institucionet e arsimit të lartë detyrohen të mbajnë në formë të shkruar regjistrin themeltar të studentëve, si dhe në nenin 102, në pikat 1 dhe 2, shprehet se IAL-të ruajnë të dhënat personale të studentëve bazuar në parimin e konfidencialitetit. Sa më sipër, duke qenë se, në kërkesën e depozituar në MAS kërkohet informacioni statistikor, mbi: studentët e regjistruar, kuotat, kriterin mesatare të pranimit, numrin rendor të të regjistruarve dhe mesataren e shkollës së mesme/maturës shtetërore, sqarojmë se duhet t’ua drejtoni kërkesën institucioneve të arsimit të lartë, si institucione përgjegjëse të cilat mbajnë regjistrin themeltar të studentëve. Gjithashtu ju bëjmë me dije se të dhëna statistikore në lidhje me regjistrimet në IAL mund të gjeni edhe në portalin U-Albania në rubrikën "statistika" https://ualbania.al/pages/statistika-regjistrime.html</p>	Përfunduar	Jo
5	07.02.2024	<p>Baza ligjore dhe nënligjore për arsimimin me kohë të pjesshme në arsimin parauniversitar (në arsimin bazë dhe në gjimnaz) në Shqipëri Situata aktuale në lidhje me ofrimin e arsimit bazë me kohë të pjesshme në institucionet e arsimit publik parauniversitar, sipas ZVAP-ve: Programet e ofruara grupet e synuara që përfitojnë (gjinia, rurale kundrejt urbane, situata social-ekonomike etj.). Nevojat për ndërhyrje në programet që mund të ofrohen (si kurse të përshepuara për aftësitë e buta, komunikimi etj.) për të lehtësuar hapat e edukimit për të rinjtë që kanë braktisur arsimin 9-vjeçar. dhe tani janë mjaft të rritur për ta ndjekur rregullisht.</p>	21.02.2024	Vënia në dispozicion e informacionit të kërkuar.	Përfunduar	Jo
6	08.02.2024	Informacion në lidhje me arsimimin dhe procesin e njohjes së diplomës për B.K.	15.02.2024	Vënia në dispozicion e informacionit të kërkuar.	Përfunduar	Jo
7	09.02.2024	<p>Cili është numri i shkollave 9-vjeçare në 61 bashki të vendit, për secilën bashki për vitet 2010-2023. Sa është numri i fëmijëve të regjistruar në shkollat 9-vjeçare shtetërore për secilën bashki të vendit për vitet 2010-2023. Cili është numri i shkollave 9 vjeçare private në 61 bashki të vendit, për secilën bashki për vitet 2010- 2023. Cili është numri i fëmijëve të regjistruar në shkollat 9-vjeçare private në 61 bashki të vendit për vitet 2010-2023.</p>	<p>Shkres nr. 1124/5 prot., datë 21.02.2024.</p>	<p>Të dhënat e kërkuara mund të gjenerohen nga vjetari statistikor, i cili është i publikuar në faqen zyrtare të MAS në linkun https://arsimi.gov.al/statistika-2/, si dhe në faqen zyrtare të Institutit të Statistikave (INSTAT) në linkun https://ëëë.instat.gov.al/al/publikime/librat/. Gjithashtu ju bëjmë me dije se të dhënat për vitin shkollor 2023-2024 janë ende në përpunim dhe do të publikohen së shpejti.</p>	Përfunduar	Jo
8	09.02.2024	<p>Cili është numri i çerdheve shtetërore në 61 bashki të vendit, për secilën bashki për vitet 2010-2023. Sa është numri i fëmijëve të regjistruar në çerdhet shtetërore për secilën bashki të vendit për vitet 2010-2023. Cili është numri i çerdheve private në 61 bashki të vendit, për secilën bashki për vitet 2010-2023. Cili është numri i nxënësve të regjistruar në çerdhet private në 61 bashki të vendit, për secilën bashki për vitet 2010-2023. Sa është numri i çerdheve të mbyllura sipas bashkive të vendit në 61 bashki të vendit, për secilën bashki për vitet 2010-2023. Sa është numri i kopshteve shtetërore në 61 bashki të vendit për secilën bashki për vitet 2010-2023. Sa është numri i kopshteve private në 61 bashki të vendit sipas secilës bashki për vitet 2010-2023. Sa është numri i nxënësve të regjistruar në kopshtet private në 61 bashki të vendit, për secilën bashki për vitet 2010-2023. Sa është numri i kopshteve të mbyllura për secilën bashki për vitet 2010-2023.</p>	<p>Shkres nr. 1124/6 prot., datë 21.02.2024.</p>	<p>Të dhënat e kërkuara nga pyetjet 1-5, gjenerohen nga institucionet e vetëqeverisjes vendore (bashkitë). Sa i përket të dhënave të kërkuara nga pyetjet 6-10, ju bëjmë me dije se mund të gjenerohen nga vjetari statistikor, i cili është i publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në linkun https://arsimi.gov.al/statistika-2/, si dhe nga publikimet në faqen zyrtare të Institutit të Statistikave (INSTAT), në linkun https://ëëë.instat.gov.al/al/publikime/librat/. Gjithashtu ju bëjmë me dije se të dhënat për vitin shkollor 2023-2024 janë ende në përpunim dhe do të publikohen së shpejti.</p>	Përfunduar	Jo

9	09.02.2024	<p>Cili është numri i shkollave të mesme të përgjithshme shtetërore në 61 bashki të vendit për secilën bashki për vitet 2010-2023. Sa është numri i fëmijëve të regjistruar në shkollat e mesme të përgjithshme për 61 bashki të vendit për secilën bashki për vitet 2010-2023. Cili është numri i shkollave të mesme të përgjithshme private në 61 bashki të vendit, për secilën bashki për vitet 2010-2023. Cili është numri i fëmijëve të regjistruar në shkollat e mesme të përgjithshme private në 61 bashki të vendit, për secilën bashki për vitet 2010-2023. Cili është numri i shkollave të mesme profesionale shtetërore në 61 bashki të vendit, për secilën bashki për vitet 2010-2023. Sa është numri i fëmijëve të regjistruar në shkollat e mesme profesionale shtetërore për 61 bashki të vendit, për secilën bashki, për vitet 2010-2023. Cili është numri i shkollave të mesme profesionale private në 61 bashki të vendit, për secilën bashki, për vitet 2010-2023. Cili është numri i fëmijëve të regjistruar në shkollat e mesme profesionale private në 61 bashki të vendit, për secilën bashki për vitet 2010-2023.</p>	<p>Shkres nr. 1124/7 prot., datë 21.02.2024.</p>	<p>Të dhënat e kërkuara nga pyetjet 5-8 gjenerohen nga Ministria e Financave. Sa i përket të dhënave të kërkuara nga pyetjet 1-4, ju bëjmë me dije se mund të gjenerohen nga vjetari statistikor, i cili është i publikuar në faqen zyrtare të MAS, në linkun https://arsimi.gov.al/statistika-2/. Gjithashtu të dhënat e kërkuara nga pyetjet 1-5, i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Institutit të Statistikave (INSTAT), në linkun https://ëëë.instat.gov.al/al/publikime/librat/. Të dhënat për vitin shkollor 2023-2024 janë ende në përpunim dhe do të publikohen së shpejti.</p>	Përfunduar	Jo
10	09.02.2024	<p>Cilat janë universitetet shtetërore në Republikën e Shqipërisë për vitet 2010-2023. Cili është numri i degëve të akredituara për secilin universitet publik për vitet 2010-2023. Cilat janë degët e mbyllura për secilin prej universiteteve publike për vitet 2010-2023. Cilat nga degët e hapura rishtazi pranë secilit universitet publik për vitet 2010-2023. Cili është numri i studentëve të regjistruar pranë secilit prej universiteteve publike për vitet 2010-2023. Cili është numri total/vjetor i studentëve të regjistruar për vitet 2010-2023.</p>	<p>Shkres nr. 1124/8 prot., datë 21.02.2024.</p>	<p>Të dhënat e kërkuara nga pyetjet 1, 5, 6, mund të gjenerohen nga vjetari statistikor, i cili është i publikuar në faqen zyrtare të MAS, në linkun https://arsimi.gov.al/statistika-2/. Gjithashtu të dhënat e kërkuara nga pyetjet 1, 5, 6, i gjeni të publikuara edhe në faqen zyrtare të Institutit të Statistikave (INSTAT), në linkun https://ëëë.instat.gov.al/al/publikime/librat/. Për vitin akademik 2023-2024 të dhënat janë ende në përpunim dhe do të publikohen së shpejti. Sa i përket pyetjeve 2-4, ju bëjmë me dije se të dhënat i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Referuar pyetjeve 7-9, ju bëjmë me dije se të dhënat e kërkuara i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në linkun: https://arsimi.gov.al/Buxheti dhe Financat.</p>	Përfunduar	Jo
11	09.02.2024	<p>Sa është numri i përgjithshëm i mësuesve për arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm në R.SH për vitet 2010-2023? Sa është rroga bruto dhe neto e mësuesve për arsimin 9-vjeçar në R.SH në fshat, për vitet 2010-2023? Sa është rroga bruto dhe neto e mësuesve për arsimin 9-vjeçar në R.SH në qytet, për vitet 2010-2023? Sa është rroga bruto dhe neto e mësuesve për arsimin e mesëm në R.SH në fshat, për vitet 2010-2023? Sa është rroga bruto dhe neto e mësuesve për arsimin e mesëm në R.SH në qytet, për vitet 2010-2023? Sa është pagesa për vështirësi pune për mësuesit që udhëtojnë në zonat rurale? Cili është numri i fëmijëve për të cilët ligji parashikon transport drejt/nga shkollat për distanca të largëta? Për sa prej tyre ofrohet ky shërbim në të gjithë Republikën e Shqipërisë.</p>	<p>Shkres nr. 1124/9 prot., datë 21.02.2024</p>	<p>Vënia në dispozicion e informacionit të kërkuar.</p>	Përfunduar	Jo

12	12.02.2024	<p>Kur ka nisur funksionimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) në sistemin shkollor?</p> <p>Sa ka kushtuar Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP)? Është kryer me buxhetin e shtetit apo me projekte ndërkombëtare? Ju lutem specifikoni kostot totale dhe koston e mirëmbajtjes së sistemit, prej funksionimit të tij deri më tani.</p> <p>A ka pasur trajnim të mësuesve dhe administratorëve të zyrave arsimore në vend, për përdorimin e këtij sistemi? Nëse po, sa mësues janë trajnuar dhe sa administratorë të zyrave arsimore në rang vendi? Ju lutem specifikoni numrin e mësuesve për secilin institucion shkollor.</p> <p>Sa institucione arsimore publike janë në Shqipëri? Sa prej tyre kanë kompjutera funksionalë? Ju lutem, specifikoni emrat e institucioneve arsimore publike të cilat nuk kanë kompjutera funksionalë.</p> <p>Sa prej institucioneve arsimore publike kanë qasje në internet? Interneti është i vendosur vetëm në një klasë/ambient apo aksesit është i mundur në të gjithë hapësirën e shkollës?</p> <p>A janë hasur problematika gjatë kësaj periudhe të përdorimit të sistemit SMIP? Cilat janë ato më kryesoret dhe si është punuar në këtë drejtim?</p>	01.03.2024	Vënia në dispozicion e informacionit të kërkuar. Pyetja nr. 2 deleguar AKSHI.	Përfunduar/Deleguar pjesërisht.	Jo
13	14.02.2024	Duke qenë në dijeni për lëvrinim e fondit grant për sportin, për çështje transparence për publikun dëshironim nëse mundeni të na vendosni në dispozicion të gazetës tabelën e plotë të shpërndarjes për çdo federatë.	27.02.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj ju bëjmë me dije se ndarja e fondit “Grand/transfertë korrente e brendshme” për Federatat Sportive Olimpikë, bëhet sipas udhëzimit nr. 4, datë 25.2.2022, të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për mënyrën e përdorimit të fondit “grant/transfertë korrente e brendshme” për Federatat Sportive Olimpikë, Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizatën Kombëtare Antidoping” ku janë parashikuar shprehimisht kriteret që aplikohen për përfitimin e fondeve dhe sistemi i pikëzimit për federatat olimpikë.</p> <p>Buxheti vjetor i miratuar për ministrinë përgjegjëse për sportin, i detajuar në gr. 11, titull 08140, artikull 604 “Transferta korrente e brendshme”, detajohet në llogarinë e përfituesve/federatave shqiptare sportive, Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizatës Kombëtare Antidoping. Për vitin 2024 ndarja e fondit “Grand/transfertë korrente e brendshme” për Federatat Sportive Olimpikë, është kryer bazuar në ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” dhe ju është përcjellë federatave sportive olimpikë përkatëse.</p> <p>Udhëzimi nr. 4, datë 25.2.2022, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë gjendet i aksesueshëm pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare në linkun https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2022/02/25/4/eb4f2311-f499-4887-9f25-33299ebfea42;</p>	Përfunduar	Jo
14	19.02.2024	nr. 386, datë 1.6.2022 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen	28.02.2024	Ministrave “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të	Përfunduar	Jo
15	20.02.2024	Emrin e personit që ka autorizimin për të përfaqësuar Ministrinë e Arsimit në këtë Këshillin Kombëtar të Psikologut.	26.02.2024	Vënia në dispozicion e informacionit të kërkuar.	Përfunduar	Jo
16	21.02.2024	Listën emërore të mësuesëve të gjimnazit “ Andon Zako Çajupi” , drejtuesve të shkollës , llojin e kontratës, lëndën që kanë dhënë për vitin shkollor 2022-2023 dhe për vitin shkollor 2023-2024. Gjithashtu edhe numrin e përgjithshëm të nxënësve që kanë nisur vitet shkollore 2022-2023 dhe 2023- 2024.	06.03.2024	Vënia në dispozicion e informacionit të kërkuar.	Përfunduar	Jo
17	23.02.2024	Jam i interesuar nëse figuron e regjistruar në regjistrin përkatës të universitetit Kristal diploma e shtetasës XX . Fakulteti Drejtësisë, përfunduar në vitin 2013. Ju lutem na pritje të një përgjigje	26.02.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju bëjmë me dije dokumentacioni i ish - SHLUPJ “Universiteti “Kristal”, nuk është më në administrimin e ministrisë së Arsimit dhe Sportit pasi është arkivuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, Tiranë. Sa më sipër, duhet t’i drejtoheni Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, Tiranë.	Përfunduar	Jo

18	26.02.2024	Sa titullare ka pasur institucioni ne periudhen 2019-2023 dhe ne cilat vite saktësisht kanë ndodhur ndërrimet?Sa është numri i punonjësve të larguar nga institucioni për periudhën 2019-2023?Si është raportu i vlerësimit të performancës të punonjësve të larguar në periudhën 2019-2023? Sa është numri i punonjësve që kanë pezulluar statusin dhe (nuk) janë rikthyer për periudhën 2019-2023? Nëse punonjësit nuk janë rikthyer në pozicionet e mëparshme në institucion, cilat janë arsytet? A keni program të dedikuar për punësimin e talentit në institucion? A i identifikon vetë institucioni talentet brenda organizatës? Nëse po, cilat janë kriteret që përdoren? Nëse jo, a është diskutuar ndonjëherë kjo çështje brenda institucionit?	25.03.2024	Vënia në dispozicion e informacionit të kërkuar.	Përfunduar	Jo	
19	28.02.2024	A është konsumuar i gjithë fondi?Nese po, a duhet të shtohet ky fond? Nese jo, sa % ka mbetur pa u përdorur dhe a duhet të rritet shuma e bursës në mënyrë që degët prioritare të bëhen më tërheqëse për studentët? Sa është numri në total i kuotave për bursa që janë miratuar? Sa kuota ka Universiteti i Tiranës dhe sa kuota kanë universitetet në rrethe? Cili është raportu i numrit të	21.03.2024	Vënia në dispozicion e informacionit të kërkuar.	Përfunduar	Jo	
20	04.03.2024	Sa mësues ka në të gjithë Shqipërinë? Sa nevoja për mësues ka arsimi parauniversitar në vend? Sa vende të lira ka aktualisht për mësues? Në cilat lëndë ka nevoja më urgjente për mësues? Ku kërkohen më shumë mësues, në shkollat 9-vjeçare po gjimnaze? Në cilat qytete, fshatra ka më shumë mungesa të mësuesve? *shifrat e ndara sipas vendit	21.03.2024	Për vitin shkollor 2023-2024 në sistemin arsimor parauniversitar publik dhe jopublik në të gjitha nivelet arsimore (arsimi parashkollor, arsimi bazë dhe arsimi i mesëm i lartë (pa profesionalin) janë 36.321 mësues.Në zbatim të udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021 ”Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit dhe të mësuesit në dispozicion nga një vend pune si dhe administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, të ndryshuar, çdo fillim muaj DRAP raporton në DPAP vendet vakante dhe punësimet e realizuara gjatë muajit. Në këto kushte sqarojmë se numri i vendeve vakante të mësuesve është fleksibël. Plotësimi i vendeve vakante kryhet sipas udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021 , të ndryshuar. Në përgjigje të pyetjes së tretë u bëjmë me dije se ka më nevojë për profilet e tilla si: “Arsim special” dhe “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”. Në arsimin 9-vjeçar kërkohen më shumë mësues, duke mbajtur në konsideratë dhe numrin më të lartë të nxënësve. Mungesat për mësues ndihen kryesisht në zona të thella malore si: Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar Tropojë, Bulqiza , Has, Skrapar dhe Dibër.	21.03.2024	Përfunduar	Jo
21	08.03.2024	Vazhdoj studimet per drejtesi ne universitetin shteteror te tetoves sipas sistemit 4+1. Ne perfundim te studimeve te ciklit te pare me kohezgjatje 4 vite me nje total prej 240 kredite pajisem me diplome bachelor. Cikli i dyte eshte me kohezgjatje 1 vit me nje total prej 60 kredite ku ne perfundim pajisem me diplome Master i Shkencave. Pra cikli i pare dhe i dyte kane nje total prej 300 kredite.Sipas legjislacionit shqiptar a me njihen ne Shqiperi diplomat e ciklit te pare dhe ciklit te dyte qe leshohen sipas sistemit 4+1 nga universiteti shteteror i tetoves.	07.03.2024	Deleguar Qendrës së Shërbimeve Arsimore	Deleguar/Përfunduar	Jo	
22	12.03.2024	Informacion lidhur me bazen ligjore dhe procedurat qe duhen ndjekur për të ndryshuar emrin e një insitucioni të arsimit të lartë (në sektorin privat). Do te doja të dija nëse ka një parashikim në një akt nënligjor që përshkruan në mënyrë më specifike dhe të detajuar mënyren se si ndryshohet emri. Po ashtu, cili është roli i Ministrisë në miratimin e ndryshimit të emrit, a përfundon procedura me miratimin nga ana e ministrise apo ka hapa të mëtejshëm për tu ndjekur?	03.04.2024	Në vijim të kërkesës tuaj sqarojmë se bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar parashikohet e drejta e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Për sa i përket kërkesës sqarojmë se parashikime në lidhje me emrin dhe stemën e institucioneve të arsimit të lartë i gjeni në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” që është i publikuar në Qendrën e Botimeve Zyrtare.	Përfunduar	Jo	
23	12.03.2024	Informacion në lidhje me njësimin e diplomës së ciklit të parë.	12.03.2024	Deleguar Qendrës së Shërbimeve Arsimore	Deleguar/Përfunduar	Jo	

24	18.03.2024	Sa i përhapur është dhe a e gjeni shqetësues si fenomen, shitjen e produkteve ushqimore nga ambulatë të ndryshëm pranë shkollave në kryeqytet? A ofrojnë të gjitha shkollat në kryeqytet dyqane apo ambiente të brendshme (menza) për konsumimin e ushqimit? Gjatë vitit kalendariq 01.01.2023-31.12.2023, sa raste helmimesh në shkolla janë konstatuar si pasojë e konsumimit të produkteve të tregtuara nga shitësit ambulatë jashtë rrethimit të shkollës përkatëse?	28.03.2024	<p>urdrin e përbashkët nr. 336, datë 14.07.2021 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për miratimin e rregullores “Për Standardet e ushqimit në mjediset e Institucioneve Arsimore Parauniversitare”, është miratuar rregullorja që ka për qëllim të sigurojë standardet më të larta të shëndetit të fëmijës, duke përcaktuar standardet e ushqimit në institucionet arsimore dhe duke siguruar bashkëpunim efektiv të institucioneve të ngarkuara nga legjislacioni në fuqi me detyra e përgjegjësi për zbatimin dhe kontrollin e përmbushjes së këtyre standardeve në mjediset e institucioneve arsimore.</p> <p>Stafet drejtuese dhe pedagogjike të shkollave në bashkëpunim me prindërit, komunitetin dhe njësitë e qeverisjes vendore kanë këshilluar dhe orientojnë në mënyrë periodike fëmijët mbi kujdesin shëndetësor duke iu referuar produkteve ushqimore të përshtatshme. Gjithashtu janë marrë masat e nevojshme për trajnimin e personelit arsimor dhe mbështetës për tu njohur me këto standarde dhe për të qënë sa më pranë fëmijëve për ndërgjegjësimin e tyre mbi pasojat që mund të shkaktojnë në organizëm kequshyerja dhe produktet që përmbajnë substancave të dëmshme ose të padobishme për shëndetin e fëmijëve .</p> <p>Institucionet arsimore në bashkëpunim me institucionet e strukturat e tjera zhvillojnë dhe zbatojnë veprimtari për ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe të prindërve për ushqyerjen e shëndetshme me qëllim angazhimin e të gjithë aktorëve për të ofruar standartet e nevojshme në institucionet arsimore që lidhen me konsumimin e ushqimeve në institucionet arsimore.</p> <p>Në ambientet e brendshme të institucioneve arsimore nuk ka dyqane që ofrojnë shërbim apo ambiente të veçanta për konsumimin e ushqimit.</p> <p>Në lidhje me pyetjen e tretë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit</p>	Përfunduar	Jo
25	18.03.2024	1. Numri i Shkollave Qendër Komunitare në Shqipëri; 2. Lista e Shkollave Qendër Komunitare në Tiranë; 3. Numri i përfituesve nga shërbimet e Shkollës Qendër Komunitare në Tiranë;	02.04.2024	Vënia në dispozicion e informacionit/dokumentacionit të kërkuar.	Përfunduar	Jo
26	26.03.2024	Vënie në dispozicion të udhrit të delegimit.	05.04.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije se urdhrat e delegimit të kompetencave bazuar në nenin 29 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” botohen në Fletoren Zyrtare. Sa më sipër, urdhrat e delegimit mund ti gjeni në Qendrën e Botimeve Zyrtare në linkun https://qbz.gov.al/eli/akte	Përfunduar	Jo
27	27.03.2024	Sa është numri i programeve ndërkombëtare të licencuara të universiteteve publike me universitete të huaja? - Sa prej tyre janë diploma të përbashkëta (joint degrees), sa janë të dyfishta si double-degrees? - Sa programe janë të akredituara? - Sa është numri i studenteve të huaj dhe studentëve shqiptarë që ndjekin këto programe? - Cilët janë këto programe dhe në cilat universitete? - Cila është strategjia e MASR për ndërkombëtarizimin e universiteteve publike, nëse ka një të tillë? - Sa është tarifa që paguan qeveria shqiptare për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin Erasmus+, Horizon Europe, Creative Europe, Digital Europe? - Sa është fondi i përfituar nga universitetet publike nga secili prej këtyre programeve? - Cilat janë lehtësitë që ofron kuadri ligjor për kërkuesit në universitete publike për t’u angazhuar në projekte ndërkombëtare? - Cilat janë planet dhe strategjitë e MASR për reformimin e kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit?	17.04.2024	Vënia në dispozicion e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar.	Përfunduar	Jo
28	28.03.2024	Lutem të dhëna mbi Programi Kombëtar të Praktikave të Punës nga thirrja e parë deri në Dhjetor 2023	11.04.2024/2 3.04.2024	V ënia në dispozicion e informacionit q ë disponon MAS	Përfunduar	Jo
29	29.03.2024	Kërkohet infomacion në lidhje me konkursin për nëndrejtor ZVAP Malësi e Madhe.	05.04.2024	Vënia në dispozicion e informacionit të kërkuar.	Përfunduar	Jo

30	03.04.2024	<p>Sa nxënës me Aftësi të Kufizuar në të gjithë vendin në shkollat publike trajtohen me mësues ndihmës të arsimit special?</p> <p>Sa është numri i nxënësve me Aftësi të Kufizuar aktualisht në të gjithë vendin që kanë nevojë për arsimit special?</p> <p>Deri në sa nxënës mund të mbulojë një mësues ndihmës i arsimit special?</p> <p>Sa vende të lira ka në institucionet arsimore publike për arsimit special, dhe ku janë nevojat më të mëdha?</p> <p>Prej sa kohësh është kjo kërkesë, dhe cilat janë arsytet që ka ende vakanca në institucionet arsimore për arsim special?</p> <p>Sa është numri i aplikimeve për arsimit special?</p> <p>Cilat janë kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët, dhe nga kush zgjidhen?</p>	18.04.2024	Vënien në dispozicion e informacionit të kërkuar.	Përfunduar	Jo
31	11.04.2024	Sondazhe dhe raporte të konsultimit publik.	23.04.2024	Vënien në dispozicion e informacionit dokumentacionit të kërkuar.	Përfunduar	Jo
32	16.04.2024	Kërkohe informacioni dhe dokumentacioni mbi njohjen e diplomës së një shtetasi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.	17.04.2024	<p>adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me anë të së cilës kërkohet informacioni dhe dokumentacioni mbi njohjen e diplomës së shtetasis S. Z nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, sqarojmë si më poshtë:</p> <p>Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar parashikon të drejtën e njohjes me informacionin publik. Gjithashtu sipas nenit 17 të ligjit nr. 119/2014, të ndryshuar parashikohet se e drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat që lidhen me të drejtën për një jetë private. Sipas nenit 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij. Bazuar në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar parashikohet se mbrojtja e të dhënave personale bazohet në përpunimin në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme. Të dhënat personale përpunohen vetëm nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin.</p> <p>Sa më sipër, sqarojmë se bazuar në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kufizimet e të drejtës së informimit, Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk mund të bëjë publike të dhëna personale të një personi pa marrë pëlqimin e tij.</p> <p>Në lidhje me procesin që lidhet me njohjen dhe njësimin e diplomave të asimit të lartë ju bëjmë me dije se procedurat parashikohen në udhëzimin nr. 21, datë 15.10.2021 i ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar”, të ndryshuar.</p>	Refuzuar dhënia e informacionit bazuar në shkronjën "a", të pikës 1, të ligjit 119/2014 të ndryshuar.	Jo

33	16.04.2024	Informacion për shkollat publike të cilat t'ë ulën në territorin e Republikës së Shqipërisë që janë potencialisht të segreguara më nënës Rom dhe Egjiptian, kërkoj gjithashtu të ndahet shkollat sipas bashkive në rënditje dhe në nënës ëve në këto shkolla.	17.04.2024	Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) bazuar në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021–2026, ka si qëllim ndërtimin e një sistemi arsimor cilësor, i cili trajton me sukses nevojat individuale të të gjithë fëmijëve, nxënësve e studentëve, duke i trajtuar ata në mënyrë të barabartë dhe me respekt, bazuar në diversitetin e tyre. Gjithëpërfshirja është parakusht i domosdoshëm për të siguruar zhvillimin e të gjithë individëve deri në potencialin e plotë të tyre dhe për të ngushtuar hendekun e arritjeve arsimore midis grupeve të ndryshme sociale. MAS nëpërmjet politikave të saj po punon fort për sigurimin e një arsimit parauniversitar cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë që krijon kushte që të gjithë nxënësit, pa asnjë dallim, të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera në pajtim me kërkesat e shoqërisë demokratike, të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës, si dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies vetjake dhe të shoqërisë. Për sa më sipër, ju informojmë se nuk ka dallime apo ndasi në shkolla lidhur me Romët dhe Egjiptianët. Fëmijët e këtyre pakicave/minoriteteve mësojnë në të njëjtat shkolla dhe ambiente si gjithë nxënësit e tjerë pa dallim etniciteti, race, ngjyre, niveli, etj.	Përfunduar	Jo
34	17.04.2024	Lista me emërtimet e 200 shkollave në gjithë vendin në të cilat u zhvillua procedura e konkurrencës për pozicionin drejtues në institucionet publike arsimore parauniversitare, bazuar në Udhëzimin nr.22, datë 13.11.2023, i ministrit të Arsimit dhe Sportit. Lista e emrave të drejtorëve të komanduar në 200 shkollat në gjithë vendin në të cilat u zhvillua procedura e konkurrencës për pozicionin drejtues në institucionet publike arsimore parauniversitare, bazuar në Udhëzimin nr.22, datë 13.11.2023, i ministrit të Arsimit dhe Sportit, të cilët ishin komanduar përpara se të emëroheshin drejtorët e shpallur fitues në përfundim të këtij procesi konkurrimi, duke specifikuar emrin e drejtorit të komanduar dhe shkollën ku ai ka qenë i komanduar. Lista e drejtuesve të shkollave të të arsimit parauniversitar të shpallur fitues në gjithë vendin në përfundim të procedurës së konkurrencës bazuar në Udhëzimin nr.22, datë 13.11.2023, i ministrit të Arsimit dhe Sportit, duke specifikuar emrin e drejtorit të shpallur fitues dhe shkollën ku ai është emëruar në mënyrë përfundimtare. Lista me emërtimet e shkollave në të gjithë vendin në të cilat është ndërprerë procedura e konkurrencës për pozicionin drejtues i institucionit publik arsimor parauniversitar, bazuar në Udhëzimin nr.22, datë 13.11.2023. Lista me emërtimet e shkollave të arsimit parauniversitar në të gjithë vendin në të cilat u zhvillua konkurrimi për pozicionin drejtues i institucionit publik arsimor parauniversitar, bazuar në Udhëzimin nr.22, datë 13.11.2023, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, në të cilat nuk ka pasur drejtor të komanduar përpara se të zhvillohej konkurrimi e të emërohej drejtori i shpallur fitues gjatë kësaj procedure. Numri i kandidatëve për pozicionin e drejtuesit në secilën prej shkollave të arsimit parauniversitar në të cilat u zhvilluar procedura e konkurrencës për pozicionin e drejtuesit.	09.05.2024 20.06.2024	Vënia në dispozicion e informacionit të kërkuar	Përfunduar	Jo
35	17.04.2024	Referuar shkrimit të doktoraturës së kandidatës znj. Juna Muça në fushën e Punës dhe Politikës Sociale, në Departamentin Punë dhe Politikë Sociale me temë “Vlerësimi i Nevojave Psikosociale të Punonjësve në Administratën Publike”, udhëhequr nga Prof.Dr. Edmond Dragoti, sqarojmë se kërkojmë nga ana juaj listën e e-maileve zyrtare të punonjësve që kanë statusin e nëpunësit civil dhe që janë pjesë e ministrive të linjës.	23.04.2024	Në vijim të kërkesës tuaj me anë të së cilës kërkonte listën e e-maileve zyrtare të punonjësve që kanë statusin e nëpunësit civil të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me qëllim realizimin e një pyetësi, ju bëjmë me dije se sipas rregullores nr.1 date 16.06.2023 të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit “Për përdorimin e postës elektronike në administratën publike” posta elektronike përdoret nga punonjësit vetëm për përbushjen e detyrave dhe është i ndaluar përdorimi i adresës së postës elektronike zyrtare për qëllime të tjera.	Përfunduar	Jo

36	18.04.2024	<p>Sa është numri I nxënësve të minoritetit rom dhe egjiptian të cilët janë regjistruar dhe sa prej tyre kanë përfunduar arsimin 9-vjeçar? Sa është numri I nxënësve të minoritetit rom dhe egjiptian të cilët janë regjistruar dhe sa prej tyre kanë përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm? Sa është numri i studentëve të minoritetit rom dhe egjiptian të cilët janë regjistruar dhe a prej tyre janë përfunduar arsimin e lartë të ciklit Bachelor? Sa është numri i studentëve të minoritetit rom dhe egjiptian të cilët janë regjistruar dhe sa prej tyre kanë përfunduar arsimin e lartë të ciklit Master?</p>	23.04.2024	<p>Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) bazuar në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021–2026, ka si qëllim ndërtimin e një sistemi arsimor cilësor, i cili trajton me sukses nevojat individuale të të gjithë fëmijëve, nxënësve e studentëve, duke i trajtuar ata në mënyrë të barabartë dhe me respekt, bazuar në diversitetin e tyre. Gjithëpërfshirja është parakusht i domosdoshëm për të siguruar zhvillimin e të gjithë individëve deri në potencialin e plotë të tyre dhe për të ngushtuar hendekun e arritjeve arsimore midis grupeve të ndryshme sociale. MAS nëpërmjet politikave të saj po punon fort për sigurimin e një arsimit parauniversitar cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë që krijon kushte që të gjithë nxënësit, pa asnjë dallim, të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera në pajtim me kërkesat e shoqërisë demokratike, të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës, si dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies vetjake dhe të shoqërisë. Për sa më sipër, ju informojmë se nuk ka dallime apo ndasi në shkolla lidhur me Romët dhe Egjiptianët. Fëmijët e këtyre pakicave/minoriteteve mësojnë në të njëjtat shkolla dhe ambiente si gjithë nxënësit e tjerë pa dallim etniciteti, race, ngjyre, niveli, etj.</p> <p>Gjithashtu sa i takon pyetjeve mbi fushën e arsimit të lartë ju informojmë se Ministria e Arsimit dhe Sportit mbledh, përpunon dhe raporton të dhënat statistikore bazuar në kalendarin statistikor, në zbatim të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare” dhe ligjit nr. 30/2022 “Për miratimin e programit të statistikave zyrtare 2022-2026”.</p> <p>Referuar programit të statistikave zyrtare 2022-2026, në listën e të dhënave për fushën e arsimit të lartë që kërkohen nga MAS për raportim, nuk mblidhen të dhëna të ndara vetëm për studentët romë dhe egjiptian por mblidhen në tërësi për të gjithë studentët pa bërë dallime.</p>	Përfunduar	Jo
37	18.04.2024	<p>Kërkoj informacion për një vendim të publikuar të Fletorja Zyrtare: Vendim, Nr.822, datë 28.12.2023, "Për financimin e Federatës Shqiptare të Futbollit, për mbështetjen e ekipit kombëtar të futbollit." Kërkoj informacion për dokumentacion justifikues të shpërndarjes së fondit sipas veprimtarisë për të cilën është përdorur ky fond.</p>	17.05.2024	<p>Vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.</p>	Përfunduar	Jo
38	19.04.2024	<p>Kam mbaruar studimet në degën Infermierë të Përgjithshme Master Shkencor në Tiranë. Për të tërhequr diplomën më duhet të mbroj një gjuhë të huaj. Nëse gjuhën e huaj (gjermanisht) e mbroj tek Götthe në Gjermani a më njihet në Shqipëri?</p>	23.04.2024	<p>Udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar parashikohet se dokumenti i njohjes së gjuhëve, mund të jetë një certifikatë, diplomë apo dëshmi, e lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për ofrimin e testeve ndërkombëtare.</p> <p>Subjektet që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale për ofrimin e testeve ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, certifikimet e të cilëve do të shërbejnë në përmbushjen e detyrimit ligjor, duhet të:</p> <p>Paraqesin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, dokumentacionin ligjor për të drejtën e pronësisë intelektuale dhe ofrimin e testeve ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, sipas procedurave dhe afateve kohore të publikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;</p> <p>Nënshkruajnë marrëveshjen me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me qëllim njohjen e të drejtës së subjektit për ofrimin e testeve, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, shkëmbimin e informacionit në lidhje me testimet ndërkombëtare, si dhe ofrimin e të dhënave për të gjithë kandidatët që aplikojnë në institucionet e arsimit të lartë për programet e studimit të ciklit të dytë apo të tretë.</p> <p>Certifikata, diploma apo dëshmia e lëshuar nga subjektet që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale për ofrimin e testeve ndërkombëtare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, njihen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, pas konfirmimit të secilit dokument nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që kanë nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për testin përkatës, sipas tabelës 1 bashkëngjitur këtij udhëzimi.</p>	Përfunduar	Jo

39	25.04.2024	<p>Kerkoj nje informacion ne lidhje me mbeshtetjen financiare te nxenesve te cilet jane vleresuar me medaljen e arte:</p> <p>1-A perfitojne financiarisht nxenesit me medalje te arte?</p> <p>2-Nga cili institucion duhet pere pagesa dhe ne cfare vlere ne qofte se perfitojne shperblim monetar?</p> <p>3-Ne qofte se nxenesi ka perfituar nje shperblim si fitues olimpiade apo si nxenesi me i mire i qarkut, a perfiton shperblim per fitimin e medaljes se arte?</p>	16.05.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije se sipas nenit 53 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar parashikohet se nxënësve të shkëlqyer në vite, pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, u jepet “Medalje e artë” nga Kryeministri, me propozimin e ministrit. Në udhëzimin nr. 21, datë 27.07.2022, të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për dhënien e Medaljes së artë nxënësve të shkëlqyer në vite, pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë”, përcaktohen kriteret dhe procedurat për dhënien e “Medaljes së artë”.</p> <p>Në lidhje me mbështetjen financiare sqarojmë se në legjislacionin e arsimit të lartë ka parashikime mbi mbështetjen financiare të studentëve të pranuar në vitin e parë akademik, në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve dhe programet e integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, bazuar në rezultatet nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë.</p>	Përfunduar	Jo
40	04.05.2024	<p>Çfarë politikash dhe programesh ka Ministria për të siguruar përfshirjen dhe mbështetjen e fëmijëve me aftësi të ndryshme në sistemin arsimor? Sa është numri i mësuesve aktuale që janë të profilizuar? Në sa shkolla shtetërore gjenden mësues të profilizuar për këto nxënës? Sa është numri i mësuesve në shkolla shtetërore për fëmijet me aftësi ndryshe? Si janë trajnuar dhe certifikuar mesuesit për të punuar me fëmijë me këto aftësi? Çfarë resurseve materiale dhe njerëzore disponon Ministria për të mbështetur nevojat e këtyre fëmijëve dhe mesuesve të tyre? Si monitoron Ministria efektivitetin dhe cilësinë e arsimit për fëmijët me aftësi të ndryshme? A ka programe ose inisiativa për përmirësimin e bashkëpunimit midis prindërve, mesuesve dhe specialistëve për të ofruar një mbështetje sa më të mirë për fëmijët me aftësi të ndryshme në ambientin shkollor?</p>	16.05.2024	Vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.	Përfunduar	Jo
41	06.05.2024	<p>Ju lutem mund te kem informacion se cili gjimnaz publik shtetëror i Bashkise Tirane mbulon shkollen 9-Vejcare "Konferenca e Pezes"</p>	08.05.2024	<p>Në zbatim të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, "Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenit 12 të Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, të miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 ju informojmë se nxënësit që mbarojnë klasën e 9-të në Institucionin Arsimit Publik Parauniversitar "Konferenca e Pezës" në Tiranë, kanë të drejtën të regjistrohen në klasën e 10-të në gjimnazin "Qemal Stafa" në Tiranë.</p>	Përfunduar	Jo

42	07.05.2024	A po vazhdon projekti "Bëjmë detyrat e shtëpisë" në 4 shkollat pilot në Tiranë? Projekti pilot, parashikonte që të zbatohet në 20 shkolla 9-vjeçare edhe në Korçë, Fier, Lezhë dhe Elbasan. A ka nisur zbatimin në rrethet e tjera? Nevoja për kujdes arsimor me orare më të gjata në tregun e biznesit dhe 'afterschool'. Sa kontrollë ka Ministria kundrejt këtyre strukturave? Keni një numër të saktë të institucioneve të tilla të hapura?	14.06.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, ju informojmë se: Për vitin shkollor 2023-2024, nisim "Bëjmë Detyrat e Shtëpisë" shtrihet në 189 institucione arsimore në rang vendi. Në përgjigje të pyetjes tuaj të tretë ju bëjmë me dije se me ndryshimet që janë bërë në vitin 2023, me ligjin nr.44/ 2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në nenin 42 është përcaktuar si më poshtë: "2.Licencimi i institucioneve private dhe institucioneve plotësuese private bëhet nëpërmjet institucionit përkatës të licencimit, sipas vendimit të ministrit..." Institucionet arsimore plotësuese, private, parauniversitare, licencohen nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit, sipas kriterëve dhe standardeve të përcaktuara. Institucionet arsimore private dhe institucionet arsimore plotësuese private, krijohen dhe funksionojnë sipas ligjit të sipërcituar, përveç rasteve kur ligji ka formulim të veçantë për institucionet arsimore publike si edhe akteve nënligjore të nxjerra në mënyrë specifike për to.Deri më sot, nga Qendra Kombëtare e Biznesit nuk është përcjellë asnjë kërkesë për licencim, për ushtrim veprimtarie, me këtë objekt. Aktualisht, kuadri nënligjor për kriteret dhe standardet e licencimit të institucioneve arsimore, dhe arsimore plotësuese është në proces rishikimi.	Përfunduar	Jo
43	13.05.2024	1. Sa është numri i nxenesve në shkollë me aftësi ndryshe (Autik, Do ën) ?(Numri i nxenesve të ndahet në qytete) 2. Sa është numri i mesuesve ndihmes aktualisht për këto fëmijë? 3. Sa mesues ndihmes duhen për çdo shkollë? 4. Sa është numri i nxenesve me aftësi ndryshe dhe mesuesve ndihmes në çdo shkollë? 5. Në cilat shkolla ka mungesa dhe sa janë këto mungesa?	25.05.2024	Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitarë ka vënë në dispozicion informacionin kërkuar.	Përfunduar	Jo
44	15.05.2024	Konfirmim në lidhje me njohjen e diplomës së një personi.	5.2024	Vënia në dispozicion të informacionit të kërkuar.	Përfunduar	Jo
45	16.05.2024	Sa është numri i pedagogëve me gradën Profesor Doktor në Shqipëri? Sa prej tyre e kanë marrë këtë gradë brenda vendit dhe sa prej tyre jashtë Shqipërisë? Cila është mënyra se si MAS konfirmon vlefshmërinë e titujve Prof. Dr të pedagogëve që marrin këto grada jashtë vendit? Cila është mënyra se si MAS konfirmon vlefshmërinë e titujve Prof. Dr të pedagogëve që marrin këto grada brenda vendit?	31.05.2024	dhe Sportit fillimisht ju bëjmë me dije se sipas ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" institucionet e arsimit të lartë japin titujt akademikë "Profesor" dhe "Profesor i asociuar". Diploma e Gradës shkencore "Doktor" lëshohet nga institucionet e arsimit të lartë në përfundim të studimeve të doktoratës. Për vitin akademik 2023-2024 në institucionet e arsimit të lartë (publik dhe jopublik), rezultojnë të angazhuar si më poshtë: 915 personel akademik (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme), me titullin akademik "Profesor". 3248 personel akademik (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme), me gradën shkencore "Doktor". Në lidhje me pyetjen e dytë nëse personeli akademik i institucioneve të arsimit të lartë e ka marrë gradën shkencore brenda vendit ose jashtë duhet t'i drejtoheni institucioneve përkatëse të arsimit të lartë që administrojnë dosjet e personelit. Në përgjigje të pyetjes 3 të kërkesës ju bëjmë me dije se sipas pikës 4 të nenit 92 të ligjit 80/2015 parashikohet se titujt e lëshuar jashtë vendit nga një institucion i huaj i arsimit të lartë njihen në Republikën e Shqipërisë, të barasvlershëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, përmes procedurës zyrtare të njohjes. Procedurat e njohjes së titujve akademikë të fituar jashtë vendit parashikohen në udhëzimin nr. 21, datë 15.10.2021 të ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara", të ndryshuar të cilin e gjeni të	Përfunduar	Jo

46	16.05.2024	<p>1. Në informacionet e bëra publike nga AKSHI rezultojnë se deri në datë 1.12.2023, janë impelmetuar në Shqipëri 100 smartlab, në kuadër të projekteve për rritjen e aftësive digjitale, që në moshë të hershme. Ne cilat shkolla janë vendosur këto 100 smartlab-e? Pra kërkoj në mënyrë të saktë, emrat e secilës shkollë. Më pas nisi faza e dytë e këtij projekti, siç u lajmërua publikisht, se Akshi në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, do të implementonin edhe 216 kalasa të tjera smartlab në 216 shkolla të tjera. Në çfarë faze është ky projekt? Cilat janë 216 shkollat të cilat do të përfitojnë një klasë smartlab? Kërkoj të disponoj të gjithë emrat e tyre dhe vendndodhjen e shkollave nëpër Shqipëri. Cila është kosto buxhetore e këtij projekti në total të dedikuara nga Ministria e Arsimit? Cila është kosto buxhetore përkatësisht fazës së parë dhe fazës së dytë, dedikuar nga Ministria e Arsimit? Konkretisht çfarë do të thotë një smartlab? Cfarë përfshihet në këto klasa? (cilat janë pajisjet)</p>	05.07.2024	Vënia në dispozicion e informacionit të kërkuar	Përfunduar	Jo
47	21.05.2024	Struktura Organizative/ Organigramën e re të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit; Vendet vakante të kategorisë së mesme drejtuese.	31.05.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije se në institucionin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit janë 7 vende vakante të nivelit të mesëm drejtues që janë dërguar për shpallje në DAP. Struktura dhe organika e MAS gjendet në linkun : https://arsimi.gov.al/transparenca-3/	Përfunduar	Jo
48	23.05.2023	<p>bazuar në vendimin nr. 673, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, të ndryshuar AKSHI administron çdo sistem dhe infrastrukturë hardëare dhe softëare në fushën TIK, për institucionet dhe organet e administratës buxhetore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, si dhe institucionet jobuxhetore për të cilat do të përdoren tarifa shërbimi.</p> <p>Programi i transparencës i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit përmban rubrikat sipas ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar dhe urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) “Për miratimin e Programit të Transparencës”, të ndryshuar.</p> <p>Në lidhje me përditësimin e programit të transparencës në vijim të monitorimit të kryer nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë vitit 2023 Ministria e Arsimit dhe Sportit ka marrë masa për përditësimet e kërkuara. Programi i transparencës është një program që ka nevojë për përditësim të vazhdueshëm në kuadër të ndryshimeve që ndodhin dhe do të vijojë përditësimi i këtij programi. Gjatë vitit 2023 në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit në MAS nuk ka pasur kërkesa nga qytetarë të cilët nuk kanë mundur të aksesojnë informacionet të cilat duhet të ishin online në programin e transparencës.</p> <p>Në lidhje me pyetjen e fundit nëse ekziston një raport periodik mbi performancën e programit të transparencës sqarojmë se autoriteti kompetent, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale harton raporte mbi zbatimin e së drejtës për informimit në Republikën e Shqipërisë, si dhe programet e transparencës. Këto raporte mund t'i gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit për të Drejtën e Informimit</p>	09.07.2024	<p>se bazuar në vendimin nr. 673, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, të ndryshuar AKSHI administron çdo sistem dhe infrastrukturë hardëare dhe softëare në fushën TIK, për institucionet dhe organet e administratës buxhetore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, si dhe institucionet jobuxhetore për të cilat do të përdoren tarifa shërbimi.</p> <p>Programi i transparencës i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit përmban rubrikat sipas ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar dhe urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) “Për miratimin e Programit të Transparencës”, të ndryshuar.</p> <p>Në lidhje me përditësimin e programit të transparencës në vijim të monitorimit të kryer nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë vitit 2023 Ministria e Arsimit dhe Sportit ka marrë masa për përditësimet e kërkuara. Programi i transparencës është një program që ka nevojë për përditësim të vazhdueshëm në kuadër të ndryshimeve që ndodhin dhe do të vijojë përditësimi i këtij programi. Gjatë vitit 2023 në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit në MAS nuk ka pasur kërkesa nga qytetarë të cilët nuk kanë mundur të aksesojnë informacionet të cilat duhet të ishin online në programin e transparencës.</p> <p>Në lidhje me pyetjen e fundit nëse ekziston një raport periodik mbi performancën e programit të transparencës sqarojmë se autoriteti kompetent, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale harton raporte mbi zbatimin e së drejtës për informimit në Republikën e Shqipërisë, si dhe programet e transparencës. Këto raporte mund t'i gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit për të Drejtën e Informimit</p>	Përfunduar	Jo

49	23.05.2024	<p>1. Sa është aktualisht numri i çerdheve dhe kopshteve private të licencuara në territorin e Bashkisë Tiranë? 2. A është kryer nga ana e institucionit tuaj kontroll në terren për të gjetur kopshte/çerdhe të hapura në kundërshtim me ligjin? Ju lutem, më vendosni në dispozicion ndonjë memo/raport apo dokument tjetër zyrtar që mund të jetë prodhuar në fund të këtyre aksioneve. 3. A keni një bilanc se sa të tilla keni gjetur në Bashkinë Tiranë, cilado qoftë periudha? 4. Cilat kanë qenë masat e marra ndaj këtyre subjekteve</p>	04.06.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion ju bëjme me dije se: Në lidhje me pyetjen e parë informacionin e kërkuar mund ta gjeni në linkun https://arsimi.gov.al/femijet/Femijet - Ministria e Arsimit dhe Sportit ARSIMI PARASHKOLLOR Edukimi parashkollor në Republikën e Shqipërisë është publik dhe privat. Procesi mësimor edukativ në arsimin parashkollor zhvillohet ... arsimi.gov.al Në përgjigje të pyetjes së dytë ju informojmë se në zbatim të urdhrir nr.631, datë 07.11.2023, të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit “Për ngritjen e grupeve të Punës Task-Forcë, për inspektimin e veprimtarisë së institucioneve arsimore parashkollore private (kopshte)”, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar ka organizuar punën për identifikimin e institucioneve arsimore parashkollore private (kopshte), që ushtrojnë veprimtarinë pa licencë, duke komunikuar zyrtarisht me: Njësitë Administrative, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Policinë e Shtetit, Inspektoriatin Qëndror, Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, me qëllim bashkëpunimin dhe mbështetjen për grupet Task-Forcë; Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe ZVAP-et për marrjen e masave mbi evidentimin e subjekteve private dhe kontrollin e zbatueshmërisë së përputshmërisë së aktivitetit të tyre me kërkesat ligjore dhe kushtet e licencave përkatëse, të cilët më pas kanë ngritur grupe pune dhe kanë monitoruar subjekte/kopshte në Durrës, Kavajë, Kamëz, Krujë, Vlorë, Elbasan, Fier, Lushnjë, Përmet, Peqin, Berat, Korçë, Pogradec, Kurbin, Malësi e Madhe dhe Lezhë. Për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë pa licencë DPAP përveç dënimit administrativ (kryesor dhe plotësues) që ka marrë ndaj subjekteve, dërguar shkresë zyrtare Drejtorive të Policisë Vendore për marrjen e masave të</p>	Përfunduar	Jo
50	4.6.2024	<p>Po ju shkruaj këtë email për të kërkuar ndihmën e fondeve të ekselencës, në mënyrë që të mund të ndjek studimet në këto institucione prestigjioze.</p>	14.6.2024	<p>Në vijim të kërkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije se: Me vendimin nr. 458, datë 29.6.2022 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (fondi i ekselencës)”, të ndryshuar janë shfuqizuar pikat 5 dhe 6 të vendimit nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar ku parashikohet: “5. Rregullat e hollësishme për afatet e aplikimit, të zbatimit të kriterëve e procedurave, për përcaktimin e masës dhe të mënyrës së financimit si dhe për numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni, për secilën nga bursat e parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, i cili miratohet brenda 30 ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. 6. Përzgjedhja e kandidateve kryhet para fillimit të vitit akademik, nga komisione përzgjedhëse të ngritura me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin. Komisioni përzgjedhës kryesohet nga ministri përgjegjës për arsimin ose nga personi i deleguar prej tij, në nivel zëvendësministri ose nëpunësi civil i nivelit të lartë drejtues. Kur Fondi i Ekselencës plotësohet edhe nga donacione, në komision ka të drejtë të marrë pjesë edhe një përfaqësues i donatorëve.” Në kushtet kur me vendimin nr. 458, datë 29.6.2022 të Këshillit të Ministrave janë shfuqizuar dispozitat e vendimit nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar që lidhen me aplikimin, nuk mund të aplikohet për të përfutur mbështetje financiare bazuar në këtë vendim.</p>	Përfunduar	Jo

51	4.6.2024	<p>1.Si funksionon skema e financimit të kartës së studentit?</p> <p>2. Listë me shërbimet e rimbursuara nga institucionet publike si pjesë e përfitimeve të kartës së studentit</p> <p>3. Buxheti i alokuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve për Kartën e Studentit nga viti 2019 deri në vitin 2024</p> <p>4. Sa është numri i studentëve të pajisur me Kartë Studenti për çdo qytet ku shtrihet karta e studentit?</p>	09.07.2024	<p>17.4.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”.</p> <p>Kategoritë e shërbimeve që përfitojnë studentët nëpërmjet kartës së studentit janë miratuar me vendimin nr. 226, datë 17.4.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, të cilin e gjeni të publikuar në Qendrën e Botimeve Zyrtare në linkun https://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/04/17/226/12ad54dd-346c-4682-8d8b-6d8118592979</p> <p>Në pikën 4 të këtij vendimi përcaktohet se “Në nivel vendor, marrëveshjet për ofrimin e shërbimeve me çmime të reduktuara për përfituesit e kartës së studentit nënshkruhen ndërmjet njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin. Efektet financiare nga reduktimi i çmimeve përballohen nga buxhetet e njësisë të vetëqeverisjes vendore.”.</p> <p>Ministria e Arsimit dhe Sportit ka nënshkruar marrëveshje për ofrimin e shërbimeve me çmime të reduktuara për përfituesit e kartës së studentit me 8 (tetë) Njësi të Vetëqeverisjes Vendore: Tiranë, Durrës, Shkodër, Korçë, Kamëz, Vlorë, Elbasan dhe Gjirokastrë. Lista e shërbimeve përcaktohet në Aneksin 1, Programi “Karta e Studentit”, të marrëveshjes së lidhur me këto NJQV.</p> <p>Sa i përket pyetjes nr. 3 të kërkesës sqarojmë se sipas vendimit nr. 226, datë 17.4.2019 të Këshillit të Ministrave efektet financiare nga reduktimi i çmimeve përballohen nga buxhetet e njësisë të vetëqeverisjes vendore.”.</p> <p>Qendra e Shërbimeve Arsimore ka nisur shkresë zyrtare drejt njësisë së vetëqeverisjes vendore listën me numrin e studentëve të matrikulluar.</p>	Përfunduar	Jo
52	4.6.2024	Kërkohen të dhëna statistikore lidhur me arsimin bazë dhe arsimin e lartë.	20.06.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije se të dhënat e kërkuara nga pyetjet 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9, 11, 12, 13, 14, 15, 16 i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Institutit të Statistikave (INSTAT), në linkun https://ëëë.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/arsimi/#tab1 . Ndërsa të dhënat për pyetjet 4 dhe 10 janë ende në përpunim.</p>	Përfunduar	Jo
53	6.6.2024	Bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, lutem të më informoni se sa është numri i fëmijëve që po trajtohen aktualisht pranë kopshteve dhe çerdheve private në bashkinë e Tiranës bazuar në raportimin periodik që ato bëjnë pranë drejtorisë rajonale arsimore përkatëse?	14.6.2024	<p>Në lidhje me pyetjen 17 nëse MAS ka bashkëpunuar me organizma të tjerë (organizata të shoqërisë civile, donatorë) për aplikimin e programeve mbështetëse për të rinjtë, sqarojmë se sipas vendimit nr. 524, datë 22.9.2021 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët” parashikohet se Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët harton, zhvillon dhe monitoron politikën, për bashkëpunimin me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë.</p>	Përfunduar	Jo
54	11.06.2024	Për arsye studimore, na duhet të komunikojmë me drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar të sistemit tuaj. Kemi tentuar të kontaktojmë drejtëpërdrejt me koordinatorët e informimit, por për fat të keq ka qënë i pamundur kontakti me ta. Në këto rrethana, do të çmonim ndihmesën tuaj në sigurimin e email-eve për personat e kontaktit si koordinatorë informimi ose, në pamundësi, jeni e lutur të përcillni kërkesat tona për informim në Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (Lezhë, Fier, Durrës, Korçë).	14.6.2024	<p>Kërkesat për informacion mund t'i drejtoni në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit në Agjencinë Kombëtare për Arsimin Parauniversitar (AKAP) dpaptirane@arsimi.gov.al dhe akilda.ndone@arsimi.gov.al ose në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit në MAS.</p>	Përfunduar	Jo
55	11.6.2024	<p>Numri i shkollave publike dhe private 9 vjeçare dhe gjimnaze</p> <p>Numrin e klasave përgatitore në shkollat e arsimit baze</p> <p>Listen emerore te detajuar te shkollave 9 vjecare ne te gjithë vendin sipas qytetit/fshatit</p> <p>Numri i klasave (mundësisht i detajuar për secilin nivel nga kl 1 në 12)</p> <p>Numri i mësuesve ne sistem nga klasa 1-12</p> <p>Numri i nxënësve (në total dhe sipas gjinisë) për secilin prej niveleve kl.1-12</p> <p>Numri I nxënësve të regjistruar sipas klasave të ndarë në grup mosha sipas qarqeve</p>	09.10.2024	Vënia në dispozicion e informacionit të kërkuar	Përfunduar	Jo

56	11.6.2024	Sa gjimnaze në Shqipëri, kanë gjermanishten si gjuhë të dytë” (të dhënat të ofruara me shifra konkrete dhe %). Sa nga këto gjimnaze janë shtetërore dhe publike	20.06.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije se janë 71 gjimnaze publike dhe jo publike (16% të totalit të gjimnazeve) në arsimin parauniversitar që kanë gjermanishten gjuhë të dytë për vitin shkollor 2023-2024. Nga këto janë 22 gjimnaze publike dhe 49 private.	Përfunduar	Jo
57	14.6.2024	Pershendetje doja te beja nje ankese ne lidhje me provimin e matures te shkolla mahir domi elbasan duke pare nivelin e te tjereve nuk mendoj se jam vleresuar me te drejte ju lutem kerkoj nga ana juaj rivleresim	20.06.2024	rregullores “Për zhvillimin e maturës shtetërore në Republikën e Shqipërisë” miratuar me urdhrin nr. 661, datë 1.12.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë parashikohet si më poshtë: Maturanti/kandidati ka të drejtë të kërkojë fotokopjen e testit, 1 (një) ditë pas shpalljes së rezultateve paraprake të të gjitha provimeve. Maturanti/kandidati pasi është pajisur me fotokopjen e testit, ka të drejtë ta paraqesë kërkesën për rivlerësim testi në KSHMSH-në e shkollës, ku është regjistruar si maturant, më datë 5 korrik. Fotokopjet e testeve të paraqitura në KSHMSH shqyrtohen nga dy mësues lëndor të përcaktuar nga KSHMSH-ja (nëse një shkollë nuk ka dy mësues të lëndës shqyrtimi do të bëhet vetëm nga një mësues i lëndës). Mësuesit e përcaktuar sipas pikës 3, të këtij neni, shqyrtojnë kërkesat e paraqitura nga maturantët/kandidatët vetëm për pyetjet e ankimuarra dhe vendosin nëse këto teste do t’i kalojnë për rivlerësim QSHA-së. KSHMSH-ja, kërkesat për rivlerësim të miratuara nga mësuesit lëndor, i përcjell në ZVAP në format elektronik, brenda datës 5 korrik dhe në format shkresor brenda datës 6 korrik. KMSH-ja në ZVAP, kërkesat e paraqitura nga KSHMSH-ja i përcjell në format elektronik në QSHA brenda datës 5 korrik, si dhe zyrtarisht në format shkresor, brenda datës 7 korrik. QSHA-ja kryen procesin e rivlerësimit të testeve, me të njëjtat rregulla e procedura si vlerësimi i testeve, duke i sekretuar me barkode testet që rivlerësohen. QSHA-ja kryen rivlerësimin e të gjithë testit. Pas rivlerësimit, vlerësimi përfundimtar i maturantit mund të jetë: me të njëjtin rezultat;	Përfunduar	Jo
58	14.6.2024	Dua te shikoj pergjigjet e sakta te provimit tim te gjuhes se huaj anglisht B2 Dua rivleresim te ri Me dergoni kopjen e provimit	20.06.2024	rregullores “Për zhvillimin e maturës shtetërore në Republikën e Shqipërisë” miratuar me urdhrin nr. 661, datë 1.12.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë parashikohet si më poshtë: Maturanti/kandidati ka të drejtë të kërkojë fotokopjen e testit, 1 (një) ditë pas shpalljes së rezultateve paraprake të të gjitha provimeve. Maturanti/kandidati pasi është pajisur me fotokopjen e testit, ka të drejtë ta paraqesë kërkesën për rivlerësim testi në KSHMSH-në e shkollës, ku është regjistruar si maturant, më datë 5 korrik. Fotokopjet e testeve të paraqitura në KSHMSH shqyrtohen nga dy mësues lëndor të përcaktuar nga KSHMSH-ja (nëse një shkollë nuk ka dy mësues të lëndës shqyrtimi do të bëhet vetëm nga një mësues i lëndës). Mësuesit e përcaktuar sipas pikës 3, të këtij neni, shqyrtojnë kërkesat e paraqitura nga maturantët/kandidatët vetëm për pyetjet e ankimuarra dhe vendosin nëse këto teste do t’i kalojnë për rivlerësim QSHA-së. KSHMSH-ja, kërkesat për rivlerësim të miratuara nga mësuesit lëndor, i përcjell në ZVAP në format elektronik, brenda datës 5 korrik dhe në format shkresor brenda datës 6 korrik. KMSH-ja në ZVAP, kërkesat e paraqitura nga KSHMSH-ja i përcjell në format elektronik në QSHA brenda datës 5 korrik, si dhe zyrtarisht në format shkresor, brenda datës 7 korrik. QSHA-ja kryen procesin e rivlerësimit të testeve, me të njëjtat rregulla e procedura si vlerësimi i testeve, duke i sekretuar me barkode testet që rivlerësohen. QSHA-ja kryen rivlerësimin e të gjithë testit. Pas rivlerësimit, vlerësimi përfundimtar i maturantit mund të jetë: me të njëjtin rezultat;	Përfunduar	Jo

59	18.6.2024	<p>Unë jam një qytetare italiane dhe do të doja të merrja informacion mbi procesin e njohjes (equipollencës) së diplomës sime të shkollës së mesme të bashkuar bujqësore "Andon Profka" në Seman.</p> <p>Aktualisht nuk kam në dispozicion dokumentet origjinale shqiptare. Do të doja të dija çfarë hapash duhet të ndjek dhe cilat dokumente alternative mund të paraqes për të përfunduar me sukses këtë proces.</p> <p>Do të isha shumë mirënjohëse për çdo informacion dhe udhëzime që mund të më ofroni.</p>	21.06.2024	<p>Në vijim të kërkesës tuaj të përcjellë në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ju bëjmë me dije se lidhur me procedurën për njohjen e diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit parauniversitarë në Republikën e Shqipërisë, jashtë vendit, duhet t'i autoriteteve përkatëse në shtetin ku do të njihni diplomën.</p>	Përfunduar	Jo
60	18.06.2024	<p>Ju lutem mund te me ndihmoni per nje syllabus nga universiteti Kristal.</p>	22.06.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj ju informojmë se për të marrë një kopje të vulosur të programit të studimit "Laborant Mjekësor" të ish-SHLUJP "Universiteti "Kristal", duhet që të përcillni kërkesë zyrtare pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të shoqëruar me kartën e identitetit dhe fotokopje të diplomës.</p>	Përfunduar	Jo
61	18.6.2024	<p>Kam mbaruar studimet e larta për Gjuhë -Letërsi në vitet 2004-2008 në universitetin e Histori -Filologji në Tiranë.Dua të aplikoj në platformën "Mësues për Greqinë".Më herët jam interesuar për të bërë licencën për degën e mësuesisë por në drejtorinë arsimore më thanë qe nuk është e nevojshme për ju.Ju lutem në aplikim qe dua të bëj si duhet të veproj duhet te brj check "me licence".</p>	21.06.2024	<p>Bazuar në ligjin nr.10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar sqarojmë se nëse e keni ushtruar profesionin e mësuesit para muajit janar 2011, nuk keni detyrimin për të dhënë provimin e licensimit.</p> <p>Për ta provuar këtë në platformën "Mësues për Greqinë", duhet të ngarkohet një vërtetim nga ZVAP ku keni punuar si mësuese e lëndës gjuhë shqipe dhe letërsi.</p>	Përfunduar	Jo
62	19.6.2024	<p>Kam filluar studimet per Drejtesi ne Universitetin Vitrina 2010-2014 kam jetuar jashte ne londer deri tani dhe nuk kam pasur mundesi ta terheq kartonin e diplomes mundet Ministria e Arsimit te me ndimoje se ku mund ta mare diplomen meqense Univeriteti Vitrina u eshte hequr. Licenca ne 2014 edhe a disponon nje liste Ministria e Arsimit</p>	21.06.2024	<p>Në vijim të kërkesës tuaj të përcjellë në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit, lidhur me tërheqjen e diplomës së lëshuar nga Shkolla e Lartë Private "Vitrina", sqarojmë si më poshtë:</p> <p>Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 539., datë 6.8.2014, Shkolla e Lartë Private "Vitrina" ka dorëzuar pranë MAS dosjet e studentëve si dhe të gjithë dokumentacionin ligjor, financiar dhe akademik që dispononte. Nga verifikimi që ju bë dosjeve të dorëzuara nga ky institucion nuk rezulton të jetë depozituar dosja e Selma Qemal Kozarja.</p> <p>Regjistrat e matricullimit dhe të notave të depozituara në MAS nga ish-Shkolla e Lartë Private "Vitrina" janë dorëzuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Suggjerojmë që t'i drejtoheni Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave për informacion të mëtejshëm.</p>	Përfunduar	Jo
63	20.06.2024	<p>Universiteti Shtetëror i Tetovës, Fakulteti Juridik ofron program studimi në ciklin e dytë të studimeve E drejtë Penale, kohëzgjatja 1 vit arsimor me 60 kredite. Në përfundim të studimeve Universiteti Shtetëror i Tetovës lëshon Diplomë të Ciklit të dytë të studimeve Master Shkencor 60 kredite me gradë Magjistër i të Drejtës Penale, shkalla e kualifikimit VII A, shkallë e cila sipas nivelit të kornizës europiane të kualifikimeve i korrespondon nivelit VII. Sipas ligjit të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë Diploma e ciklit të dytë të studimeve Master Shkencor ka 120 kredite me kohëzgjatje 2 vite ndërsa ajo që lëshohet nga Univeriteti Tetovës në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka 60 kredite me kohëzgjatje 1 vit, kjo sepse Maqedonia e Veriut sistemin e arsimit të lartë e ka 4+1, ku cikli i parë bachelor është 4 vite me 240 kredite ndërsa cikli i dytë master shkencor është 1 vit me 60 kredite. Pra në total janë 300 kredite.</p> <p>Për sa më sipër referuar legjisllacionit të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, që rregullojnë procesin e njohjes dhe njësimit të diplomave, që lëshohen nga institucionet e arsimit të lartë jashtë Republikës së Shqipërisë, Diploma e sipërcituar e ciklit të dytë të studimeve Master Shkencor më kohëzgjatje 1 vit me 60 kredite e lëshuar nga Universiteti Tetovës nga ana e Qendrës së Shërbimeve Arsimore do njësohet si Diplomë e Ciklit të Dytë Master Shkencor ashtu sikur se është shënuar tek diploma e lëshuar nga Universiteti Tetovës apo si Diplomë e Ciklit të Dytë Master Profesional apo si Diplomë e Ciklit të Dytë Master Ekzekutiv?</p>	21.06.2024	<p>Në vijim të kërkesës tuaj të përcjellë në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ju bëjmë me dije se:</p> <p>Bazuar në udhëzimin nr. 21, datë 15.10.2021 të ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara", të ndryshuar parashikohet se Qendra e Shërbimeve Arsimore është institucioni përgjegjës për njohjen e diplomave të programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve. Aplikimi kryhet on line nëpërmjet portalit e-Albania.</p> <p>Sa më sipër, lutemi që për kërkesën tuaj t'i drejtoheni Qendrës së Shërbimeve Arsimore si institucioni përgjegjës për njohjen e diplomave të programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve.</p>	Përfunduar	Jo

64	20.06.2024	A e ka kryer arsimin e mesëm qytetari A. H, i datëlindjes _____? Nëse po, në cilën shkollë dhe në cilat vite? Ju lutem na vini në dispozicion numrin e amzës dhe numrin e regjistrimit të veçantë të dëftesës së pjekurisë së këtij shtetasi.	09.07.2024	Në vijim të kërkesës suaj me anë të së cilës kërkohet informacioni: "A e ka kryer arsimin e mesëm qytetari A.H, i datëlindjes 17.10.1973? Nëse po, në cilën shkollë dhe në cilat vite? Ju lutem na vini në dispozicion numrin e amzës dhe numrin e regjistrimit të veçantë të dëftesës së pjekurisë së këtij shtetasi", ju bëjmë me dije si më poshtë: Amza e shkollës dhe regjistri i veçantë ku nënshkruajnë nxënësit që marrin dëftesën e arsimit bazë, certifikatën dhe diplomën e Maturës Shtetërore, janë dokumentacion me ruajtje të përhershme në arkivin e institucionit arsimor, prandaj për këto të dhëna duhet t'i drejtoheni institucionit arsimorë përkatës. Gjithashtu lidhur me të dhënat e databazës së Maturës Shtetërore (krijuar për herë të parë në vitin 2006) mund t'i drejtoheni Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Theksojmë se të dhënat që ju kërkoni janë të dhëna personale që trajtohen në kuadër të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar. Sipas këtij ligji parashikohet se mbrojtja e të dhënave personale bazohet në përpunimin në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme. Të dhënat personale përpunohen vetëm nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin. Gjithashtu në nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij. Sa më sipër, sqarojmë se përcjellja e të dhënave personale rreth personit bëhet me pëlqimin e tij	Përfunduar	Jo
65	20.06.2024	Jam e interesuar t vazhdoj studimet e larta ne Shqiperi,por nuk kam plotesuar formularin A1Z. Doja t dija nese, aplikimet per plotesimin e formularit A1Z per kete vit do hap perseri Apo Jo ?	03.07.2024	Ju bej me dije se do te kete raund aplikimesh me formularin A1/A1Z . Per datat konkrete, lutemi qendroni te perditesuar me faqen e QSHA.	Deleguar QSHA-së që i ka kthyer përgjigje kërkuesit, për dijeni MAS.	Jo
66	21.06.2024	Cilat ishin degët prioritare në universitetet publike të përcaktuara nga Ministria e Arsimit për vitin akademik 2023-2024? Sa studentë në total zgjodhen degët prioritare për vitin akademik 2023-2024? Sa ishte në total fondi i alokuar në mbështetje të studentëve që zgjodhën degët prioritare për vitin akademik 2023-2024? Sa prej studentëve që zgjodhën degët prioritare për vitin akademik 2023-2024 përfituan burs? Cilat ishin kriteret e vendosura që një student i vitit të parë Bachelor që zgjedh një degë prioritare duhet të plotësojë për të përfituar burs? Çfarë kriteresh duhet të plotësojë ky student për të përfituar burs në vitin e dytë akademik? Cila është arsyeja e vonësës së shpërndarjes së fondit për studentët që përfituan burs në vitin akademik 2023-2024? Si ka ndikuar kjo iniciativë në zgjedhjen e degëve prioritare nga studentët? A ka pasur një rritje të regjistrimeve në këto degë? A ka Ministria plane për të vazhduar me këtë politikë për bursat mujore në vitet e ardhshme? Nëse po, a do të ketë ndryshime në përzgjedhjen e degëve prioritare apo në kriteret e përfitimit të bursave?	08.07.2024	Ministrave "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë", të ndryshuar parashikohen fushat dhe programet e studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar në institucionet publike të arsimit të lartë. Vendimin e gjeni të publikuar në Qendrën e Botimeve Zyrtare në linkun https://qzb.gov.al/previeë/8206de24-a19d-4956-bdc6-63bb5575d410/cons/20230724 Rregullat e hollësishme për afatet e aplikimit, shqyrtimit dhe procedurat për përcaktimin e masës dhe të mënyrës së financimit përcaktohen në udhëzimin nr. 30, datë 4.11.2022 të ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të përcaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar", të ndryshuar. Fondi i miratuar për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe studentëve që ndjekin studimet në një program prioritar, për vitin akademik 2023-2024 është 150 milion lekë. Fondi i miratuar i ka kaluar çdo Insitucioni të Arsimit të Lartë të cilët e shpërndajnë te studentët përfitues. Në pikën 8 të udhëzimit nr. 30, datë 4.11.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të përcaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar", të ndryshuar parashikohet se: "8. Pas nënshkrimit të marrëveshjes trepalëshe, çdo muaj, institucioni publik i arsimit të lartë duhet të kryejë pagesën në llogarinë bankare të	Përfunduar	Jo

67	22.06.2024	Jam diplomuar ne Universitetin Aleksander Moisiu Durrës dhe pas kesaj jam martuar dhe kam ndryshuar mbiemrin. Jam interesuar prane sekretarise se Universitetit ne lidhje me diplomën time (duke qene se tani jetoj ne Gjermani) dhe nuk me kane dhene asnje informacion. Kjo gje nuk me jep mundesine qe te punoj ne nivelin e nje te diplomuari me diplome masteri dhe per mua perben shume problem.	08.07.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se sipas ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” diploma lëshohet nga institucioni i arsimit të lartë në përfundim të programit të studimit përkatës. Institucionet e arsimit të lartë nuk mund të lëshojnë dublikatë diplome, por mund të lëshojnë dokument të barasvlershëm me diplomën në formën e vërtetimit, i cili duhet të përmbajë emrin e institucionit që ka lëshuar diplomën, numrin e diplomës origjinale, datën e lëshimit të saj, ciklin dhe programin e studimit. Sa më sipër, sqarojmë se për t’u informuar në lidhje lëshimin e diplomës në përfundim të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave”, duhet t’i drejtoheni institucionit të arsimit të lartë, në rastin tuaj Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës.	Përfunduar	Jo
68	25.06.2024	Interesohem per vellan tim per tu rregjistruar serisht ne arsimin e larte . Ka qene i rregjistruar ne Universitetin e Buqesis Tirane dhe e ka nderprer si dege . Do te rregjistrohet ne nje Universitet tjeter cfare procedure duhet te ndjeke .	08.07.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj ju bëjmë me dije se duhet fillimisht të çregjistrohet nga programi i studimit në të cilin ka qenë i regjistruar duke u paraqitur pranë sekretarisë së institucionit përkatës. Më pas, për t’u regjistruar në një program studimi të ofruar nga një institucion tjetër i arsimit të lartë për vitin akademik 2024-2025, duhet të ndiqen procedurat e përcaktuara në udhëzimin nr. 12, datë 30.06.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë” të cilin e gjeni të publikuar në Qendrën e Botimeve Zyrtare në linkun https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2023/06/30/12/19c69ef9-f851-47cd-9a56-802e0560ba7f	Përfunduar	Jo
69	26.06.2024	Certifikatat per kurse profesionale te marra jasht Shqiperie psh si guzhinjer , berber, etj pasi jan paisur me vule apostile nga vendi i origjines , kujt institucioni duhet ti drejtoheni per tu njohur dhe per tu perdorur ne Shqiperi .	19.07.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se sipas vendimit nr. 30, datë 17.1.2024 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit” arsimit dhe formimi profesional janë në fushën e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Sa më sipër, lidhur me njohjen e kualifikimeve profesionale të përfituara jashtë vendit duhet t’i drejtoheni Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.	Përfunduar	Jo
70	26.06.2024	Jam e interesuar per kredite ne lidhje me mesuesit!Kam pare nje njoftim qe keni nxjerre kredi per 30 mesues!Kur fillojne aplikimet dhe cilat jane kushtet qe duhet te plotesohen?	17.07.2024	Informacionin e kërkuar e gjeni në linkun https://arsimi.gov.al/hapen-aplikimet-per-mesuesit-qe-mund-te-perfitojne-kredi-me-interes-0/	Përfunduar	Jo

71	27.06.2024	<p>Jam e interesuar te di nese nje studente qe perfundon ciklin e dyte te studimeve universitare dhe ka deshire qe te studioje per mesuesi si dege e dyte studimi</p> <p>Se pari, a mundet qe t'i njihen disa nga lendet e kryera gjate 5 viteve studime (bachelor+master shkencor) nese zgjedh profilin e mesuesise</p> <p>Se dyti, a mundet te mbeshtet me burse gjate viteve te studimit, duke qene se mesuesia hyn ne deget prioritare dhe plotesohet kriteri i ekselences</p>	04.07.2024	<p>me dije, se ndjekja e një programi të dytë studimi në institucionet publike të arsimit të lartë është e parashikuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Neni 85, pika 1, e këtij ligji ka përcaktuar se: “Individët, që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi të të njëjtit cikël. Në këtë rast, kandidatët përballojnë koston e plotë të studimeve. Nga ky rregull përjashtohen studentët e shkëlqyer. Në statutet e institucioneve të arsimit të lartë përcaktohen kriteret që duhen të plotësohen për t’u pranuar në një program të dytë studimi”.</p> <p>Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, institucionet publike të arsimit të lartë, të cilat ofrojnë programe në fushën e mësuesisë, mundësojnë ekuivalentim të pjesëve ose programeve të plota të studimit të marra në institucione të tjera të vendit. Si rregull, procedura e ekuivalentimit nis dhe realizohet përmes komisioneve të posaçme, të ngritura pranë departamenteve, të cilat shqyrtojnë rastet kur studenti kandidon për transferim të programit të studimit ose kur pranohet në një program të dytë studimi. Për më shumë informacion, ju mund të drejtoheni pranë institucioneve publike të arsimit të lartë, që ofrojnë programe në fushën e mësuesisë.</p> <p>Sa i takon programeve prioritare dhe mbështetjes studentore, ju informojmë se, kriteret për mbështetjen financiare studentore janë përcaktuar në Vendimin nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar. Sipas dispozitave përkatëse, kjo mbështetje mundësohet për program të parë studimi.</p>	Përfunduar	Jo
72	27.06.2024	<p>Marrëveshje financiare me donatorë të huaj ku Ministria e Arsimit dhe Sportit, ose institucionet e saj të varësisë, janë përfituese fondesh në formë granti.</p> <p>Marrëveshjet financiare ku Ministria e Arsimit dhe Sportit, është përfituese për hua zhvillimore për projekte në sektorët e kompetencës.</p> <p>Projektet me financim të huaj, ku Ministria e Arsimit dhe Sportit, ose institucionet në varësi të saj, janë partner ose lead partner.</p>	18.07.2024	Vënia në dispozicion e informacionit të kërkuar.	Përfunduar	Jo
73	30.06.2024	<p>Jam maturante nga Ulqini,kam përfunduar shkollën e mesme dhe jam e interesuar të regjistrohem në fakultetin e mjeksise së përgjithshme në Tiranë dhe më duhen me tepër informacione për procedurat e regjistrimit dhe provimive pranuese.Do të më ndihmonit shumë nëse do të ndanit disa informata.</p>	17.07.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, janë përcaktuara në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”. Në kreu V, të këtij udhëzimi parashikohen procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci. Afatet e procedurave (aplikim, shpallje fituesish, regjistrim, etj) janë përcaktuar në urdhrin e përbashkët të QSHA dhe RASH nr. 112, datë 05.07.2024 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2024-2025”.</p> <p>Për më shumë informacione mbi kriteret e pranimit në programet e studimit përkatëse drejtohuni institucionit të arsimit të lartë ku mendoni të ndiqni studimet.</p>	Përfunduar	Jo

74	01.07.2024	Informacion ne lidhje me proceduren e vules apostile e marre ne ministrine tuaj,vule per diplomen universitare bachelor me qellim aplikimin e vizes italiane per studimet universitare master ne qytetun e Genova. Eshte e mundur ju lutem te me jepni informacion nese kam akses te jem e pranishme ne ministrine tuaj me qellim marrjen e vules?	03.07.2024	Në vijim të kërkesës tuaj ju bëjmë me dije se bazuar në vendimin nr.134, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit”, të ndryshuar vërtetimi i dokumenteve bëhet nga institucioni që i ka lëshuar. Sa më sipër, sqarojmë se për dokumentet (diplomë,listë notash,suplement) kjo procedurë kryhet pranë sekretarisë së IAL që ka lëshuar këto dokumente	Përfunduar	Jo
75	02.07.2024	Kam nje problem me nje te afermin tim emrin qe nga lindja deri tani nuk e ka ndryshuar ndonjehere ne deftese ja kane shkruar ndryshe,i duhet nje vertetim notash per dokumenta ne greqi me emrin e saj si e ka ne certifikate lindje dhe personale te kohes se tanishme.	11.07.2024	Në vijim të kërkesës suaj, ju bëjmë me dije se për të marrë vërtetim mbi përfundimin e arsimit bazë (8 vjeçare) ose listë notash duhet t'i drejtoheni shkollës përkatëse.	Përfunduar	Jo
76	03.07.2024	Jam nje maturante qe jeton jasht Shqiperise dhe do doja te dija, nese eshte e mundur, si funksionon aplikimi ne nje universitet shqiptar, ngaqe nuk mund te apliloj ne U-Albania si maturanet e tjerë.	24.07.2024	Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, janë përcaktuar në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”. Në kreun VI të këtij udhëzimi parashikohen procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve me diplomë të huaj të shkollës së mesme në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e ciklit të parë të studimeve, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë. Afatet e procedurave (aplikim, shpallje fituesish, regjistrim, etj) janë përcaktuar në urdhrin e përbashkët të QSHA dhe RASH nr. 112, datë 05.07.2024 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2024-2025”. Bashkëlidhur gjeni udhëzimin e MAS nr. 12, datë 30.6.2023 dhe urdhrin e përbashkët QSHA-RASH nr. 112, datë 05.07.2024, të sipërcituar.	Përfunduar	Jo
77	03.07.2024	Kam qene ne shkollen Teknike-ekonomike Tirane nxenes NE periudhen 1989-1993.Kerkoj informacion SE si mund te marr nga shkolla teknike-ekonomike ne Tirane nje certificate diplomimi(pasi ajo qe kisha me Ka humbur) dhe Pasqyre e subjekteve dhe notave.Nese eshte e mundur te Di keto dokumenta a mund ti doënlod nga ealbania	04.07.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se amza e shkollës është dokumentacion me ruajtje të përhershme në arkivin e institucionit arsimor, prandaj për të marrë vërtetimin e kërkuar drejtohuni shkollës ku keni përfunduar studimet .	Përfunduar	Jo
78	03.07.2024	Pyetja ime është në lidhje me stazhin. A duhet të kryhet me patjetër në shkollë, apo mund të bëhet dhe në qendra kursesh ku certifikatat janë të aprovuara nga ministria e arsimit .	09.07.2024	Praktika profesionale është kusht dhe detyrim për t'u pranuar në provimin e licensimit për ushtrimin e profesionit të mësuesit. Praktika profesionale 3 mujore bëhet vetëm në shkollë, sipas përcaktimit nga Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, të cilat ju caktojnë edhe mësues mentor për të udhëhequr dhe mentoruar punën tuaj gjatë praktikës. Pra, praktika bëhet vetëm në shkollë dhe jo në qendra kursesh.	Përfunduar	Jo

79	04.07.2024	Jam nga Presheva.Tani kam mbaruar shkollen e mesme. Sigurisht qe tani duhet te filloj te mendoj per me tutje pra per fakultete apo universitet. Lexova pak dhe u informova rreth jush permes Google mirepo desha te marr ca informata.Une deri tani pra per kater vite kam qene nxenese e shkelqyer ne gjimnazin e larte permendur,desha te ju pyes se nese vendos te studioj tek ju pra ne Universitetin shteteror te Tiranes a me takon ndonje burse ne universitetin tuaj?Nese jo a mund te dij sa eshte pagesa e tere vitit?Si duhet te informohem per cdo gje?	16.07.2024	<p>Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, janë përcaktuar në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”.</p> <p>Në kreu V, të këtij udhëzimi parashikohen procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci.</p> <p>Afatet e procedurave (aplikim, shpallje fituesish, regjistrim, etj) janë përcaktuar në urdhrin e përbashkët të QSHA dhe RASH nr. 112, datë 05.07.2024 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2024-2025”.</p> <p>Për të marrë informacion mbi tarifën e studimit dhe bursat e ofruara, duhet t’i drejtoheni institucionit të arsimit të lartë ku synoni të aplikoni.</p> <p>Bashkëlidhur gjeni udhëzimin e MAS nr. 12, datë 30.6.2023 dhe urdhrin e përbashkët QSHA-RASH nr. 112, datë 05.07.2024, të sipërcituar.</p>	Përfunduar	Jo
80	04.07.2024	Kam mbaruar shkollen e mesme profesionale ne greqi. Doja te bej njohjen e diplomes ne Shqiperi dhe te vazhdoj studimet bachelor ne Shqiperi. Ju lutem mund te me udhezoni cfare dokumentacioni me duhet, ku duhet te bej aplikimin dhe sa kohe zgjat	08.07.2024	Deleguar Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Kthyer përgjigje nga QSHA me datë 11.07.2024.	Përfunduar	Jo
81	06.07.2024	Dua të shoh dëftesën e gjimnazit të vitit 2020 ose dëftesën e lirisimit se më duhet me patjetër.Ju lutem me ktheni përgjigje sa më shpejt.	11.07.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se për dëftesat duhet t’i drejtoheni shkollës ku keni përfunduar arsimin bazë dhe arsimin e mesëm. Në e-Albania mund të merrni vërtetim mbi notat e Maturës Shtetërore në shërbimin elektronik "Notat e provimeve të Maturës Shtetërore" https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=4432	Përfunduar	Jo
82	08.07.2024	Doja të dija nëse e kam të detyrueshme të futem ne provimin e informatizuar këtë vit pasi une e kam kryer ne vitin 2021?	15.07.2024	Nëse keni qenë pjesëmarrës në portalin e 2023, ju mund t’i mbartni pikët pavarësisht vitit kur e keni dhënë testimin e informatizuar.	Përfunduar	Jo
83	08.07.2024	Më nevojitet një vërtetim për jashtë shtetit që të vërtetoj që Universiteti Vitinat nuk ekziston me dhe është mbyllur dhe nuk mund të marrë nga ai universitet asnjë të dhënë.	09.07.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj me anë të së cilës kërkohet "... një vërtetim për jashtë shtetit që të vërtetoj që Universiteti Vitinat nuk ekziston më dhe është mbyllur dhe nuk mund të marrë nga ai universitet asnjë të dhënë", sqarojmë se Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk lëshon një vërtetim të tillë, por ju informojmë se: Me vendimin nr. 539, datë 06.08.2014, të Këshillit të Ministrave “Për heqjen e licencës disa institucioneve private të arsimit të lartë”, Shkollës së Lartë Private “Vitrina”, i është hequr licenca për të ushtruar aktivitetin si institucion i arsimit të lartë.	Përfunduar	Jo

84	08.07.2024	Sapo mbarova këtë vit për inxhinieri elektronike Bachelor dhe kam dëshirë të aplikoj për "Bachelor" tek Akademia e Sigurisë. Doja të dija nëse kam të njëjtën procedurë aplikimi si maturantët e tjerë nëpërmjet formularit A1Z dhe U-albania.	16.07.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, janë përcaktuara në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë".</p> <p>Për kandidatët të cilët synojnë të aplikojnë për pranim në kuota të veçanta të përcaktuara nga IAL-të për kategorinë e specifikuar në kërkesë (nëse janë parashikuar nga IAL), procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, janë përcaktuar në kreun IV të udhëzimit nr. 12, datë 30.6.2023, të sipërcituar.</p> <p>Afatet e procedurave (aplikim, shpallje fituesish, regjistrim, etj) janë përcaktuar në urdhrin e përbashkët të QSHA dhe RASH nr. 112, datë 05.07.2024 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2024-2025".</p> <p>Për më shumë informacione mbi kriteret e pranimit në programet e studimit përkatëse drejtohuni institucionit të arsimit të lartë.</p> <p>Bashkëlidhur gjeni udhëzimin e MAS nr. 12, datë 30.6.2023 dhe urdhrin e përbashkët QSHA-RASH nr. nr. 112, datë 05.07.2024, të sipërcituar.</p>	Përfunduar	Jo
85	09.07.2024	Jam në shtetë të shqiptare të maturuar në Maqedoni dhe dua të aplikoj për universitet në Tiranë këtë vit . Cfarë procedurash më duhet të ndjek për aplikim ?	11.07.2024	<p>Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, janë përcaktuar në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë".</p> <p>Afatet e procedurave (aplikim, shpallje fituesish, regjistrim, etj) janë përcaktuar në urdhrin e përbashkët të QSHA dhe RASH nr. 112, datë 05.07.2024 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2024-2025".</p> <p>Bashkëlidhur gjeni udhëzimin e MAS nr. 12, datë 30.6.2023 dhe urdhrin e përbashkët QSHA-RASH nr. 112, datë 05.07.2024, të sipërcituar.</p>	Përfunduar	Jo
86	09.07.2024	Jam e interesuar për të marrë pjesë në provimin e shtetit për licensën e mësuesit në degën gjuhë - letërsi shqipe dhe dëshiroja të dija ku mund të drejtohem për të ditur hapat që duhet të bëj, dokumentat që duhet të kem dhe datat kur zhvillohen?	11.07.2024	<p>Procedura për regjistrimin në provimin e shtetit të profesionit të rregulluar të mësuesit kryhet sipas rregullores "Për funksionimin e komisionit të provimit të shtetit dhe procedura të zhvillimit të provimit të shtetit" miratuar me urdhrin nr. 365, datë 28.12.2020 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2020/12/Urdher-nr-365-dt-28-12-2020-Miratimi-i-rregullores-se-provimit-te-shtetit.pdf</p> <p>Kandidati për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit aplikon online në portalin qeveritar e-Albania, për regjistrimin në provimet e shtetit. Aplikimi online për regjistrim kryhet deri në 4 (katër) javë para fillimit të sezonit të provimit të shtetit</p>	Përfunduar	Jo

				<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion në lidhje me hapjen e institucioneve arsimore parauniversitare private, të nivelit parashkollor si dhe çerdheve, ju bëjmë me dije se:</p> <p>Në bazë nenit 42, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është përcaktuar se, licencimi i institucioneve arsimore parauniversitare private (shkollë /kopesht) bëhet nëpërmjet institucionit përkatës të licencimit, sipas vendimit të ministrit. MAS ka në fushën e përgjegjësisë licencimin e institucioneve arsimore parauniversitare private, të llojit "kopsht" (mosha 3-6 vjeç), të cilat licencohen nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), në përputhje me kriteret dhe standradet e përcaktuara në ligjin nr.69/2012, i ndryshuar, dhe udhëzimin nr.15 datë 12.07.2013 "Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare", i ndryshuar, por nuk ka në fushën e përgjegjësisë licencimin e çerdheve private.</p>		
87	11.07.2024	Jam e interesuar per hapjen e nje institucioni arsmir parashkollor dhe cerdhe jopublike ! Dua te di rregullat per strukturen	26.07.2024		Përfunduar	Jo
88	12.07.2024	Ju lutem si duhet të veprojmë për të aplikuar në aplikacionin U-Albania.	16.07.2024	Afati për kryerjen e pagesës së aplikimit sipas urdhrin të përbashkët të QSHA dhe RASH nr. 112, datë 05.07.2024 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2024-2025” është deri në 29 korrik 2024. Për kryerjen e procedurave të aplikimit (shkarkimit të mandatit) referohuni manualeve në faqen e U-Albania dhe nëse konstaton problematika gjatë procedurave të aplikimit kontaktoni adresën elektronike të suportit support@rash.al .	Përfunduar	Jo
89	14.07.2024	<p>Jam i intereseuar për njësimin e diplomes se arsimit te larte ne stomatologji,te cilin e kam kryer ne Bukuresht.</p> <p>Shoh ne informacionin e vendosur ne dispozicion nga Ministria e Arsimit dhe kerkohet vula apostile ose legalizim nga vendi ku kam kryer studimet.</p> <p>Jam interesuar per kete ceshtje para se te largohesha nga Bukureshti dhe per studentet qe largoheshin dhe donin te ushtronin profesionin ne vende te tjera na eshte rekomanduar vertetimi nga Rektorati i fakultetit perkates,qe leshohet kundrejt nje pagese qe kryhej ne Rektorat dhe qe e posedoj momentalisht kete document.Ky document ka vule dhe numer leshimi qe verteton legjitimitetin e diplomes dhe me njej si student qe kam frekuentuar dhe qe jam I diplomuar ne fakultetin perkates.</p> <p>Pra a mund te kryej njehsimin e diplomes duke pasur kete vertetimi nga Rektorati I shkolles sime?Te cilin do te me duhet ta perkthej dhe noterizoj.</p> <p>A duhet te perkthej suplementin e diplomes ne momentin qe eshte vete I perkthyer I gjithi ne anglisht?</p>	15.07.2024	<p>Deleguar për trajtim QSHA-së. Kthyer përgjigje nga QSHA-ja me datë 15.07.2024 si më poshtë:</p> <p>Për diplomat e fituara në Rumani nuk ka nevojë që ato të pajisen me vullë apostile sepse Shqipëria ka marrëveshje të veçantë me Rumaninë për këtë çështje.</p> <p>Legjislacioni kërkon që ju të ngarkoni në portalin e-albania diplomën dhe listën e notave të përkthyer dhe noterizuara në Republikën e Shqipërisë, si dhe faturën që vërteton pagesën në favor të QSHA. Nëse keni edhe këtë dokument shtesë, përkthejeni dhe noterizojeni dhe ngarkojeni në portal.</p> <p>Informacionin e detajuar për njohjen dhe njësimin e diplomës e gjeni edhe në linkun më poshtë:</p> <p>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=853</p>	Përfunduar	Jo
90	15.07.2024	Kërkoj nga ana juaj nje mundesi per te aplikuar per formularin A1Z ose nje informacion nese do kete nje raund tjetër per te aplikuar.	15.07.2024	<p>Deleguar për trajtim QSHA-së. Kthyer përgjigje nga QSHA-ja me datë 15.07.2024 si më poshtë:</p> <p>Ju bëjmë me dije se do të kete raund ne vijim per aplikime me formularet A1/A1Z, me qellim qe t'ju jepet mundesia per aplikim ne IAL per vitin akademik 2024-2025.</p> <p>Qendroni te perdituesuar me faqen e QSHA per t'u informuar rreth dateve konkrete.</p>	Përfunduar	Jo

91	16.07.2024	<p>Interesohem për studimin e programit të Mjekësisë në Universitetin ëestern Balkans (ëBU) i regjistruar në Tiranë. Ky universitet shkruan se ka filluar aktivitetin në vitin akademik 2022-2023 duke ofruar një arsim tërësisht në gjuhën angleze.</p> <p>Interesohem nëse Universiteti ëestern Balkans (ëBU) është i akredituar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë.</p>	16.07.2024	<p>Institucionet e Arsimit të Lartë akreditohe me vendim të Bordit të Akreditimit, të Agjencisë së Sigurimit të Cilesisë në Arsimin e Lartë. Per me teper informacion mund të merrni nga faqja zyrtare e ASCAL mbi akreditimin e IAL-se që interesoheni, nga ku rezultojnë se me Vendim nr. Nr. 75, datë 19.04.2024 të Bordit të Akreditimit, "Për akreditimin e parë të institucionit të arsimit të lartë universiteti "ëestern Balkans", është vendosur:</p> <p>Vlerësimin përfundimtar POZITIV për institucionin e arsimit të lartë, Universiteti "ëestern Balkans", me rekomandimet sipas shtojcës së këtij vendimi.</p> <p>Akreditimin institucional të institucionit të arsimit të lartë, Universiteti "ëestern Balkans", me kohëzgjatjen prej 6 (gjashtë) vite.</p> <p>Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të institucionit është 18/04/2030.</p>	Përfunduar	Jo
92	17.07.2024	<p>Lutem më informoni se si mund të pajisem me programin mësimorë të arsimit të mesëm për efekt të njohjes së diplomës jashtë vendit.</p>	17.07.2024	<p>Deleguar për trajtim ASCAP.</p>	Përfunduar	Jo
93	17.07.2024	<p>Kam marrë tek Ascap programet e lendeve të gjimnazit për njohje diplome jashtë vendit.</p> <p>Ascac me shpjegon që është e nevojshme firma në Ministrinë e Arsimit para noterizimit dhe dergimit në Ministrinë e Jashtme.</p> <p>Mund të më ndihmoni si mund të bëj këtë përmes postës?</p>	18.07.2024	<p>Procedura e programeve duhet që programet e bera nga institucioni jone duhet të dërgohen për tu firmosur në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, pastaj duhen perkthyer dhe noterizuar dhe me pas të dërgohen për vule apostile në Ministrinë e Jashtme. Ju mund ta dërgoni dokumentacionin me postë sipas procedurës së mësipërme.</p>	Përfunduar	Jo
94	17.07.2024	<p>Nuk e kam marrë dot dëftesën e pjekurisë për shkak të provimit të matematikës, të cilin nuk e mora dot në kohë. Kur mund ta jap këtë provim sa më parë.</p>	19.07.2024	<p>Në bazë të urdhrit të përbashkët nr. 661, datë 01.12.2023 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë", neni 11, pika 7, kandidatët të cilët nuk kanë shlyer një prej provimeve të Maturës Shtetërore nuk pajisen me diplomë dhe certifikatën e Maturës Shtetërore, deri në shlyerjen e këtij detyrimi. Të gjithë kandidatët të cilët rezultojnë jo kalues në një ose më shumë provime të Maturës Shtetërore duhet të plotësojnë formularin A1Z, i cili plotësohet sipas një kalendari të miratuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore. Për sa më sipër, në momentin e shpalljes së datave nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, plotësimin e formularit A1Z pranë shkollës dhe vetëm në përfundim të këtij procesi mund të jepni provimin në lëndën e Matematikës të sesionit të dytë, të Maturës Shtetërore 2024. Lutem ndiqni faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore apo Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar për tu njohur me datat e fazës së aplikimeve për sesionin e dytë.</p>	Përfunduar	Jo

95	17.07.2024	Kërkesë për informacion lidhur me kriteret për ushtrimin e profesionit të mësuesit të edukimit fizik.	26.07.2024	<p>Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se sipas pikës 5, të nenit 57 të sipas ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar parashikohet se:</p> <p>“5. Mësuesi i arsimit fillor, i arsimit të mesëm të ulët dhe i arsimit të mesëm të lartë, mësuesi i shkollave të arsimit të orientuar, mësuesi i kulturës së përgjithshme në shkollat profesionale, mësuesi që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe mësuesi me diplomë të ngjashme ose të përafërt me diplomat në fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar ushtron profesionin pasi:</p> <p>a) të ketë kryer me sukses praktikën profesionale;</p> <p>b) të ketë kaluar me sukses provimin e shtetit në fushën e formimit të tij, siç parashikohet në ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.”</p> <p>Për t’u regjistruar për të dhënë provimin e shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit fillimisht duhet të keni kryer me sukses praktikën profesionale. Aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesisë bëhet nëpërmjet platformës së aplikimit online në e-Albania në datat e përcaktuara.</p>	Përfunduar	Jo
96	17.07.2024	Dua te bej nje kerkese per njohje diplome. Kam mbaruar bachelorin ne Univeristetin Kristal te Tiranës. Te lutem ku duhet te bej kerkesen dhe cfare dokumentash duhet te nis?	02.08.2024	<p>Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se sipas ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", procedurës zyrtare të njohjes i nënshtrohen diplomat fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit. Diplomat e lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë nuk i nënshtrohen procesit të njohjes në vendin tonë.</p>	Përfunduar	Jo
97	17.07.2024	Sa nxënës te komunitetit Rom dhe Egjiptian kane përfituar tekstet shkollore falas per vitin 2022 dhe 2023 ne te gjithë Shqiperine ?	02.08.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar ka përcjellë informacionin si më poshtë:</p> <p>Për vitin shkollor 2022-2023 kanë përfituar tekste falas 10960 nxënës rom dhe egjiptian.</p> <p>Për vitin shkollor 2023-2024 kanë përfituar tekste falas 10217 nxënës rom dhe egjiptian.</p>	Përfunduar	Jo
98	18.07.2024	A ka ekuivalence turke pas studimeve ne shqiperi apo eshte e nevojshme te besh provimin (STS)? A mund të marr informacion për ekuivalencën Türkiye?	23.07.2024	<p>Në vijim të kërkesës suaj të përcjellë në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ju bëjmë me dije se lidhur me procedurën për njohjen e diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, jashtë vendit, duhet t'i autoriteteve përkatëse në shtetin ku do të njihni diplomën.</p>	Përfunduar	Jo

99	18.07.2024	Te udhëzimi nr.12, datë 30.06.2024 te kreu i V, pika e 8 është i renditur dokumentacioni që duhet dorëzuar pranë IAL në momentin e aplikimit, ku ndër të tjera kërkohet edhe kopje e mandatpagesës. Duke u nisur nga kjo dëshirojmë të dijmë se ku mund të merret ose shkarkohet mandati i pagesës, pasi që disa studente nga Mali i Zi na kane pyetur lidhur me këtë çështje.	26.07.2024	<p>Në vijim të kërkesës suaj, ju bëjmë me dije se procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, janë përcaktuara në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”.</p> <p>Në kreun V të udhëzimit nr. 12, datë 30.6.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit parashikohen edhe procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë.</p> <p>Sipas pikës 5, të kreut V përcaktohet se kandidatët, përpara aplikimit, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për çdo program studimi, sipas përcaktimit të IAL-së, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në llogari të Institucionit të Arsimit të Lartë pranë të cilit aplikon. Sa më sipër, sqarojmë se pagesën e tarifës së aplikimit e kryejnë sipas përcaktimeve të Institucioneve të Arsimit të Lartë ku aplikojnë në datat e përcaktuara në urdhrin e përbashkët të QSHA dhe RASH nr. 112, datë 05.07.2024.</p>	Përfunduar	Jo
100	18.07.2024	Informacion lidhur me kohëzgjatjen e programit të studimit dhe mundësinë e aplikimit për të rifilluar studimet.	26.07.2024	<p>Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se sipas nenit 90 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se: Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.</p> <p>Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Ai u nënshtrohet kritereve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të institucionit pritës. Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të njësisë bazë të institucionit që pranon studentin, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e saj.</p> <p>Për më shumë informacione drejtohuni institucionit të arsimit të lartë ku keni ndjekur studimet.</p>	Përfunduar	Jo
101	19.07.2024	Doja te aplikoj per shkollë të lartë e kam kryer maturën në vitin 2015-2016. Por më kërkohet aplikimi i formularit A1z të cilin nuk e kam bërë për arsye që nuk isha informuar . Mund te me ndihmoni qe ta plotesoj tani dhe te kryej pagesen per aplikim per shkolle te lart .	22.07.2024	Deleguar QSHA-së. Kthim përgjigje nga QSHA-ja.	Përfunduar	Jo
102	19.07.2024	Kërkesë për informacion lidhur me plotësimin e formularit A1Z	22.07.2024	Deleguar QSHA-së. Kthim përgjigje nga QSHA-ja.	Përfunduar	Jo
103	22.07.2024	Doja te dija cilat Universitete publike dhe jo publike jane te akredituara nderkombetarisht.	23.07.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se informacionin lidhur me ak	Përfunduar	Jo

104	22.07.2024	Informacion lidhur me përjashtimin nga provimi i licencës për mësues.	26.07.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se bazuar në nenin 9, të ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar parashikohet se përjashtohet nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit: profesionisti që, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtron ose ka ushtruar një profesion të rregulluar; profesionisti, i cili fiton të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar jashtë Republikës së Shqipërisë, në përputhje me përcaktimet e Këshillit të Ministrave. Me ligjin nr.10 357, datë 16.12.2010 “Për një shtesë në ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë””, është parashikuar profesioni i mësuesit si profesion e rregulluar. Nëse e keni ushtruar profesionin e mësuesit në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji ose para hyrjes në fuqi të këtij ligji përjashtoheni nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit.	Përfunduar	Jo
105	22.07.2024	Kam bere aplikimi ne e albania tek Mësues per Shqipërine por gabimisht nuk kam ngarkuar diplomën dhe listën e notave të Bachelor, do më duhet të paraqitem fizikisht tek Drap Durres apo ka nje adrese specifike ku mund të dergoj me email?	01.08.2024	Kthim pergjigje nga AKAP. Ankimi bëhet nepermjet sistemit. Për të ankimuar, ju duhet të shkoni në "Historiku i aplikimeve" në e-albania.	Përfunduar	Jo
106	23.07.2024	Kam nevojë për një informacion më të detajuar. 9 muajt e praktikës profesionale konsiderohen si vit pune ju lutem?	26.06.2024	Deleguar AKAP.	Përfunduar	Jo
107	23.7.2024	Kerkoj te me informoni ne lidhje me procesin e kredise per blerje banese?	02.08.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju lutem referohuni në linkun https://arsimi.gov.al/hapen-aplikimet-per-mesuesit-qe-mund-te-perfitojne-kredi-me-interes-0/	Përfunduar	Jo
108	24.07.2024	Jam i interesuar per te ditur ne ate qe duhet te beje per te pasur mundesi te jap mesim per lenden e Edukimit Fizik ne shkolle.	02.08.2024	69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar lidhur me ushtrimin e profesionit të mësuesit parashikohet se: "3. Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët dhe për arsimin e mesëm të lartë duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë “Bachelor” në fushën/lëndët e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë dhe diplomën e ciklit të dytë “Master” me 120 ECTS në fushën e mësuesisë, që lidhet me programin e studimit të ciklit të parë. 4. Profesionin e mësuesit mund të ushtrohet edhe nga individë që zotërojnë diplomë universitare të ciklit të parë dhe të dytë ose diplomë universitare të integruar, të ngjashme ose të përafërt me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar, dhe njohuri të certifikuar në formimin psikopedagogjik nga institucione të arsimit të lartë, që ofrojnë programe të studimeve të formimit të vazhduar. Diplomat e njëvlershme, diplomat e ngjashme ose të përafërta me diplomat e sipërpërmendura të këtij neni në fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psikopedagogjike përcaktohen me udhëzime të ministrit. 5. Mësuesi i arsimit fillor, i arsimit të mesëm të ulët dhe i arsimit të mesëm të lartë, mësuesi i shkollave të arsimit të orientuar, mësuesi i kulturës së përgjithshme në shkollat profesionale, mësuesi që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe mësuesi me diplomë të ngjashme ose të përafërt me diplomat në fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar ushtron profesionin pasi: a) të ketë kryer me sukses praktikën profesionale; b) të ketë kaluar me sukses provimin e shtetit në fushën e formimit të tij, siç parashikohet në ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e	Përfunduar	Jo
109	24.07.2024	Ju lutem kam nevojë për një informacion, lidhur me nevojën ose jo të vulosjes së Diplomes Bachelor para apostilimit për aplikime për Master jashtë vendit. A është një procedurë që kryhet nga Ministria juaj? Nëse po ku duhet të drejtohem?	25.07.2024	Në vijim të kërkesës tuaj ju bëjmë me dije se duhet t'i drejtoheni Institucionit të Arsimit të Lartë që ju ka lëshuar diplomën.	Përfunduar	Jo
110	25.07.2024	Informacion lidhur me mandatin pagesën për licencim të institucionit arsimor parashkollor, të llojit kopsht	02.08.2024	Bashkëlidhur do të gjeni mandatin pagesën për licencim të institucionit arsimor parashkollor, të llojit kopsht. Paga kryhet për llogari të MAS dhe depozitohet në QKB për tu pajisur me licencë.	Përfunduar	Jo

111	26.07.2024	Sa është numri i mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi ndryshe. Në cilat shkolla ka mungesa dhe sa janë këto mungesa.	02.08.2024	arsimin parauniversitar (përfshirë arsimin parauniversitar) është 2187, për vitin shkollor 2023-2024. Sipas të dhënave nga Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar nuk rezultojnë të ketë mungesa në shkolla për mësues ndihmës, pasi në mungesë të mësuesve të arsimit special, ZVAP ka vijuar me procedurat e punësimit sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021 "Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit dhe të mësuesit në dispozicion nga një vend pune si dhe administrimin e portalit "Mësues për	Përfunduar	Jo
112	26.07.2024	Kërkesë për informacion lidhur me procedurën e njësimit të diplomës.	29.07.2024	Deleguar QSHA-së.	Përfunduar	Jo
113	26.07.2024	Kërkesë lidhur me pagat për punonjësit arsimor jo mësimdhënës siç janë sekretaret e gjimnazeve.	02.08.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj ju bëjmë se dije se pagat e për pozicionet "Sekretar shkolle në shkollat e arsimit të mesëm të lartë" dhe "Sekretar shkolle në shkollat e arsimit bazë" parashikohen në vendimin nr. 326, datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", të ndryshuar, në Kreun II/1.	Përfunduar	Jo
114	27.07.2024	Kam aplikuar për nostrifikimin e diplomes online dhe desha që të di a është e mundur të përpëjtohet si proces apo ne të kundërtën të më lëshohet një vërtetim që është në proces nostrifikimi që të kem mundësi të aplikoj në një konkurs pune .	29.07.2024	Deleguar QSHA-së.	Përfunduar	Jo
115	28.07.2024	A dispononi modele modulesh ose kurrikulash sipas standardeve të AKPA që përdoren për aplikim për licencimin e një qendre kursesh profesionale? Nëse po, vendosjen në dispozicion të modeleve.	02.08.2024	Deleguar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit si institucioni që ka në fushën e përgjegjësisë shtetërore arsimin dhe formimin profesional	Përfunduar	Jo
116	29.07.2024	Si mund të pajisem me një dokument lidhur me akreditimin e programit të studimit që kam ndjekur.	30.07.2024	Deleguar ASCAL dhe kthyer përgjigje nga ASCAL.	Përfunduar	Jo
117	30.07.2024	Ku mund të adresohem për një interpretim diplome se kujt cikli i perkase?	16.08.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se, për të konfirmuar/verifikuar	Përfunduar	Jo
118	31.07.2024	Informacion mbi procedurën që duhet ndjekur për tu pajisur me leshimin e dokumentit të doktoratës nga MAS.	12.08.2024	Në lidhje me kërkesën tuaj ju bëjmë me dije se Ministria e Arsimit dhe Sportit lëshon vërtetimin për gradën shkencore "Doktor" referuar regjistrin	Përfunduar	Jo

119	30.07.2024	Jam nje studente kam mbaruar gjimnazin këtë vit me mesatare 6.46 dhe nuk mund te shkoj ne universitet. A mund të bëhet ndonjë gjë për të vijuar studimet.	02.08.2024	80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Bazuar në vendimin nr. 436, datë 3.6.2020 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, të ndryshuar parashikohet se kanë të drejtë të aplikojnë për t’u pranuar në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020–2021 dhe në vijim , përkatësisht, si më poshtë: a) Në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, kandidatët, që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë, minimalisht me notë mesatare 6.5 (gjashhtë pikë pesë); b) Në programet e studimit të gjuhëve të huaja, të përcaktuara në shtojcën nr. 1 të këtij vendimi, minimalisht me notë mesatare 7 (shtatë); c) Në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë, të përcaktuara në shtojcën nr. 2, të këtij vendimi, minimalisht me notë mesatare 7.5 (shtatë pikë pesë). Gjithashtu ju bëjmë me dije se sipas pikës 3 të vendimit nr. 436, datë 3.6.2020, të ndryshuar përjashtohen nga detyrimi i plotësimit të kriterit të notës mesatare kandidatët që aplikojnë për t’u pranuar në programet e	Përfunduar	Jo
120	01.08.2024	Kam bërë aplikimin ne e albania tek "Mësues për Shqipërinë", por gabimisht nuk kam ngarkuar diplomën dhe listën e notave të Bachelor, do me duhet të paraqitem fizikisht tek Drap Durres apo ka një adresë specifike ku mund të dërgoj me email?	01.08.2024	Deleguar për trajtim AKAP.	Përfunduar	Jo
121	01.08.2024	Informacion lidhur me kuotat dhe procedurat për transferim në programin e studimit “Mjekësi e Përgjithshme” Universiteti ëestern Balkan.	16.08.2024	Në lidhje me kërkesën e parashtruar ju informojmë se: Me vendimin nr. 1, datë 11.03.2024 të Senatit Akademik, Universiteti "ëestern Balkans", ka kërkuar 2 kuota pranimi, për kategorinë 'transferime', në programin e integruar të ciklit të dytë të studimeve (PIND) në "Mjekësi" (anglisht), të cilat janë certifikuar nga MAS me raportin nr. 3881/1 prot., datë 17.07.2024, "Mbi verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimit në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara nga Universiteti "ëestern Balkans", për vitin akademik 2024-2025." Gjithashtu, sjellim në vëmendje se, referuar urdhrit të përbashket të RASH dhe QSHA nr. 112, datë 05.07.2024, në pikën 1, të kreut IV, shtojca nr. 1, përcaktohet se, kandidati që kërkon të ndjekë studimet në një program të dytë studimi apo të transferojë studimet, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, ka të drejtë të aplikojë deri në 5 programe studimi pranë instiucioneve të arsimit të lartë, në datat 02-03 shtator 2024.	Përfunduar	Jo
122	02.08.2024	Informacion lidhur me adresën elektronike të ZVAP Shkodër dhe gjimnazit "Jordan Misja" Shkodër.	02.08.2024	Deleguar për trajtim AKAP dhe DRAP Lezhë.	Përfunduar	Jo
123	05.08.2024	Kam mbaruar studimet e larta në Universitetin Aleksandër Xhuvani, Elbasan ,duke qenë se jetoj në Itali me dua që të më njihen diplomat atje. Cilat janë procedurat që duhet të ndjek se i kam noterizuar (para 6 viteve në pamundësi kthimi në shqipëri ndalova aty) të gjitha diplomat dhe programin lëndor e kam tërhequr pranë universitetit dhe do doja të dija duhet ri noterizoj përsëri.	12.08.2024	Në vijim të kërkesës suaj të përcjellë në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ju bëjmë me dije se lidhur me procedurën dhe dokumentacionin për njohjen e diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit lartë në Republikën e Shqipërisë, jashtë vendit, duhet t'i autoriteteve përkatëse në shtetin ku do të njihni diplomën.	Përfunduar	Jo

124	05.08.2024	<p>Si procedohet për njësimin e diplomës së maturës italiane në Shqipëri? Kam marrë vulën apostile në shtetin italian, i kam përkthyer e noterizuar në Shqipëri, por nuk kam informacion për fazat pasardhëse. Duhet të paraqitem në ministri që të bëj konvertimin?</p> <p>Pasi në portalin e-Albania nuk thuhet asnjë informacion për maturën e ndjekur jashtë.</p>	16.08.2024	<p>Më poshtë gjeni informacionin e përcjellë nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucioni përgjegjës për njohjen e diplomave të arsimit të mesëm.</p> <p>Qytetarja shkruan për njësimin e diplomës së shkollës së mesme italiane. Po e nisim të plotë informacionin, pavarësisht se zonja shkruan që e ka marrë vulën apostile dhe ka bërë noterizimin dhe përkthimin në Shqipëri. Duhet të dërgojë me postë normale të gjithë dokumentet e shkollës së mesme:</p> <ul style="list-style-type: none"> •Diplomën. •Certifikatën e provimeve të maturës, ku të jenë shkruar pikët që keni fituar për çdo provim dhe pikët maksimale të parashikuara atë vit shkollor për çdo provim, •Dëftesat e të gjithë viteve shkollorë që ka kryer. <p>Dokumentet nuk duhet të jenë origjinale. Secili dokument duhet të ketë vulë apostile nga vendi ku është kryer shkolla, të noterizohet dhe përkthehet në Shqipëri, duke u shoqëruar me vërtetimin njësisia me origjinalin dhe me vërtetim përkthimi.</p> <p>Në faqen tonë zyrtare: ëëë.qsha.gov.al gjendet informacioni i duhur.</p> <p>Aty ndodhet një formular që duhet ta plotësohet dhe të bashkëngjitet me dokumentet e tjerë, si dhe një fotokopje të dokumentit tuaj ID.Të gjithë këto do t'i nisni me postë normale në adresën: Qendra e Shërbimeve Arsimore, Bulevardi "Zhan D'Ark", nr. 23, Tiranë. Shërbimi është falas për shkollën e mesme.</p>	Përfunduar	Jo
125	06.08.2024	<p>Kam përfunduar studimet e Masterit Shkencor për Mësuesi të Gjuhës Angleze për Arsimin e Mesëm të Lartë në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. Këtë vit po interesohem për të kryer praktikën profesionale në një shkollë 9-vjeçare në Elbasan. Dua të di nëse përbën problem për licencën që do e kryej praktikën në një shkollë 9-vjeçare, duke qenë se kam përfunduar Master Shkencor për Arsimin e Mesëm të Lartë. A do të konsiderohet kjo praktike e vlefshme dhe relevante për procesin e licencimit? Gjithashtu, dëshiroj të di se si do të jetë emërtimi i licencës sime pas përfundimit të praktikës. A do të emërtohet licenca që unë duhet të jap mësim në shkollë 9-vjeçare për shkak të praktikës sime atje, apo do të emërtohet që unë duhet të jap mësim në arsim të mesëm të lartë, siç kam përfunduar Masterin?</p>	22.08.2024	<p>Deleguar dhe kthim pergjigje AKAP. .Në pergjigje të kërkesës ju bëjmë me dije se në rast se plotësoni kriteret e pikës 1 të nenit 4 të urdhërit të MAS nr.100, datë 25.02.2022 “Për miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe zhvillimin e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”, ju mund të zhvilloni praktikën profesionale në çdo institucion arsimor të arsimit parauniversitar që ofron kryerjen e praktikës dhe që është nën juridiksionin e ZVAP që i përket vendbanimit tuaj.</p>	Përfunduar	Jo
126	13.08.2024	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i nxënësve të regjistruar në shkollë në Republikën e Shqipërisë për secilën klasë, nga klasa I deri në klasën IX, për vitin shkollor 2023-2024; 2. Numri i shkollave 9-vjeçare (publike dhe private) në secilin qark të vendit, në Republikën e Shqipërisë; 3. Numri i mësuesve në të gjitha shkollat e sistemit arsimor 9-vjeçar në Republikën e Shqipërisë për vitin shkollor 2023-2024; 4. Emrat e teksteve shkollore, që përdoren për lëndën e gjuhës angleze, të të gjitha klasat ku bëhet kjo lëndë, në shkollat 9-vjeçare publike të Republikës së Shqipërisë, së bashku me emrat e shtëpive botuese përkatëse, që i ofrojnë këto tekste. 	16.08.2024	<p>Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se të dhënat e kërkuara nga pyetjet 1, 2 dhe 3 i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Institutit të Statistikave (INSTAT), në linkun https://ëëë.instat.gov.al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/arsimi/#tab1</p> <p>Lidhur me pyetjen nr. 4 ju bëjmë me dije se tekstet shkollore që përdoren në shkolla janë të përcaktuara në urdhrin nr. 193, date 20.04.2023 i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në linkun https://arsimi.gov.al/urdher-nr-193-date-20-04-2023-per-perzgjedhjen-shperndarjen-dhe-shitjen-e-teksteve-shkollore-te-klasave-1-2-3-6-7-10-11-12-te-sistemit-arsimor-parauniversitar-per-vitin-shkollor-2023-2024/</p>	Përfunduar	Jo

127	13.08.2024	<p>Çfarë do të ndodh me studentët e mjekësisë që janë aktualisht, apo ata të cilët vijnë për herë të parë në vitin akademik 2024-2025? A do të firmosin studentët kontratën e parashikuar nga ligji para nisjes së vitit të ri akademik? Viti i ri akademik do të funksionojë për të pesta vitet, pa implementimin e këtij ligji? Në çfarë faze diskutimi është Ministria e Arsimit për miratimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore? Dhe kur parashikoni që të hyjë në funksionim ligji? Ndryshimet dhe afatet e përcaktuara do të jenë të njëjta me draftin e hedhur për konsultim publik më 30 prill, konsultimet e të cilit janë mbyllur më 29 maj? Nëse ka ndryshime, cilat janë ato? Kur do të dorëzohet ligji në Kuvend?</p>	17.09.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj ju bëjmë me dije si më poshtë: Në vendimin nr. 1, datë 25.1.2024 të Gjykatës Kushtetuese (botuar në Fletoren Zyrtare nr. 40, datë 04.03.2024) është vendosur detyrimi i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë që të miratojë ndryshimet e nevojshme ligjore mbi ligjin nr. 60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e përgjithshme’” . Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kanë hartuar dokumentacionin për ndryshimet në ligjin nr. 60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e përgjithshme’” dhe ia kanë përcjellë Kuvendit, si institucioni i ngarkuar me zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, për vlerësim dhe ndjekje të procedurave të mëtejshme për miratimin e këtij projektakti. Sa më sipër, aktualisht projektligji është në shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.</p>	Përfunduar	Jo
128	14.08.2024	<p>Kam bër njesimin e diplomes se dua te studio n Shqiperi edhe tani dua te aplikoj per universitet , si mundem ?</p>	19.08.2024	<p>Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, janë përcaktuar në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”. Afatet e procedurave (aplikim, shpallje fituesish, regjistrim, etj) janë përcaktuar në urdhrin e përbashkët të QSHA dhe RASH nr. 112, datë 05.07.2024 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2024-2025”. Bashkëlidhur gjeni udhëzimin e MAS nr. 12, datë 30.6.2023 dhe urdhrin e përbashkët QSHA-RASH nr. 112, datë 05.07.2024, të sipërcituar.</p>	Përfunduar	Jo
129	16.08.2024	<p>Kam mbaruar shkollën 9 vjeçare “24 Maji” Vlorë në vitin 2004 -2013. Kërkoj nga ministria e arsimit të pajisem me një vërtetim që kam përfunduar vitin shkollor 2012-2013 (klasën e 9</p>	19.08.2024	<p>Në vijim të kërkesës suaj, ju bëjmë me dije se për të marrë vërtetim mbi përfundimin e arsimit bazë duhet t'i drejtoheni shkollës që keni ndjekur</p>	Përfunduar	Jo
130	16.08.2024	<p>Cfare i dergoni per te njesuar diplomat studenteve jashte Republikes se Shqiperise kur universiteti eshte mbyllur.</p>	20.08.2024	<p>Në vijim të kërkesës suaj të përcjellë në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ju bëjmë me dije se lidhur me procedurën dhe dokumentacionin për njohjen e diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, jashtë vendit, duhet t'i autoriteteve përkatëse në shtetin ku do të njihni diplomën.</p>	Përfunduar	Jo
131	16.08.2024	<p>Kam mbaruar Bachelorin per sociologji dhe Master Profesional ne Psikologji shkollore. Ku duhet te aplikoj per tu punesuar ne shkolla.</p>	20.08.2024	<p>Kthyer përgjigje nga AKAP që duhet të ndiqni shpalljen e procedurave të konkurimit të punonjësve të shërbimit psikosocial nga DRAP dhe të aplikoni për konkurrim. Theksojmë që duhet të jeni pajisur dhe me licencë.</p>	Përfunduar	Jo
132	17.08.2024	<p>Jam me studime në degën “Teknik Imazherie” në Kosovë tek Kolegji AAB mbarova vitin e dytë dhe për vitin e tretë dua të transferohem në Tiranë. Desha të pyes çfarë dokumentash duhen për të bërë transferimin ?</p>	20.08.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se: Procedurat e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e ciklit të parë të studimeve, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë parashikohen në kreun IV të udhëzimit nr. 12, datë 30.6.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”. Afatet e procedurave janë përcaktuar në urdhrin e përbashkët të QSHA dhe RASH nr. 112, datë 05.07.2024 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2024-2025”. Bashkëlidhur gjeni udhëzimin e MAS nr. 12, datë 30.6.2023 dhe urdhrin e përbashkët QSHA-RASH nr. 112, datë 05.07.2024, të sipërcituar.</p>	Përfunduar	Jo

133	20.08.2024	A mund te perkthehet 1 Diplome Gjermane e nivelit te 4 ne shqip ? Nese po cilat procedura duhet te ndjek ?	20.08.2024	Deleguar QSHA-së.	Përfunduar	Jo
134	20.08.2024	A mund të më tregoni se cila është procedura e regjistrimit në universitetet e shqipërisë për kandidatët nga Mali i Zi. Apo të paktën ndonjë informacion i cili do të na ndihmojë në këtë drejtim.	20.08.2024	Në vijim të kërkesës suaj, ju bëjmë me dije se procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, janë të përcaktuara në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”. Në kreun V të udhëzimit nr. 12, datë 30.6.2023 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit parashikohen edhe procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë. Afatet e procedurave janë përcaktuar në urdhrin e përbashkët të QSHA dhe RASH nr. 112, datë 05.07.2024 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2024-2025”, (kreu V, shtojca nr.1). Bashkëlidhur gjeni udhëzimin e MAS nr. 12, datë 30.6.2023 dhe urdhrin e përbashkët QSHA-RASH nr. 112, datë 05.07.2024, të sipërcituar.	Përfunduar	Jo
135	21.08.2024	Une kam mbaruar nje shkolle te larte dhe dua te nis nje tjetër por nuk di si te veproj. Me ndihmoni dot me procesin qe duhet te ndjek?	23.08.2024	Në vijim të kërkesës suaj, ju bëjmë me dije se procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, janë të përcaktuara në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”. Në kreun IV (pika 8 e në vijim) të udhëzimit nr. 12, datë 30.6.2023 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit parashikohen edhe procedurat e pranimit dhe regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për program të dytë studimi. Afatet e procedurave janë përcaktuar në urdhrin e përbashkët të QSHA dhe RASH nr. 112, datë 05.07.2024 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2024-2025”. Për më shumë informacione duhet t’i drejtoheni institucionit të arsimit të lartë ku do të aplikoni. Bashkëlidhur gjeni udhëzimin e MAS nr. 12, datë 30.6.2023 dhe urdhrin e përbashkët QSHA-RASH nr. 112, datë 05.07.2024, të sipërcituar.	Përfunduar	Jo
136	21.08.2024	Gjatë viteve 2007-2009 kam ndjekur shkollën te Medicom në degën e Farmacis. Për arsye të jashtme lindi nevoja qe ta nderprisja frekuentimin e mësimit më gjatë në atë periudhë. Në 2012 kam dhënë provimin e fundit dhe kam marrë diplomën si Ndihmës Farmaciste. Duke qenë se tani jetoj jashtë vendit dhe do doja të konvertoja mësimin e marrë në Shqipëri. Shkolla që une kam ndjekur është mbyllur dhe mua me duhet një dokument mbështetës në lidhje me orët dhe praktiken e bërë dhe kurrikulën që kam ndjekur. Do ju lutesha të më ndihmoni nëse mund ta gjeja këtë informacion pranë zyrave tuaja.	17.09.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se për t’u pajisur me një kopje të programit të studimit “Teknik Farmacist”, në ish-Kolegjin Profesional Privat “Medicom”, duhet t’i drejtoheni Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me një kërkesë zyrtare shoqëruar me fotokopjen e kartës së identitetit.	Përfunduar	Jo

137	22.08.2024	<p>Informacion mbi kuotat per vazhdimin e fakultetit te dyte kryesisht ate te Universitetit te Mjekesise ne degen Mjekesi e Pergjithshme.</p> <p>Une dua te informohem mbi:</p> <p>1-Numrin e kuotave per vazhdimin e fakultetit te dyte per vitin akademik 2024-2025 ne degen Mjekesi e pergjithshme prane Universitetit te Mjekesise?</p> <p>2-Te informohem paraprakisht per datat e aplikimit dhe dorezimit te dosjes?</p> <p>3-Te informohem mbi dokumentet qe duhen per te plotesuar dosjen, menyren e vleresimit, kriteret qe duhen per tu bere pjese e konkurimit</p>	17.09.2024	<p>Universiteti i Mjekësisë Tiranë (UMT) ka deklaruar 0 kuota të dedikuara për studentë të cilët synojnë të ndjekin si program të dyte studimi programin e integruar "Mjekësi e Përgjithshme" për vitin akademik 2024-2025. Ministria e Arsimit dhe Sportit pasi ka verifikuar kapacitetet akademike dhe infrastrukurore të deklaruara nga UMT dhe në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, ka certifikuar kuotat e deklaruara nga ky institucion sipas ndarjes së bërë nga strukturat e UMT.</p> <p>Në lidhje me informacionin për dokumentacionin, afatet dhe procedurat lutemi te gjeni informacion shterues në linkun më poshte ku listohen të gjithë aktet që rregullojnë aplikimin dhe regjistrimin në programin për të cilin është kërkuar informacion.</p> <p>http://umed.edu.al/pranimet-ne-programet-e-ciklit-te-pare-te-integruara-te-ciklit-te-dyte-dhe-te-ciklit-te-dyte-te-universitetin-e-mjekesise-tirane-per-vitin-akademik-2024-2025/</p>	Përfunduar	Jo
138	23.08.2024	<p>Sa është numri i nxënësve që janë pjesë e sistemit arsimor përherë të parë, si në 9 vjecare dhe gjimnaz? Sa ka qene ky numër 3 vitet e fundit? Sa maturante ka ky vit i ri shkollor? Cilat janë udhëzimet e reja për mësuesit? Sa mësues do të ushtrojnë detyrën për vitin shkollor 2024-2025? Sa mësues kane ushtruar detyrën në 3 vitet e fundit</p>	16.09.2024	<p>Sa i përket pyetjes 1, ju informojmë se të dhënat mbi regjistrimet për vitin shkollor 2024-2025 gjenerohen më vonë. Për 3 vitet e fundit shkollore, të dhënat e kërkuara i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Institutit të Statistikave (INSTAT), në linkun https://ëëë.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/arsimi/#tab1, si dhe në vjetarin statistikor të publikuar në faqen zyrtare të MAS, në linkun https://arsimi.gov.al/statistika-2/.</p> <p>Referuar pyetjeve 2 dhe 5, ju bëjmë me dije se të dhënat për numrin e nxënësve, maturanëve dhe mësuesve në arsimin parauniversitar, për vitin shkollor 2024-2025, gjenerohen më vonë. Të dhënat lidhur me numrin e mësuesve për 3 vitet e fundit shkollore i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Institutit të Statistikave (INSTAT), në linkun https://ëëë.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/arsimi/#tab1, si dhe në vjetarin statistikor të publikuar në faqen zyrtare të MAS, në linkun https://arsimi.gov.al/statistika-2/.</p> <p>Lidhur me pyetjen nr. 3 të kërkesës për informacion ju bëjmë me dije se udhëzimet e MAS i gjeni të publikuara në Qendrën e Botimeve Zyrtare në linkun https://qbz.gov.al/search;filter=qbz:actActType:%22http:%2F%2Fqbz.gov.al%2Fresource%2Fauthority%2Fdocument-type%2Fudhezim%22 dhe në faqen zyrtare të MAS në linkun https://arsimi.gov.al/category/udhezime/</p> <p>Sa i përket pyetjes 4, ju informojmë se të dhënat e perfundimtare për mësuesit që ushtrojnë detyrën për vitin shkollor 2024-2025 do të gjenerohen më vonë</p>	Përfunduar	Jo
139	26.08.2024	<p>Ju lutem kam nevojë per me teper informacion per mesues per greqine ju lutem nese do kete pranime do te afishohet diku si informacion?</p>	27.08.2024	<p>Deleguar ASCAP për trajtim dhe kthim përgjigje.</p>	Përfunduar	Jo

140	27.08.2024	Kam nevojë për informacion, se cili prej universiteteve në Shqipëri ofron dege studimi part time?	17.09.2024	<p>Në vijim të email-it tuaj, ju informojmë se: Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", asnjë prej institucioneve të arsimit të lartë publik apo jopublik, nuk ofron programe studimi part-time. Bazuar në nenin 69, të ligjit, nr. 80/2015, format e studimeve në institucionet e arsimit të lartë janë: a) studime me kohë të plotë; b) studime me kohë të zgjatur. Studimet me kohë të zgjatur mund të ofrohen në programet e studimit një deri në dyvjeçare me karakter profesional, programet e ciklit të dytë "Master profesional" dhe programet e ciklit të tretë "Master ekzekutiv". Programet e studimit, që japin të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, organizohen vetëm në formën e studimeve me kohë të plotë. Gjithashtu, ju informojmë se sipas nenit 79 të ligjit nr. 80/2015, studimet e doktoratës zhvillohen me kohë të plotë pranë njësive bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.</p>	Përfunduar	Jo
141	28.08.2024	Dua të pyes nëse njihet dhe konvertohet diploma bachelor e Universitetit Shtetëror Të Vlorës në Itali.	29.08.2024	Në vijim të kërkesës suaj të përcjellë në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ju bëjmë me dije se lidhur me njohjen e diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, jashtë vendit, duhet t'i drejtoheni autoriteteve përkatëse në shtetin ku do të njihni diplomën.	Përfunduar	Jo
142	28.08.2024	Kam mbaruar studimet e Larta (bachelor dhe master) në Itali, në fakultetin e Arkitektures dhe Inxhinierise së Ndërtimit dhe kam njohur dhe konvertuar diplomat në Shqipëri nga institucionet perkatëse. Duke qenë se ligji i ri përfshin që në mësuesi të futen edhe persona që kanë mbaruar shkollën e lartë dhe masterat me notën mesatare mbi 7, dëshiroja të dija më shumë hapat që duhet të ndjek për këtë proces.	16.09.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj ju bëjmë me dije si më poshtë: Bazuar në pikën 4, të nenit 57 të ligjit nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar parashikohet se profesioni i mësuesit mund të ushtrohet edhe nga individë që zotërojnë diplomë universitare të ciklit të parë dhe të dytë ose diplomë universitare të integruar, të ngjashme ose të përafërt me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar, dhe njohuri të certifikuar në formimin psikopedagogjik nga institucione të arsimit të lartë, që ofrojnë programe të studimeve të formimit të vazhduar. Diplomat e njëvlershme, diplomat e ngjashme ose të përafërta me diplomat e sipërpërmendura të këtij neni në fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psikopedagogjike përcaktohen me udhëzim të ministrit. Për më shumë informacion ju bëjmë me dije se udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2023 të ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike", të ndryshuar e gjeni të publikuar në linkun https://qbz.gov.al/previeë/ecf050ca-3113-45a7-a913-9109e4ff425d/cons/20230327 QBZ - Qendra e Botimeve Zyrtare Qendra e Botimeve Zyrtare qbz.gov.al Duke ju falenderuar,</p>	Përfunduar	Jo
143	30.08.2024	Jam diplomuar në vitin 2008. Profili historik (mësues i historisë). Kam punuar 3 vite si mësuese ndihmëse. A mund të futem në provimin e shtetit për licensim apo duhet praktika tre mujore profesionale?	02.09.2024	Deleguar AKAP për trajtim.	Përfunduar	Jo
144	31.08.2024	Informacion lidhur me formularin AIZ	02.09.2024	Deleguar QSHA-së.	Përfunduar	Jo
145	01.09.2024	Kërkoj informacion për shkollën 9 vjeçare Gjergj Fishta Lezhë për pikat: 1. Numër telefoni zyrtar. 2. Adresë e-maili zyrtar. 3. Adresë poste normale zyrtare.	02.09.2024	Deleguar AKAP, DRAP Lezhë dhe ZVAP Lezhë për kthim përgjigje.	Deleguar/Përfunduar	Jo

146	02.09.2024	Doja një informacion ju lutem në lidhje me regjistrimin në universitet, pasi nuk po më japin zgjidhje as shkolla e mesme ku mbaruar studimet.Kam.mbaruar par dy vjetësh dhe dua të regjistrohem kte vit në universitet.Cilat janë procedurat dhe nëse janë mbyllur ka ndonjë round të dytë për t'u regjistruar ?Çfarë dokumentacioni me duhet të plotësoj?	16.09.2024	Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, janë përcaktuar në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”. Afatet e procedurave (aplikim, shpallje fituesish, regjistrim, etj) janë përcaktuar në urdhrin e përbashkët të QSHA dhe RASH nr. 112, datë 05.07.2024 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2024-2025”. Bashkëlidhur gjeni udhëzimin e MAS nr. 12, datë 30.6.2023 dhe urdhrin e përbashkët QSHA-RASH nr. 112, datë 05.07.2024, të sipërcituar.	Përfunduar	Jo
147	04.09.2024	Ku mund të pajisem me vërtetim të shkollës 8 vjeçare? Para 1990.	04.09.2024	Në vijim të kërkesës suaj, ju bëjmë me dije se për të marrë vërtetim mbi përfundimin e arsimit bazë duhet t'i drejtoheni shkollës që keqi ndjekur.	Përfunduar	Jo
148	05.09.2024	Sa complete librash ka porositur Ministria e Arsimit dhe Sportit për vitin shkollor 2024-2025? Ju lutem, specifikoni të dhënat për secilin nivel arsimor (cikli parashkollor, fillor, 9-vjeçar dhe i mesëm) 2. Deri në ç'klasë jepen librat falas? Sa është kostoja totale e librave falas për vitin shkollor 2024-2025? 3. Çfarë ndodh me librat falas pas përfundimit të vitit shkollor? Sa prej tyre ripërdoren për vitin e ardhshëm shkollor? A ka një mekanizëm orientimi drejt riciklimit të tyre?	17.10.2024	gjithë nxënësit e arsimit bazë nga klasa e parë deri në klasë të nëntë. Nga klasa e parë deri në klasë të tretë jepen falas dhe nuk janë në ripërdorim. Ndërsa nga klasa e katërt deri në klasë të nëntë janë falas dhe përdoren tri vite. Gjithashtu librat falas jepen për nxënësit e arsimit të mesëm të lartë në institucionet arsimore publike për kategoritë të përcaktuara në vendimin nr. 486, datë 17.6.2020 të Këshillit të Ministrave “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar si më poshtë: i. Kanë përfituar statusin e jetimit; ii. Vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie nga zyrat e punësimit; iii. Janë me aftësi të kufizuara, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen sociale; iv. Vijnë nga familje që kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen sociale; v. Vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension invaliditeti shteti; vi. Vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension pleqërie shteti dhe kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura; vii. I përkasin kategorisë rome dhe egjiptiane. Për vitin shkollor 2024-2025 kanë marrë tekste falas rreth 238000 nxënës. Pas përfundimit të vitit shkollor në zbatim të udhëzimit nr. 21, datë 13.08.2020 “Për përcaktimin e procedurave për administrimin e teksteve shkollore në përdorim falas në arsimin parauniversitar”, librat që mbarojnë afatin trevjeçar të përdorimit kalojnë në inventarin e shkollës. Tekstet shkollore që janë në ripërdorim administrohen nga komisioni i	Përfunduar	Jo
149	06.09.2024	Kam aplikuar në portalin "Mësues për Greqinë". Doja të dija a janë bërë përzgjedhjet? Në rast se nuk do përzgjidhemi, do na informojnë?	09.09.2024	Deleguar Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)	Përfunduar	Jo

150	07.09.2024	A mundet qe vellai im i cili qe ka kryer Shkollen e Mesme Profesionale 4 vjeçare te aplikoj per studime te larta ne degen: Drejtesi?	09.09.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se në pikën 1 të nenit 74 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Në vendimin nr. 436, datë 3.6.2020 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021-2022 e në vijim” , i ndryshuar parashikon kriterin e notës mesatare https://qbz.gov.al/previeë/14a635cd-5aab-476c-a0aa-05892faf2566/cons/20220609 Institucionet e arsimit të lartë mund të vendosin edhe kriteret shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve prandaj lidhur me kriteret e tjera për ndjekjen e një programi studimi duhet t’i drejtoheni institucionit të arsimit të lartë ku do të vazhdoni studimet.	Përfunduar	Jo
151	07.09.2024	Informacion lidhur me lëvizjen e mësusit nga klasa kur bie numri i nxënësve në shtator. Drejtori si vepron me mësuesin që i mbyllet klasa i thotë zgjidh ku do apo e çon ku hapet klasë e re brenda drejtorisë. Çfarë procedure ndiqet dhe a ka një udhëzim për këtë.	09.09.2024	mësimore të një profili/lënde janë të parashikuar në udhëzimin nr. 8, datë 3.5.2024 “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, të ndryshuar që e gjeni të publikuar në linkun https://qbz.gov.al/previeë/23ef650d-391a-4a7c-ba9d-	Përfunduar	Jo
152	09.09.2024	Kam bërë aplikimin për njohje diplome si shtetase e huaj. Doja të kem informacion nëse aplikimi im është në proces.	09.09.2024	Deleguar për trajtim Qendrës së Shërbimeve Arsimore.	Përfunduar	Jo
153	09.09.2024	Informacion për SHMB "Karl Gega", Balldren, Lezhë. (1. Numër telefoni zyrtar. 2. Adresë e-maili zyrtar. 3. Adresë postare normale zyrtare.)	09.09.2024	Deleguar për trajtim DRAP Lezhë/ZVAP Lezhë, që kanë kthyer përgjigje datë 09.09.2024.	Përfunduar	Jo
154	07.09.2024	Jam ish maturante dhe kam bërë formularin A1Z në datën 5 gusht tani nuk me hapet U-Albania me nxjerrë perdoruesi nuk ekziston kontaktova dhe me u-albania me thanë qe nuk i ka hedhur QSHA-ja të dhenat akoma,por kam afat vetem deri në datën 18 ose nuk aplikoj dot në universitet po nuk hodhet të dhenat.Mund të kem një përgjigje ju lutem kur do hidhen është e rëndësishme	09.09.2024	Deleguar kërkesa për trajtim Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH) dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA). Me datë 10.09.2024 është kthyer përgjigje nga RASH se kërkesa është trajtuar dhe kthyer përgjigje maturantit.	Përfunduar	Jo

155	07.09.2024	A mundet qe vellai im i cili qe ka kryer Shkollen e Mesme Profesionale 4 vjeçare te aplikoj per studime te larta ne degen: Drejtesi?	09.09.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se në pikën 1 të nenit 74 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.</p> <p>Në vendimin nr. 436, datë 3.6.2020 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021-2022 e në vijim” , i ndryshuar parashikon kriterin e notës mesatare https://qbz.gov.al/previeë/14a635cd-5aab-476c-a0aa-05892faf2566/cons/20220609</p> <p>Institucionet e arsimit të lartë mund të vendosin edhe kriteret shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve prandaj lidhur me kriteret e tjera për ndjekjen e një programi studimi duhet t’i drejtoheni institucionit të arsimit të lartë ku do të vazhdoni studimet.</p>	Përfunduar	Jo
156	09.09.2024	I kam derguar nje email support@rash.al lidhur me pagesen e tarifes per aplikimet per raundin e dyte, pasi portali U albania nuk me lejon akses dhe afati per pagesen eshte deri ne dt 18 shtator. Ju lutem mund te zgjidhni problemin qe te kem akses per pagesen dhe regjistrimin ne raundin e dyte, ose ju lutem mund te me sugjeroni se ku duhet ta drejtoj ankesen time lidhur me problemin ne fjale.	10.09.2024	Deleguar kërkesa për trajtim Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH). Me datë 10.09.2024 është kthyer përgjigje nga RASH se kërkesa është trajtuar dhe kthyer përgjigje maturantit.	Përfunduar	Jo
157	10.09.2024	Ju lutem do te doja nje informacion ne lidhje me “Albanian Grading System Document” qe me kerkohet ne aplikimin per master jashte Shqiperise. Si mund te pajisem me kete dokument?	11.09.2024	Lidhur me kontrollin e dijeve dhe sistemin e vlerësimit ju lutem drejtohuni institucionit të arsimit të lartë ku keni ndjekur programin e studimit.	Përfunduar	Jo
158	10.09.2024	Ne vitin 2019 kam perfunduar studimet ne nivelin Master Shkencore, fakulteti i Drejtesise. Problemi im eshte se qe ne vitin 2019 akoma nuk kam terhequr diplomen per shkak se Nuk kam arritur te mbroj gjuhen e huaj në nivel B1. Ju lutem a keni nje udhezim qe te terheq diplomen pa mbrojtur gjuhen e huaj?	16.09.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj ju bëjmë me dije si më poshtë:</p> <p>Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.</p> <p>Bazuar në udhëzimin nr. 52, datë 3.12.2015 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar përcaktohen nivelet dhe testet ndërkombëtare të 5 (pesë) gjuhëve të huaja.</p> <p>Sa më sipër, theksojmë se njohja e gjuhës së huaj është kriter pranimi për programet e studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave”.</p>	Përfunduar	Jo

159	11.09.2024	Kam mbaruar ne 2002 per histori gjeografi dhe po nga 2002 jetoj ne Itali ku kam bere kerkesen per mesuese ne lice apo gjimnase ketu , pasi kam bere njohjen e diplomes , me kerkohe nga shteti italian licenza ose provimi i shtetit. Jetoj ne Milano ku punoj si vullnetare si mesuese e diaspores per gjuhën dhe kulturen shqiptare e njohur nga ministria e arsimit ne Shqiperi, ne shkollen Ibrahim Kodra ne Rozzano te Italise. Ju kerkoj me perulesi qe te me ndihmoni se si eshte procedura. Ju pershendes, pres pergjigjen tuaj. Faleminderit. Dhe dicka tjeter, une mendoj se meqe kam mbaruar magistralen ne 2002 nuk mendoj se me kap ligji i 2010 . Te gjitha miket e mia qe punojne ne Shqiperi nuk kane bere asnje provim shteti. Por megjithate ju e dini me mire .	17.09.2024	Bazuar në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar parashikohet se mësuesi i arsimit fillor, i arsimit të mesëm të ulët dhe i arsimit të mesëm të lartë, mësuesi i shkollave të arsimit të orientuar, mësuesi i kulturës së përgjithshme në shkollat profesionale, mësuesi që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe mësuesi me diplomë të ngjashme ose të përafërt me diplomat në fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar ushtron profesionin pasi: a) të ketë kryer me sukses praktikën profesionale; b) të ketë kaluar me sukses provimin e shtetit në fushën e formimit të tij, siç parashikohet në ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Sipas nenit 9, të ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar parashikohet se përjashtohet nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit: a) -profesionisti që, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtron ose ka ushtruar një profesion të rregulluar; b) -profesionisti, i cili fiton të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar jashtë Republikës së Shqipërisë, në përputhje me përcaktimet e Këshillit të Ministrave. Me ligjin nr.10 357, datë 16.12.2010 “Për një shtesë në ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë””, është parashikuar profesioni i mësuesit si profesion e rregulluar. Nëse e keni ushtruar profesionin e mësuesit në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji ose para hyrjes në fuqi të këtij ligji përjashtoheni nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit.	Përfunduar	Jo
160	11.09.2024	Prane Ministrise se Arsimit departamentit te njehesimit te Diplomes te shtetit te huaj kam bere aplikimin ne I – allbenia per njehesim diplome, dhe nga ana juaj me eshte kthyer pergjigje. Ne imellin e derguar nga ju me eshte kerkuar qe te dergohet ne rruge postare diploma e njehesuar, si dhe mandate pagesa e kam derguar me poste qe ne muajin maj, dhe jam ne pritje. Nga ana juaj nuk me eshte kthyer asnje pergjigje. Ky njehesim me duhet per arsye se jam ne mardhenie pune ne Gjykatene Rrethit Korce dhe kjo diplome me duhet per plotesim te dosjes personale.	11.09.2024	Deleguar Qendrës së Shërbimeve Arsimore si institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të “Diplomave profesionale/certifikatave profesionale”, diplomave “Bachelor”, diplomave “Master i shkencave”, “Master i arteve” dhe “Master profesional”, “Master ekzekutiv”, “Diploma të specializimit afatgjatë”, të fituar jashtë vendit bazuar në udhëzimin nr. 21, datë 15.10.2021 të ministrit të Arsimit dhe Sportit. Vë në dijeni kërkuesi për delegimin e kërkesës të QSHA-ja.	Përfunduar	Jo
161	12.09.2024	Kërkesë për verifikim diplome.	12.09.2024	Përcjellë Qendrës së Shërbimeve Arsimore.	Përfunduar	Jo
162	12.09.2024	Kam perfunduar studimet per Inxhinieri Perpunim Druri, ne Fakultetin e Shkencave Pyjore, UBT, me kohe te plote Bachelor dhe MSC. Interesohem te kryej trajnimin per mesuesi sipas udhezimit nr.3, date 15.02.2023 “Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike	12.09.2024	Me udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2023, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, të ndryshuar përcaktohen diplomat universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, të cilin e gjeni të publikuar në Qendrën e Botimeve Zyrtare në linkun https://qbz.gov.al/previeë/ecf050ca-3113-45a7-a913-9109e4ff425d/cons/20230327 Programet e studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, ofrohen nga institucionet e arsimit të lartë që kanë programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë në fushën e mësuesisë, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.	Përfunduar	Jo
163	13.09.2024	Doja te pyesja per konvertimin e diplomes (njohjen) ne shtetin Amerikan. Kam mbaruar ne 2010 universitetin e Korces Fan S. Noli me sistemin e vjeter 4 vjecar, plus 1 vit master. Dhe doja te dija nese me ndihmoni me listen e notave qe ti konvertoj ne kredite ne menyre qe te kete vlere atje ne USA. Nese mund te me ndihmoni se cfare informacioni duhet do te vlersoja shume.	16.09.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se sipas nenit 124, “Dispozita kalimtare dhe të fundit”, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se diplomat e programeve të studimit, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, që kanë zgjatur, së paku, 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve, sipas parimeve të procesit të Bolonjës, janë ekuivalente me diplomat “Master i shkencave”. Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk kryen konvertim të këtyre diplomave.	Përfunduar	Jo

164	13.09.2024	Jam nje zonje kam mbaruar gjimnazin ne vitin 93,ne vitin 1999-2000 u regjistrova ne Elbasan per Gjuhe-Letersi per arsye familjare ne gjysme te vitit te pare e lash dhe tani une dua te vazhdoj per infermieri por shkova te UT Elbasan dhe me thane nuk rezulton te jem e regjistruar.Ne shkollen e mesme ku kam mbaruar gjimnazin (se kam bere bujqësoren ateheres)me dhane asnje informacion se cfare duhet te beja dhe dëftesën mezi ma dhane dhe sot me kerkojne provime mature dhe aplikim online qe provimet e matures u mbyllen.Tani dua te di a ka nje mundesi qe te regjistrohem kete vit?Mund te me jepni informacion me te detajuar ju lutem se kam dy vjet me sjellin verdall jam ne hall te madhe.	17.09.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se për kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë në vitet e mëparshme dhe që dëshirojnë të aplikojnë për ndjekjen e studimeve në institucionet e arsimit të lartë, duhet të aplikojnë për formularin A1Z. Sipas urdhrorit të përbashkët nr. 661, datë 1.12.2023 të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e maturës shtetërore në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se kandidatët, të cilët kanë marrë dëftesë pjekurie para vitit 2011 dhe dëshirojnë të aplikojnë për ndjekjen e studimeve në institucionet e arsimit të lartë, u njihen provimet e detyruara dhe me zgjedhje ose provimet e njëvlershme me to, të njehsuara nga ZVAP-ja. Në rastet kur këta kandidatë nuk kanë dhënë provime me zgjedhje kanë të drejtë të japin një provim me zgjedhje kur e kanë të nevojshme për plotësimin e kritereve të pranimit të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë. Gjithashtu bazuar në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë” parashikohet se për kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë në vitet e mëparshme dhe që kanë aplikuar me formularin A1Z, drejtoritë e institucioneve arsimore, ku ata kanë kryer aplikimin, hedhin në sistemin SMIP të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë. Sa më sipër, ju bëjmë me dije se për ndjekjen e studimeve në institucionet e arsimit të lartë, duhet aplikuar për formularin A1Z. Plotësimi i formularit A1Z, bëhet në shkollën ku keni kryer arsimin e mesëm të lartë.	Përfunduar.	Jo
165	13.09.2024	Informacion mbi numrin e nxënësve ukrainas që studiojnë në institucionet arsimore në Shqipëri.	18.09.2024	Vënia në dispozicion të informacionit të kërkuar.	Përfunduar	Jo
166	14.09.2024	Kam mbaruar studimet e larta per Teknik Imazherie ne shqiperi dhe Master shkencor po ne kete fushe, jam perpjekur here pas here te nxjerr nje vertetim tek e Albania por perpjekja ka rezultuar e pasukseshme. Me duhet nje vertetim i vulosur nga ministria e shendetsise qe une kam mbaruar universitetin dhe masterin ne Tirane, une jetoj prej 6 vitesh ne gjermani dhe punoj me nje spital te frankfurtit dhe kam nje mbrojtje diplome Masteri me provim perfundimtar 10 - ne shqiperi. Do ju lutesha ju lutem te me benin nje vertetim qe une kam mbaruar studimet ne shqiperi Bachelor +Master sepse dua te bej specializim ne gjermani dhe me duhet me vule dhe firme nga ministria e shendetsise ne tirane.	16.09.2024	Në vijim të kërkesës suaj të përcjellë në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit sqarojmë se për tu pajisur me vërtetim për përfundimin e ciklit të parë dhe ciklit të dytë të studimeve të arsimit të lartë duhet t'i drejtoheni institucionit të arsimit të lartë ku keni ndjekur studimet. Për sa i përket vërtetimit që kërkon nga Ministria e Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale, duhet t'i drejtoheni këtij institucioni.	Përfunduar	Jo
167	16.09.2024	Kam qen nje student i Politeknikut dhe kam ber crregjistrimin dhe kam aplikuar per formularin A1z.Kam plotsuar cdo dokument jam paisur me nje id maturanti te re kam paguar dhe faturen ne u Albania por ne u Albania.	16.09.2024	Lidhur me procedurat e aplikimit në faqen e U-Albania ju lutem kontaktoni në adresën elektronike të suportit support@rash.al dhe sqaroni problematikën që keni hasur.	Përfunduar	Jo
168	16.09.2024	Ju lutem doja informacion ne lidhje me njohjen e titullit akademik ne vendin tone per thirrjen akademike Profesor Asistent te mare ne Kosove. A njihet ky titull ne Shqiperi si Profesor Asociuar? Nese po ju lutem cilat jane hapat qe duhet te ndjeqe qe te me behet njohja edhe ne Shqiperi? Mbetem ne pritje te nje pergjigje nga ana juaj ne kuader dhe te ligjit 119/2014 “Per te drejten e informimit, i ndryshuar.	16.09.2024	Përcjellë QSHA-së. Kthim përgjigje nga QSHA-ja me datë 17.09.2024.	Përfunduar	Jo

169	17.09.2024	Sa është numri i oficerëve të sigurisë nëpër shkolla për vitin akademik 2023-2024? Sa prej tyre janë meshkuj dhe sa femra? Sa ka qenë numri i tyre në vitin akademik 2022-2023? Sa janë meshkuj dhe sa janë femra?	26.09.2024	Në zbatim të vendimit nr. 553, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.600,datë 9.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”,të ndryshuar, numri miratuar i oficerëve të sigurisë u rrit nga 150 oficerë sigurie në 222 oficerë sigurie dhe ky shërbim u shtri edhe në shkollat e arsimit bazë të cilat plotësonin kriteret e përcaktuara. Për vitin shkollorë 2022-2023 dhe 2023-2024, numri i miratuar i oficerëve të sigurisë ka qënë 222 oficer, ndërsa numri faktin ka qënë mesatarisht 212 nga të cilët 146 ishin femra dhe 66 ishin meshkuj.	Përfunduar	Jo
170	17.09.2024	Si është formula e llogaritjes se pikeve per studentet qe trasferohen ne stomatologji?	17.09.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se sipas udhëzimit nr. 12, datë 30.6.2023 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë” parashikohet se kandidati që kërkon të transferojë studimet ka të drejtë të aplikojë pranë institucioneve të arsimit të lartë, sipas afateve të përcaktuara. Çdo aplikim për transferimin e studimeve shqyrtohet nga komisioni i ngritur për këtë qëllim nga Intitucioni i Arsimit të Lartë. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi. Sa më sipër, lidhur me kërkesën tuaj lutem drejtohuni institucionit të arsimit të lartë ku do të aplikoni për transferimin e studimeve.	Përfunduar	Jo
171	17.09.2024	Jam student në vitin e tretë mjekësi dhe mbarova vitin e dytë me mesatare 9.5. A e përfitoi bursën sa paga minimale?	18.09.2024	Përcjelljë për trajtim dhe kthim përgjigje AKFAL, duke vënë në dijeni kërkuesin.	Përfunduar	Jo
172	17.09.2024	Kam perfunduar Fakultetin e Ekonomise, UT, ne vitin 2009. Ne ate kohe nuk ishte sistemi i kredite (ECTS). Doja nje informacion ju lutem ku mund te drejtohem ne menyre qe te kem nje dokument zyrtar sa kredite ka diploma qe une kam, Diplome e Integruar e Nivelit e Dyte.	17.09.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se sipas nenit 124,“Dispozita kalimtare dhe të fundit”, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se diplomat e programeve të studimit, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë,që kanë zgjatur, së paku, 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve, sipas parimeve të procesit të Bolonjës, janë ekuivalente me diplomat “Master i shkencave”. Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk kryen konvertim të këtyre diplomave.	Përfunduar	Jo
173	17.09.2024	Kam 2 femi njërin 5 vjec e kam në shkollë në parashkollor dhe njërin 11 vjen në klasë të 6 ju lutem doja tu informoja rreth bursave të shkollës a mundemi të marrim nëse aplikoj për to vetëm burri më punon me rrogë 360 mijë lekë pasi un nuk mundem te eci kam problem me gjurin jam per operim a mundemi te aplikoj për të 2 fëmijët apo nuk behet	02.10.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se bazuar në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, i ndryshuar parashikohen kriteret për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar Në vendimin e sipërcituar gjithashtu parashikohet se njësitë e vetëqeverisjes vendore, për uljen e nivelit të braktisjes shkollorë, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, miratojnë bursa financiare me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, pas konfirmimit nga mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës për frekuentimin e procesit mësimor, si dhe nga zyra vendore e arsimit parauniversitar. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kategorinë e nxënësve që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë, dhe për uljen e braktisjes shkollorë të arsimit bazë, mund të miratojnë dhe të shpërndajnë bursa edhe nga fondet e veta ose nga fondet buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar. Sa më sipër, lutem drejtohuni bashkisë përkatëse për t'u informuar nëse mund të jeni përfitues i bursave që ofrohen për nxënësit e arsimit parauniversitar sipas vendimin nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.	Përfunduar	Jo
174	17.09.2024	Jam e interesuar te di si mund te aplikoj per te terhequr diplomen e gjimnazit ?	17.09.2024	Lidhur me dokumentin që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm të lartë drejtohuni shkollës që keni ndjekur.	Përfunduar	Jo

175	18.09.2024	Kam mbaruar Bachelor ne Gazetari dhe Gjuhe Angleze ne vitin 2017 ne universitetin e Elbasanit tani dua te rregjistrohem per master ne gjuhen angleze ne qytetin e gjirokastres ne universitetin Eqerem cabej, a mund te me jepni nje informacion nese mund te rregjistrohem per kete dege dhe a mund te mare licencen per mesuesi ? A duhet per nje master profesional apo shkencore ?	01.10.2024	Në vijim të kërkesës suaj lutem lidhur me kriteret e pranimit në programet e studimit të ciklit të dytë drejtohuni institucionit të arsimit të lartë ku do të aplikoni. Kriteret e ushtrimit të profesionit të mësuesit parashikohen në nenin 57 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Pranimi në provimin e shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit kryhet sipas rregullores "Për funksionimin e komisionit të provimit të shtetit dhe procedurat e zhvillimit të provimit të shtetit" miratuar me urdhrin nr. 365, datë 28.12.2020.	Përfunduar	Jo
176	18.09.2024	Kam kryer studimet e masterit shkencor ne degen____ dhe _____ ne _____ne vitin 2018-2020. Ne keto vite ky institucion ka qene ne proces akreditimi por se fundmi nuk e kaloj procesin e akreditimit dhe si pasoj ky institucion u mbyll.Do doja te dija si funksionon ne keto raste sepse nuk kam informacionin e duhur per kete gje. Vitet e arsimit qe un kam bere ne kete institucion jane te pavlefshem dhe duhet te bej serisht ne nje universitet tjeter apo ka ndonj menyre tjeter nepermjet provimeve. Me poshte po dergoj dhe nje foto te diplomes .	01.10.2024	Në vijim të kërkesës suaj të përcjellë në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit, bazuar në pikën 1, të nenit 12 të ligjit nr.119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar lutemi qartësimin e informacionit që kërkonti t'u vihet ne dispozicion.	Përfunduar	Jo
177	18.09.2024	Ne vazhdimesi per te kuptuar aplikim per mesues per kantidatet qe kane mbaruar studimet ne vitin 2010-2011,qe na eshte njohur dhe masteri shkencor, si mund te punsohemi per mesues te edukimit fizik?	01.10.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se bazuar në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar në nenin 57 parashikohet se mësuesi i arsimit fillor, i arsimit të mesëm të ulët dhe i arsimit të mesëm të lartë, mësuesi për arsimin e mesëm të ulët dhe për arsimin e mesëm të lartë duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë “Bachelor” në fushën/lëndët e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë dhe diplomën e ciklit të dytë “Master” me 120 ECTS në fushën e mësuesisë, që lidhet me programin e studimit të ciklit të parë. Mësuesi i shkollave të arsimit të orientuar, mësuesi i kulturës së përgjithshme në shkollat profesionale, mësuesi që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe mësuesi me diplomë të ngjashme ose të përafërt me diplomat në fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar	Përfunduar	Jo
178	18.09.2024	Ju drejtohem per nje orientim si duhet te veproji, per te marr nje kopje te vertetimit te njehesimit te diplomes sime, , diplome e njehesuar ne vitin 2016. Bashkelidhur po ju dergoj dokumentin e ministrise per njehesimin. Konsultuam e-albanian por nuk gjetem nje hapsire qe te na mundesonte aplikimin per nje vertetim duplikat te diplomes se njehesur.	19.09.2024 17.10.2014	Në vijim të kërkesës suaj, ju bëjmë me dije se për t'u pajisur me një kopje të vertetimit të njehesimit të diplomës duhet të përcillni një kërkesë zyrtare drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, shoqëruar me një kopje ID,	Përfunduar	Jo

179	19.09.2024	<p>Cilat jane shkeljet konkrete qe jane gjetur nga ekspertet e grupit te verifikimit ne raportin e perfunduar ne korrik?</p> <p>Cili eshte vendimi i MAS per studentet qe ndodhen ne mes te studimeve te tyre prane ketij kolegjii?</p> <p>Cili eshte komenti juaj rreth deklrates se KU ëisdom ku thuhet se do te ushtrojne veprimtarine akademike normalisht?</p> <p>Ne faqen eeb te ketij universiteti ndodhet dhe nje njoftim qe udhezoi maturantet se si te regjistrohen per vitin e pate ne bachelor, pacaresisht se MAS nuk ka bere certifikimin e kuotave per vitin akademik 2024-2025. Ne cfare date u keni dhene vendimin e sipercituar perfaqesuesve te KU ëisdom?</p> <p>Cila eshte strategjia jua per te siguruar ne rastin konkret mbrojtjen e cilesise dhe te vleres se diplomave te studenteve shqiptare?</p>	17.10.2024	<p>nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” ka nisur prej vitit 2022 dhe në vijim, procesin periodik të verifikimit të kontrollit të pajtueshmërisë së veprimtarisë të gjithë institucioneve të arsimit të lartë.</p> <p>Në vijim të këtij procesi, në periudhën 2023-2024, MAS, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, përmes grupit të punës të ngritur për këtë qëllim, me përfaqësues të strukturave përgjegjëse të ministrisë, Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore, ka nisur verifikimin e pajtueshmërisë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të Kolegjit Universitar WISDOM. Pas procedurave të ndjekura në kuadër të këtij procesi, dhe verifikimeve të kryera përgjatë periudhës së kontrollit në këtë institucion, në përfundim të tij, grupi i punës, në korrik të këtij viti, ka përfunduar raportin final të kontrollit, duke konstatuar shkelje ligjore, gjatë ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të Kolegjit Universitar WISDOM për periudhën e ushtrimit të kontrollit, referuar dispozitave të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.</p> <p>Nënvizojmë se ndërkohë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, për vitin e ri akademik 2024-2025, nuk ka çertifikuar kuota pranimit për Kolegjin Universitar WISDOM. Me shkresën nr. 4836 prot., datë 29.07.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit drejtuar Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) me anë të së cilës janë përcjellë kuotat për programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, PIND dhe programet me karakter profesional, të ofruara nga IAL-të, për vitin akademik 2024-2025, është informuar RASH se për Kolegjin Universitar “Wisdom” nuk certifikohen kuota pranimit për vitin akademik 2024-2025.</p>	Pwrfunduar	Jo
180	19.09.2024	<p>Sa është numri i diplomave që janë lëshuar në total nga institucioni i publik kolegjii universitar “Ëisdom” ? Këto diploma në çfarë programesh studimi janë lëshuar? Sa prej tyre janë marrë nga studentë shqiptarë, dhe sa nga studentë të huaj italian? Flisni për një raport kontrolli dhe konstatim shkeljesh, çfarë shkeljesh konkretisht ka kryer ky institucion arsimor që i keni hequr të drejtën e pranimit të kuotave për një vit? Keni të dhëna në lidhje me zyrat e përfolur në këtë skemë, Shqiponja Telhaj, keni kryer verifikim për këtë shtetase, dhe bordin e akreditimit në agjencinë e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë? Sa kontrole keni kryer në total në kolegjii “Ëisdom” dhe çfarë ka rezultuar në secilin prej tyre? Në çfarë kushtesh i është dhënë akreditimi këtij institucioni?</p>	17.10.2024	<p>nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” ka nisur prej vitit 2022 dhe në vijim, procesin periodik të verifikimit të kontrollit të pajtueshmërisë së veprimtarisë të gjithë institucioneve të arsimit të lartë.</p> <p>Në vijim të këtij procesi, në periudhën 2023-2024, MAS, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, përmes grupit të punës të ngritur për këtë qëllim, me përfaqësues të strukturave përgjegjëse të ministrisë, Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore, ka nisur verifikimin e pajtueshmërisë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të Kolegjit Universitar ëISDOM. Pas procedurave të ndjekura në kuadër të këtij procesi, dhe verifikimeve të kryera përgjatë periudhës së kontrollit në këtë institucion, në përfundim të tij, grupi i punës, në korrik të këtij viti, ka përfunduar raportin final të kontrollit, duke konstatuar shkelje ligjore, gjatë ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të Kolegjit Universitar ëISDOM për periudhën e ushtrimit të kontrollit, referuar dispozitave të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.</p> <p>Nënvizojmë se ndërkohë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, për vitin e ri akademik 2024-2025, nuk ka çertifikuar kuota pranimit për Kolegjin Universitar ëISDOM. Me shkresën nr. 4836 prot., datë 29.07.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit drejtuar Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) me anë të së cilës janë përcjellë kuotat për programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, PIND dhe programet me karakter profesional, të ofruara nga IAL-të, për vitin akademik 2024-2025, është informuar RASH se për Kolegjin Universitar “ëisdom” nuk certifikohen kuota pranimit për vitin akademik 2024-2025.</p>	Përfunduar	Jo

181	19.09.2024	<p>Ministria nuk ka kompetencë në akreditimin e institucioneve, por a keni ndërmarrë veprime të rishikimit të veprimtarisë së anëtarëve të Bordit të Akreditimit në lidhje me procedurat e akreditimit të këtij kolegji? A janë gjetur shkelje dhe nëse po, a janë referuar në organet kompetente të zbatimit të ligjit? Çfarë masash janë marrë ndaj drejtoreshës së ASCAL.</p>	17.10.2024	<p>nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” ka nisur prej vitit 2022 dhe në vijim, procesin periodik të verifikimit të kontrollit të pajtueshmërisë së veprimtarisë të gjithë institucioneve të arsimit të lartë.</p> <p>Në vijim të këtij procesi, në periudhën 2023-2024, MAS, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, përmes grupit të punës të ngritur për këtë qëllim, me përfaqësues të strukturave përgjegjëse të ministrisë, Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore, ka nisur verifikimin e pajtueshmërisë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të Kolegjit Universitar ëISDOM. Pas procedurave të ndjekura në kuadër të këtij procesi, dhe verifikimeve të kryera përgjatë periudhës së kontrollit në këtë institucion, në përfundim të tij, grupi i punës, në korrik të këtij viti, ka përfunduar raportin final të kontrollit, duke konstatuar shkelje ligjore, gjatë ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të Kolegjit Universitar ëISDOM për periudhën e ushtrimit të kontrollit, referuar dispozitave të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.</p> <p>Nënvizojmë se ndërkohë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, për vitin e ri akademik 2024-2025, nuk ka çertifikuar kuota pranimi për Kolegjin Universitar ëISDOM. Me shkresën nr. 4836 prot., datë 29.07.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit drejtuar Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) me anë të së cilës janë përcjellë kuotat për programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, PIND dhe programet me karakter profesional, të ofruara nga IAL-të, për vitin akademik 2024-2025, është informuar RASH se për Kolegjin Universitar “ëisdom” nuk certifikohen kuota pranimi për vitin akademik 2024-2025.</p>	Përfunduar	Jo
182	19.09.2024	<p>A është vërtetë që MAS nuk ka çertifikuar kuota pranimi për Kolegjin Universitar ëISDOM? Nëse po, përse ëISDOM hedh poshtë reagimin zyrtar të MAS? Duke marrë parasysh nisjen e hetimeve nga Prokuroria e Tiranës, çfarë ndodh me ëISDOM? Çfarë do të ndodh me studentët që nuk kanë mbyllur ende Bachelor-in?</p>	17.10.2024	<p>nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” ka nisur prej vitit 2022 dhe në vijim, procesin periodik të verifikimit të kontrollit të pajtueshmërisë së veprimtarisë të gjithë institucioneve të arsimit të lartë.</p> <p>Në vijim të këtij procesi, në periudhën 2023-2024, MAS, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, përmes grupit të punës të ngritur për këtë qëllim, me përfaqësues të strukturave përgjegjëse të ministrisë, Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore, ka nisur verifikimin e pajtueshmërisë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të Kolegjit Universitar ëISDOM. Pas procedurave të ndjekura në kuadër të këtij procesi, dhe verifikimeve të kryera përgjatë periudhës së kontrollit në këtë institucion, në përfundim të tij, grupi i punës, në korrik të këtij viti, ka përfunduar raportin final të kontrollit, duke konstatuar shkelje ligjore, gjatë ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të Kolegjit Universitar ëISDOM për periudhën e ushtrimit të kontrollit, referuar dispozitave të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.</p> <p>Nënvizojmë se ndërkohë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, për vitin e ri akademik 2024-2025, nuk ka çertifikuar kuota pranimi për Kolegjin Universitar ëISDOM. Me shkresën nr. 4836 prot., datë 29.07.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit drejtuar Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) me anë të së cilës janë përcjellë kuotat për programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, PIND dhe programet me karakter profesional, të ofruara nga IAL-të, për vitin akademik 2024-2025, është informuar RASH se për Kolegjin Universitar “ëisdom” nuk certifikohen kuota pranimi për vitin akademik 2024-2025.</p>	Përfunduar	Jo

183	19.09.2024	Sa fëmij kanë përfituar mbështetje me burse nga minoritetin Rom & Egjiptian duke filluar nga klasa e 1 deri me klasën e 9 nga këto bashki: Bashkia Tirane, Bashkia Shkoder, Bashkia Berat, Bashkia Pogradec, Bashkia Fier, Bashkia Vlore, Bashkia Roskovec.	02.10.2024	Në vijim të kërkesës suaj të përcjellë në adresën e koordinatorit në MAS ju bëjmë me dije se: Bazuar në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike” , të ndryshuar parashikohet se njësitë e vetëqeverisjes vendore me vendim të këshillit bashkiak, miratojnë dhënien e bursave, sipas kriterëve të përcaktuara Sa më sipër, lutem lidhur me të dhënat e kërkuara nga ana juaj drejtohuni bashkive përkatëse.	Përfunduar	Jo
184	20.09.2024	Jam nje studente e viteve 2005 kam mbaruar shkollen e mesme, per arsyet e mira skam mundur te vazhdoj me larte Tani qe kam mundesi ju lutem me informoni pak kur hapet formulari A1Z?	04.10.2024	Ju informojmë se me urdhrin nr. 157, datë 3.10.2024 të Qendrës së Shërbimeve Arsimore "Për miratimin e periudhës së aplikimeve me formularin AIZ për MSH 2024" është përcaktuar miratimi i periudhës së aplikimeve me formularin AIZ, për MSH 2024, në datën 04 Tetor 2024, ora 08.00 - 16.00 https://qsha.gov.al/ep-content/uploads/2024/10/Urdher-per-miratimin-e-periudhes-se-aplikimeve-me-formularin-A1Z-per-MSH-2024.pdf	Përfunduar	Jo
185	22.09.2024	Kam mbaruar shkollen e mesme ne dures te mjeshteria sportive (bernardina qeraxhia) Per momentin dua te vazhdoj masterin por spo gjej dot diplomen e shkolles .	26.09.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se për t'u pajisur me vërtetim mbi përfundimin e arsimit të mesëm duhet t'i drejtoheni shkollës që keni ndjekur.	Përfunduar	Jo
186	23.09.2024	Ju lutem do doja të kisha nje informacion per punesim si officer sigurie neper shkolla. Cfare kriteresh duhet te plotesoj? Une jam diplomuar bachelor psikologi e pergjithshme dhe master psikologji shkollore. Ka nje trajnim te posaçem per kete pozicion pune? Vendet vakante ku shpallen ju lutem! Do doja të kisha nje informacion sa më të detajuar	01.10.2024	Punësimi si Officer Sigurie bëhet bazuar në vendimin nr. 600, datë 9.10.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në institucionet e arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, të ndryshuar. Sipas këtij vendimi parashikohet se: “4. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t’u përzgjedhur oficer sigurie janë, si më poshtë vijon: a) Të jetë shtetas shqiptarë; b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar; c) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse; ç) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale; d) Të mos ketë marrë masën disiplinore të largimit nga detyra në institucionet ku ka qenë i punësuar më parë; dh) Të ketë diplomë të ciklit të dytë ose diplomë të barasvlershme me të në fushën e edukimit, të shkencave sociale, sociologjisë, psikologjisë, drejtësisë; ë) Të ketë njohuri të mira kompjuterike.” Gjithashtu, pas aplikimit të kandidatëve dhe kualifikimit, çdo kandidat duhet t’i nështrohet trajnimit nga Akademia e Sigurisë në Tiranë. Procedurat për aplikimin dhe konkurimin për oficer sigurie janë bërë më parë. Njoftimet për aplikim bëhen në faqen e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Për momentin nuk ka një njoftim të tillë. Ju duhet të ndiqni në vijimësi këtë faqe për aplikim.	Përfunduar	Jo

187	23.09.2024	Jam e interesuar per te aplikuar per raund te trete a do kete dhe nese po, ne cfare datash?	24.09.2024	Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, janë përcaktuar në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”. Afatet e procedurave (aplikim, shpallje fituesish, regjistrim, etj) janë përcaktuar në urdhrin e përbashkët të QSHA dhe RASH nr. 112, datë 05.07.2024 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2024-2025”. Bashkëlidhur gjeni udhëzimin e MAS nr. 12, datë 30.6.2023 dhe urdhrin e përbashkët QSHA-RASH nr. 112, datë 05.07.2024, të sipërcituar.	Përfunduar	Jo
188	23.09.2024	Po planifikoj te nis doktoraturen dhe kam nje opsion te mire ne International Burch Univesity ne Sarajevo, Bosnje. Kisha deshire tju pyesja paraprakisht nese diploma e ketij universiteti njihet nga shteti shqiptar qe me pas te vazhdoj me procesin e njehsimit ne e-albania.	24.09.2024	Deleguar QSHA-së. Kthim përgjigje nga QSHA-ja datë 24.09.2024.	Përfunduar.	Jo
189	23.09.2024	Unë që po ju shkruaj jam një vajzë, quhem _____ lindur dhe banuese në Tiranë. Aryeja e kontaktit tim vjen pasi kam lexuar njoftimin tuaj në MAS, se ju si institucion arsimor keni ndërmarrë një nismë të re për të përzgjedhur në profile si Këshillimi dhe Orientimin i Karrierës për nxënësit dhe të Sigurimit të Cilësisë për shkollat dhe mësuesit. Unë kam mbaruar me rezultate të larta Bachelor në Sociologji - Antropologji Sociale dhe Master Shkencor në Shkenca Edukimi me profil Politika në Edukim në institucion jopublik të Shqipërisë. Mbas një eksperience në arsimin e lartë si asistent- pedagoge, pata dëshirën të rikthehem në sistem parauniversitar. Mirëpo profili i mbaruar prej meje në legjislacionin tuaj nuk më lejonte në fushën e mësuesit. Duke qenë se këto profile të reja që ju po aplikoni unë i kam bërë pjesë të lëndëve të mija akademike, kam zhvilluar edhe trajnime lidhur kryesisht me profilin e Sigurimit të Cilësisë, dëshiroja t'ju shtroja një kërkesë nëse mund të përfshihet rasti im në strategjinë tuaj të re.	01.10.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se në zbatim të vendimit nr. 425, datë 26.6.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar” është miratuar urdhri nr. 463, datë 30.8.2024 “Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e “Mësuesit koordinator për sigurimin e Cilësisë” dhe të “Mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës” në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, të cili e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP), në linkun https://arsimiparauniversitar.gov.al/urdher-nr-463-date-30-08-2024-per-percaktimin-e-kriterëve-per-miratimin-e-mesuesit-koordinator-per-sigurimin-e-cilesise-dhe-te-mesuesit-koordinator-te-keshillimit-te-karrieres-ne-instituci/Faleminderit ,	Përfunduar	Jo
190	23.09.2024	Kam aplikuar në programin “Mësues për Greqinë” dhe doja të dija ju lutem,në qoftë se jam përzgjedhur!	25.09.2024	Deleguar për trajtim ASCAP. Kthim përgjigje nga ASCAP me datë 27.09.2024.	Përfunduar	Jo
191	23.09.2024	Kërkohe vendosja në dispozicion të monitorimit të vlerësimit që MAS dhe ekspertëve të pavarur të arsimit kanë bërë gjatë dy herëve të fundit për secilin prej insitucioneve arsimore private që rezultojnë të akredituara sipas të dhënave të bëra publike nga ASCAL.	02.10.2024	Bazuar në vendimin nr.109, datë 15.2.2017 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, të ndryshuar parashikohet se ASCAL bën publike, përmes faqes zyrtare të saj në internet, raportet përfundimtare të vlerësimit të jashtëm, monitorimit të vazhduar të cilësisë, dhe aktet e Bordit të Akreditimit. Sa më sipër, lutemi për raportet përfundimtare të vlerësimit të jashtëm për IAL-të përkatës vizitoni faqen zyrtare të ACAL. https://ëëë.ascal.al/sq/akreditimi/institucione-te-akredituara https://ëëë.ascal.al/media/documents/rvj/IAL_36_124.pdf https://ëëë.ascal.al/media/documents/rvj/IAL_6_112.pdf	Përfunduar	Jo
192	24.09.2024	Ju lutem mund te me jepni pergjigje per nje aplikim qe kam ber me daten 23.08.2024 Jam ne pritje per njohje diplome shtetase Kosovare.	24.09.2024	Deleguar QSHA-së. Kthim përgjigje nga QSHA-ja datë 25.09.2024.	Përfunduar	Jo

193	24.09.2024	Jam i interesuar te di nese eshte e barazflefshme inxhinieri transporti ne universitetin e tiranes me inxhinieri e trafikut dhe transportit ne universitet ne prishtine. Jam i interesuar sepse me nevoitet per license per intruktor teorie per autoshkolle.	01.10.2024	Në vijim të kërkesës suaj të paraqitur në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, bëjmë me dije se kërkesa juaj është e paqartë. Lidhur me diplomat e fituara jashtë vendit ju informojmë se sipas nenit 92 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se: “Diplomat, certifikatat e gradat e fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, që i përkasin niveleve nga 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, njihen dhe njësohen përmes lëshimit të dokumentit zyrtar, të barasvlershëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, në përfundim të procedurës zyrtare të njohjes.” Procedurat e njohjen dhe njësimit e diplomave të fituara jashtë vendit parashikohen në udhëzimin nr. 21, datë 15.10.2021 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimit në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara”, të ndryshuar. Qendra e Shërbimeve Arsimore është institucioni përgjegjës për njohjen e diplomave të programeve të ciklit të parë dhe ciklit të dytë të studimeve. Aplikimi kryhet on line nëpërmjet portalit e-Albania.	Përfunduar	Jo
194	24.09.2025	I am writing to you hoping that I will find help and solution to my problem. My name is Jeta Gjergji, I was born in Patalej, Lezhe the 12/04/1975. I have been leaving 30 years now in Italy and I now need to get my "diploma shkollës së mesme". Unfortunately, there has been a mistake 45 years ago I got registered at school as "Marjeta Gjergji" while my real name, as I said, is Jeta Gjergji. My mother, who still lives there, has tried hard and travelled a lot up and down to take my diploma for me from the school I attended. The school director refuses to give the diploma to my mother, as there is this name problem. My mother has already presented my original birth certificate, but, apparently, it is not enough to have the diploma. I feel helpless, many years ago wasn't that hard to have such a document. I don't really know how should I move and what should I do in order to obtain my diploma certificate. Though, it is very necessary for me.	01.10.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se sipas ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikohet se procedura administrative kryhet në gjuhën dhe shkrimin shqip. Nëse pala duhet të paraqesë një kërkesë brenda afatit dhe e bën këtë në një gjuhë të huaj, organi publik e njofton palën për detyrimin për ta paraqitur kërkesën në gjuhën dhe shkrimin shqip. Gjithashtu bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, parashikohet se kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuar dhe nënshkrimin e tij. Sa më sipër, lutem paraqitjen e kërkesës në gjuhën shqipe dhe në formën e kërkuar.	Përfunduar	Jo
195	25.09.2024	Jam _____, student pranë diplomimit në Universitetin e Tetovës, Maqedoni e Veriut. Pasi që jam në fazat përfundimtare, për të kompletuar dosjen më duhet dokument se shkolla e mesme që kam mbaruar në Shqipëri "Haxhi Sheh Shamia" në Shkodër, është e akredituar. Bashkangjitur keni diplomën time. Ju lutem, të më jepni informatë nëse kjo shkollë është apo jo e akredituar, dhe nëse po, më duhet dokument/vërtetim që pohon këtë. Do më kishte kryer shumë punë ky dokument, përndryshe rrezikoj të mos më njihen 4 vitet e fakultetit, dhe të ngel pa diplome universitare.	01.10.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se me vendimin nr.560, datë 26.8.1996 të Këshillit të Ministrave “Për dhënie leje për funksionimin e institucioneve arsimore private”, të ndryshuar është dhënë leja për funksionimin e institucionit arsimor private, Medreseja H.Sheh Shamija” Shkodër. Me qëllim përdorimin e dokumenteve të përfundimit të arsimit të mesëm, jashtë vendit bazuar në vendimin nr.134, datë 7.3.2003 i Këshillit të Ministrave “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit”, të ndryshuar dhe urdhrin nr. 16, datë 11.01.2018 të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për legalizimin e dokumenteve të shkollimit parauniversitar” duhet të dërgoni për legalizim dokumentet e përfundimit të shkollës së mesme, në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar, që i përcjellin me postë në QSHA për të kryer legalizimin. Gjithashtu në vijim pasi të merrni dokumentet e legalizuara në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar, me qëllim përdorimin e dokumenteve jashtë vendit duhet t’i përcillni për t’i vulosur edhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.	Përfunduar	Jo

196	26.09.2024	A ka mundesi tju pyes per nje master Shkencor tek Universiteti i Sporteve te Tiranes,doja pak me shum informacion per keto mastera,sepse dua te regjistrohem. Por te di per cfare funksionon.	26.09.2024	Lutem lidhur me aplikimet në programet e ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave”, drejtohuni institucionit të arsimit të lartë ku do të aplikoni.	Përfunduar	Jo
197	26.09.2024	Jam nje nga studentet e universiteteve te mbyllura ne 2014. Kam ber rregjistrim ne universitetij e mjeksis por skam vazhduar Dua te di a eshte djegur si shkolle ne kaq vite apo ka shance te ta vazhduar ?	01.10.2024	Lutem lidhur me informacionin që kërkoni drejtohuni universitetit ku keni qenë e regjistruar.	Përfunduar	Jo
198	26.09.2024	Referuar njehsimit te diplomes time turke ne shtetin shqiptar , e kam perkthyer dhe njehsuar(noterizuar) me origjinalin pa e apostiluar. A duhej apostiluar per proceduren e njehsimit ne MAS? Dhe nese po, mundet qe ta apostiloj te perkthyeren te noterizuar apo nuk perben problem? Nese keni nje informacion me te gjere, do t'ju lutesha te me informonit!	27.09.2024	Deleguar QSHA-së. Kthim përgjigje nga QSHA-ja 30.0.2024.	Përfunduar	Jo
199	27.09.2024	Kam studiuar nje vit arkeologji dhe trashegimi kulturore te fakulteti i historise dhe filologjise ku jam crregjistruar .Kete vit desha te aplikoj per te studiuar anglisht (studime amerikane dhe britanike) te fakulteti i gjuheve te huaja por me ka kaluar afati i aplikimit AIZ per arsye personale.A eshte e mundur te hapet AIZ per raundin e trete pasi moshapja me rrezikon kete vit shkollor.	01.10.2024 04.10.2024	Ne vijim te kerkeses suaj ju bejme me dije se sipas udhezimit nr. 12, date 30.6.2023 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, lidhur me procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve pas përfundimit të raundit të dytë, parashikohet si më poshtë “1. Pas përfundimit të raundit të dytë, IAL-të, brenda 5 ditëve, përcaktojnë me vendim të Senatit Akademik programet e studimit që nuk aktivizohen në atë vit akademik për shkak se nuk plotësojnë numrin minimal të studentëve të regjistruar për aktivizimin e programit, sipas parashikimeve në aktet e brendshme të IAL-ve. Vendimi i njoftohet ministrisë përgjegjëse për arsimin, QSHA-së dhe studentëve të regjistruar në këto programe, afishohet në mjediset e tyre dhe publikohet në faqen e tyre zyrtare. Sekretaritetë mësimore kryejnë çregjistrimin e këtyre studentëve në datën e përcaktuar në kalendar. 2. Kandidatët e çregjistruar sipas pikës 1 dhe kandidatët që janë pjesë e portalit U-Albania që rezultojnë të pa regjistruar në një program studimi, kanë të drejtën e regjistrimit në programe studimi ku ka kuota të paplotësuara në të gjitha IAL-të, pavarësisht aplikimeve në raundet e mëparshme, mbi bazën e notës mesatare, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, mbi kriterin e notës mesatare dhe kriterëve të tjera të përcaktuara nga IAL-të, sipas afatit të përcaktuar në kalendar.” Sa më sipër, ju bëjmë me dije se pas përfundimit të raundit të dytë, kanë të drejtën e regjistrimit në programe studimi ku ka kuota të paplotësuara në të gjitha IAL-të, kandidatët e çregjistruar sipas pikës 1 dhe kandidatët që janë pjesë e portalit U-Albania që rezultojnë të pa regjistruar në një program studimi. Ju informojmë se me urdhrin nr. 157, datë 3.10.2024 të Qendrës së Shërbimeve Arsimore "Për miratimin e periudhës së aplikimeve me formularin AIZ për MSH 2024" është përcaktuar miratimi i periudhës së	Përfunduar	Jo
200	27.09.2024	Kam mbaruar shkollen e mesme ne viti 1984 dhe doja te dija si te veproj per te marre diplomen e matures. Do iu lutesha per nje pergjigje.	30.09.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se për t'u pajisur me vërtetim mbi përfundimin e arsimit të mesëm duhet t'i drejtoheni shkollës që keni ndjekur.	Përfunduar	Jo

201	30.09.2024	<p>Ju shkruaj për t'ju informuar se kam marrë njohjen nga QSHA për njëvlershmërinë e gjimnazit të përfunduar jashtë vendit. Megjithatë, për momentin nuk kam ID-në e maturantit dhe nuk ka data të tjera për të plotësuar formularin për aplikim. A mund të më informoni ju lutem, nese do te ketë data të tjera për raundin e tretë të aplikimeve? Dhe në rast se jo, çfarë zgjidhje tjetër mund të ketë, në mënyrë që të mos e humbas këtë vit shkollor.</p>	03.10.2024 04.10.2024	<p>Ne vijim të kërkesës suaj ju bejme me dije se sipas udhezimit nr. 12, date 30.6.2023 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, lidhur me procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve pas përfundimit të raundit të dytë, parashikohet si më poshtë</p> <p>“1. Pas përfundimit të raundit të dytë, IAL-të, brenda 5 ditëve, përcaktojnë me vendim të Senatit Akademik programet e studimit që nuk aktivizohen në atë vit akademik për shkak se nuk plotësojnë numrin minimal të studentëve të regjistruar për aktivizimin e programit, sipas parashikimeve në aktet e brendshme të IAL-ve. Vendimi i njoftohet ministrisë përgjegjëse për arsimin, QSHA-së dhe studentëve të regjistruar në këto programe, afishohet në mjediset e tyre dhe publikohet në faqen e tyre zyrtare. Sekretariteti mësimore kryejnë çregjistrimin e këtyre studentëve në datën e përcaktuar në kalendar.</p> <p>2. Kandidatët e çregjistruar sipas pikës 1 dhe kandidatët që janë pjesë e portalit U-Albania që rezultojnë të pa regjistruar në një program studimi, kanë të drejtën e regjistrimit në programe studimi ku ka kuota të paplotësuara në të gjitha IAL-të, pavarësisht aplikimeve në raundet e mëparshme, mbi bazën e notës mesatare, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, mbi kriterin e notës mesatare dhe kriterëve të tjera të përcaktuara nga IAL-të, sipas afatit të përcaktuar në kalendar.”</p> <p>Sa më sipër, ju bëjmë me dije se pas përfundimit të raundit të dytë, kanë të drejtën e regjistrimit në programe studimi ku ka kuota të paplotësuara në të gjitha IAL-të, kandidatët e çregjistruar sipas pikës 1 dhe kandidatët që janë pjesë e portalit U-Albania që rezultojnë të pa regjistruar në një program studimi. Ju informojmë se me urdhrin nr. 157, datë 3.10.2024 të Qendrës së Shërbimeve Arsimore "Për miratimin e periudhës së aplikimeve me formularin AIZ për MSH 2024" është përcaktuar miratimi i periudhës së</p>	Përfunduar	Jo
202	30.09.2024	<p>Lutem nga ana juaj nje informacion sesi mund te njihet nje diplome e shkolles se mesme se shtetit grek ketu ne Shqiperi.</p>	30.09.2024	<p>Deleguar QSHA-së. Kthim përgjigje nga QSHA-ja me datë 09.10.2024.</p>	Përfunduar	Jo
202	30.09.2024	<p>A janë hapur kuota për kolegjin universitar “ëisdom” për sezonin 2024-2025? Cfarë do të ndodhi me studentët që kanë të hapur programe studimi te subjekti “ëisdom”? Cfarë masash janë marrë për kolegjin universitar “ëisdom” pas lajmeve nga vendi fqinj Italia se ky subjekt është nën hetim për rastin e diplomave? A është mbyllur subjekti apo do të qendrojë i hapur? a) A është bërë auditim i këtij subjekti nga Ministria e Arsimit dhe Sportit? b) Nëse është bërë auditim, ju lutemi të na vendosni në dispozicion raportet e përpiluara nga grupi i auditimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.</p>	17.10.2024	<p>Ministria e Arsimit dhe Sportit, bazuar ne aktet nenligjore ne fuqi, te ligjit nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” ka nisur prej vitit 2022 dhe në vijim, procesin periodik të verifikimit të kontrollit të pajtueshmërisë së veprimtarisë të gjithë institucioneve të arsimit të lartë.</p> <p>Në vijim të këtij procesi, në periudhën 2023-2024, MAS, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, përmes grupit të punës të ngritur për këtë qëllim, me përfaqësues të strukturave përgjegjëse të ministrisë, Agjensisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore, ka nisur verifikimin e pajtueshmërisë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të Kolegjit Universitar ëISDOM. Pas procedurave të ndjekura në kuadër të këtij procesi, dhe verifikimeve të kryera përgjatë periudhës së kontrollit në këtë institucion, në përfundim të tij, grupi i punës, në korrik të këtij viti, ka përfunduar raportin final të kontrollit, duke konstatuar shkelje ligjore, gjatë ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të Kolegjit Universitar ëISDOM për periudhën e ushtrimit të kontrollit, referuar dispozitave të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.</p> <p>Nënvizojmë se ndërkohë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, për vitin e ri akademik 2024-2025, nuk ka çertifikuar kuota pranimit për Kolegjin Universitar ëISDOM. Me shkresën nr. 4836 prot., datë 29.07.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit drejtuar Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) me anë të së cilës janë përcjellë kuotat për programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, PIND dhe programet me karakter profesional, të ofruara nga IAL-të, për vitin akademik 2024-2025, është informuar RASH se për Kolegjin Universitar “ëisdom” nuk çertifikohen kuota pranimit për vitin akademik 2024-2025.</p>	Përfunduar	Jo

203	01.10.2024	Gjate viteve 1999 - 2002 kam ndjekur studimet e përgjithshme pranë gjimnazit "Jordan Misja" ne Shkoder. Prej disa vitesh jam residente në Itali ku dhe aktualisht jam duke kërkuar të ndjek studimet e larta, kriter ky i kërkuar nga puna ku ndodhem aktualisht, Ndaj do j'u lutesha nëse mund të informohem nga ju për menyren sesi dhe ku mund të pajisem me program studimor te detajuar që kam ndjekur në periudhën e gjimnazit?	02.10.2024	Deleguar ASCAP. Kthim përgjigje nga ASCAP datë 03.10.2024.	Përfunduar	Jo
204	01.10.2024	Jam regjistruar ne fazen e 1 raundi i 1 tek nje fakultet. A mund te cregjistrohem dot tani me date 8 tetor?	02.10.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion ju bëjmë me dije se bazuar në urdhëzimin nr.12, datë 30.6.2023 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë” lidhur me procesin e çregjistrimit, raundi i pare parashikohet se: 1. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistrin e IAL-së, ka të drejtë të çregjistrohet në datat e përcaktuara në kalendar. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim pranë sekretarisë mësimore të fakultetit ku është regjistruar, duke tërhequr dokumentet e dorëzuara. Nëse nuk e kryen këtë veprim brenda këtij afati, ai nuk ka të drejtë të çregjistrohet, me qëllim regjistrimin në një program tjetër studimi ku është shpallur fitues për atë vit akademik. Çregjistrimi kryhet në portalin U-Albania nga sekretaria mësimore e fakultetit. 2. Sekretaritë mësimore, në përfundim të procesit të çregjistrimit të kandidatëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, përcjellin në portalin U-Albania listën e kandidatëve të çregjistruar në format elektronik, sipas përcaktimeve në kalendar. Afatet për çregjistrimin për raundin e parë dhe të dytë përcaktohen në urdhrin e përbashkët të QSHA dhe RASH nr. 112, datë 05.07.2024 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2024-2025”. Sipas këtij urdhri lidhur me procesin e çregjistrimit, raundi i parë përcaktohet se kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistrin e IAL-së, ka të drejtë të çregjistrohet në datat 14-15 shtator 2024.	Përfunduar	Jo
205	01.10.2024	Kam mbaruar maturen ne vitin 2016 a mund te me informoni si ta marre certifikaten e notave pasi me duhet per regjistrim ne universitet.	02.10.2024	Lidhur me dokumentin që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm të lartë dhe listen e notave drejtohuni shkollës që keni ndjekur.	Përfunduar	Jo
206	01.10.2024	Po ju shkruaj kete email pasi jemi te interesuar per procesin e ekuivalentimit te diplomave te leshuara nga Universiteti Kristal ne shtetin Kanadez.Agjencia e ekuivalentimit ICAS, kerkon qe kopjet e diplomes te dergohen nga aplikanti si dhe nga institucioni akademik qe jane kryer studimet. Ne rastin e Universitetit Kristal, ata na kane komunikuar se diplomat duhet te dergohen me poste nga Ministria e Arsimit. A eshte e mundur kjo?	09.10.2024	Në vijim të kërkesës së paraqitur nga ana juaj ju bëjmë me dije se mund të pajiseni me një vërtetim mbi licencimin dhe akreditimin e programit gjatë kohës së kryerjes së studimeve. Ndërsa në lidhje me të dhënat që rezultojnë në regjistrat e matrikullimit, mund t'i drejtoheni Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk mund të dërgojë diplomat në ICAS, sepse nuk është institucioni përgjegjës për lëshimin e këtij dokumenti.	Përfunduar.	Jo

207	02.10.2024	Kam mbaruar vitin e Tret ne universitetin privat ne Kosove dhe dua ta transferoj ne Shqipëri ca procedura duhen a lejohet.	03.10.2024	Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, janë përcaktuar në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”. Afatet e procedurave janë përcaktuar në urdhrin e përbashkët të QSHA dhe RASH nr. 112, datë 05.07.2024 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2024-2025”. Bashkëlidhur gjeni udhëzimin e MAS nr. 12, datë 30.6.2023 dhe urdhrin e përbashkët QSHA-RASH nr. 112, datë 05.07.2024, të sipërcituar. Për më shumë informacione drejtohuni institucionit të arsimit të lartë ku do të transferoni studime	Përfunduar	Jo
208	03.10.2024	Jam arkitekt me diplom italiane dhe duhet te bej vertetimin e njesimit te diplomes.Si jan procedurat?	04.10.2024	Njohja e diplomave të arsimit të lartë të fituar jashtë vendit kryhet sipas udhëzimit nr. 21, datë 15.10.2021 “Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar”, të ndryshuar të cilin e gjeni të publikuar në linkun https://qzb.gov.al/previeë/67f360eb-676a-4f9e-baa2-df3f3bdb9db4/cons/20240126 Aplikimi kryhet nëpërmjet portalit e-Albania https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=853 Për më shumë informacione drejtohuni Qendrës së Shërbimeve Arsimore si institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin e diplomave.	Përfunduar	Jo
209	03.10.2024	A mund te me jepni informacion si mund ta bej njohjen e diplomes e bachelor dhe master qe kam perfunduar ne Maqedonin e Veriut	07.10.2024	Aplikimi për njohjen dhe njësimin e diplomës/diplomave të fituara jashtë Republikës së Shqipërisë bëhet në portalin e-albania. Pasi të keni noterizuar diplomat edhe listat e notave, të pajisura me vulë apostile, klikoni te linku më poshtë, te butoni "PËRDOR" dhe më pas plotësoni të dhënat tuaja. Për çdo diplomë duhet të bëhet një aplikim dhe pagesa të veçanta. Informacionin e detajuar e gjeni edhe në linkun më poshtë: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=853	Përfunduar	Jo
210	04.10.2024	Kam mbaruar shkollen e mesme pedagogjike Luigj gurakuqi ne Elbasan,do doja nje info nese me nji fet kjo diplom per ciklin e ulet apo duhet te ndjek sdudimet me tej?	09.10.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se bazuar në pikën 2, të nenit 57 të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar parashikohet se: “Mësuesi për arsimin fillor duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë “Bachelor” dhe diplomë të ciklit të dytë “Master Profesional”, që formon mësues të arsimit fillor, ose diplomë për arsimin fillor të ish-instituteve të larta pedagogjike”.	Përfunduar	Jo
211	09.10.2024	Po ju shkruaj per te marre nje informacion lidhur me punesimin tim. Ne udhezimin e nxjerre nga ju thuhej qe portali 2023 eshte deri ne daljen e portalit 2024.Nderkohe te gjitha vendet jane zene nga portali i 2023. Si do veprohet me ne?	10.10.2024	Deleguar AKAP për trajtim. Kthyer përgjigje nga AKAP me datë 10.10.2024. Në përgjigje të problematikës suaj, kujtoj se referuar pikës 1/h të udhëzimit të MAS nr. 19, datë 29.08.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 03.05.2024 “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, të ndryshuar, “5/1 Rezultatet e portalit “Mësues për Shqipërinë”, zbatohen sipas këtij udhëzimi deri në momentin që zëvendësohen nga rezultatet e portalit vijues” Për sa më sipër, duke filluar nga dita e hënë datë 07.10.2024 për vendet e lira të punës ka filluar njoftimi i kandidatëve sipas listës së portalit “Mësues për Shqipërinë” 2024.	Përfunduar	Jo

212	10.10.2024	Listën e detajuar të përfituesve nga programi i ekselencës: Emër Atësia Mbiemër, i cdo përfituesi; Universiteti për të cilin është financuar cdo përfitues gjatë këtyre viteve; Listën e renditjes së universiteteve në nivel globale sipas Time Higher Education, që ka shërbyer si listë e verifikueshme për miratimin e listës fituese dhe financuese. Kjo për vitet nga fillimi i projektit të ekselencës deri në datën e VKM referuese në kontratat e ekselencës ka qënë në fuqi; Procesverbalet për shpalljen e përfituesve sipas viteve akademike për të cilat janë financuar; Shumat e përfituara në mënyrë progressive nga cdo përfitues; Nga verifikimet tuaj në dinamikë, verifikime të detyruara ligjore a garantoni ju se cdo përfitues është financuar për programe universitare në 15 universitet e para të renditjes së universiteteve në nivel global sipas referencës së VKM?; Kërkoj një kopje të këtij verifikimi analitik sipas emrave të përfituesve dhe verifikimin e programeve të financuara të përzgjedhura, për verifikimin e plotësimit të kushtit numër një, që është renditja e 15 universiteteve më të mirë, pasi u financuan; Kërkoj informacion nëse keni raste që përfituesit e këtij programi kanë verifikuar që kanë qënë të papunë nga zyrat e punës dhe kanë qëndruar në Shqipëri vetëm për të plotësuar këtë kusht të kontratës?; Kërkoj listën e përfituesve që keni çuar në gjykatat administrative për mosplotësim të kushteve sipas vlerësimit tuaj; Kërkoj informacion sipas secilit përfitues për verifikimin që keni bërë për plotësimin e kushteve, bazuar në të dhënat tatimore, pjesën e sigurimeve shoqërore. A jeni bazuar tek vet-deklarimi, dorëzim vërtetimesh në mënyrë individuale? I keni kryqëzuar me të dhënat të siguruar në rrugë zyrtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve? ; A keni marrë përgjigje nga ____, sa herë i jeni drejtuar me kërkesë? Si e shpjegoni që për rreth 7 vite keni shkëmbyer vetëm korrespondencë, sa herë ka pasur ndryshime në stafin drejtues në Ministrinë e Arsimit dhe në drejtimin e Projektit të Ekselencës dhe	07.11.2024	Shkresë kthim përgjigje me nr. 6991 prot., datë 07.11.2024	Përfunduar	Jo
213	14.10.2024	Doja te kaloja ne sistem online gjimnazin. Nese jam e sakte keshtu me thane. Dua te vazhdoj shkollen e larte por nuk mundem sepse gjimnazi Univers neteork nuk i ka ne sistem onl.sepse mesa di eshte mbyllur. Cfare procedure duhet ndjekur? Une e kam kryer shkollen ne 2005-2009.	17.10.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se për të aplikuar për regjistrimin në programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë duhet të plotësoni formularin A1Z në datat e përcaktuara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore. Në rastin kur shkolla e mesme është mbyllur, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar cakton një shkollë të vetme, në të cilën kandidatët bëjnë plotësimin e formularit A1Z.	Përfunduar	Jo
214	15.10.2024	Informacion lidhur me mesataren e regjistrimit në Universitetin "Luigj Gurakuqi".	28.10.2024	Në vijim të kërkesës suaj të përcjellë në adresën e koordinatorit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ju bëjmë me informojmë si më poshtë: Bazuar në vendimin nr. 436, datë 3.6.2020 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, të ndryshuar në shkronjën “c”, pika 1 parashikohet se: “Në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë, të përcaktuara në shtojcën nr. 2, të këtij vendimi, minimalisht me notë mesatare 7.5 (shtatë pikë pesë).”	Përfunduar	Jo
215	15.10.2024	Jam interesuar te rregjistrohem ne arsimin e mesme ,per arsye emigrimi nuk e perfundova, doja informacion si mund te rregjistrohem ne shkollen Kostandin ne Tirane. Faleminderit dhe shpresoj ndihmoni me nje informacion.	15.10.2024	Deleguar AKAP.	Përfunduar	Jo

216	16.10.2024	Kam perfunduar Bachelorin 3 vite per Anglisht tek Fakulteti I Gjuheve te Huaja Tirane . Dhe master "Menaxhim Arsimit" tek fakulteti Mesdhetar . Si mund te aplikoj per te bere lishencen e mesuesise. Ku duhet te drejtohem ?	17.10.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se sipas nenit 5, e kreut 15 të rregullores “Për funksionimin e komisionit të provimit të shtetit dhe procedurat e zhvillimit të provimit të shtetit”, të miratuar me urdhrin nr. 365, datë 28.12.2020 të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, parashikohet se kandidati për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit aplikon on-line në portalin qeveritar në e-Albania për regjistrimin në povimet e shtetit. Aplikimi on-line kryhet deri në 4 javë para fillimit të sezonit të provimit të shtetit. Kandidatët që aplikojnë për provimin e shtetit duhet të kenë kryer me sukses praktikën profesionale. Për më shumë informacione rregullore “Për funksionimin e komisionit të provimit të shtetit dhe procedurat e zhvillimit të provimit të shtetit” e gjeni në linkun https://qsha.gov.al/ep-content/uploads/2023/08/rregullore_komision_procedura.pdf	Përfunduar	Jo
217	17.10.2024	Jam studente xx me nr personal xxxxxxxxxx , dua te di cfare numri matrikullimi kam ose ku mund ta gjej ate.	22.10.2024	Në vijim të kërkesës suaj të përcjellë në adresën e koordinatorit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit me anë të së cilës kërkoni informacion lidhur me numrin e matrikullimit, sqarojmë se duhet t'i drejtoheni institucionit të arsimit të lartë ku keni ndjekur studimet ose jeni në ndjekje të studimeve.	Përfunduar	Jo
218	17.10.2024	Jam i certifikuar si oficer sigurie ,jam ne listë pritje i pari për Elbasanin . Doja të thoja në Elbasan ka 3_4 Shkolla që e kalojnë numrin mbi 600 nxënës me këtë VKM e re që u miratua nga ju . Gjithashtu është dhe një shkollë ku oficeri është larguar dhe vëndi është bosh . Kur do emërohem në këto shkolla ? Zva Elbasan thotë ja kemi dërguar kërkesat DRAP Korçë. DRAP thotë e ka kompetencën Ministria për emërimin .	30.10.2924	Në lidhje me kërkesën tuaj për punësim si oficer sigurie ju sqarojmë se, institucionet të cilat duhet të kenë oficerë sigurie, janë përcaktuar me urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 542 prot., datë 15.09.2022, “Për përcaktimin e institucioneve të arsimit parauniversitar që do të kenë oficerë sigurie”.	Përfunduar	Jo
219	18.10.2024	Doja te informohesha nese e kam akoma nr e Matrikullimit NIM aktiv pasi ne vitin 2019 jam rregjistruar ne UET (Universiteti European i Tiranes).	21.10.2024	Në vijim të kërkesës suaj të përcjellë në adresën e koordinatorit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit me anë të së cilës kërkoni informacion lidhur me numrin e matrikullimit, sqarojmë se duhet t'i drejtoheni institucionit të arsimit të lartë ku keni ndjekur studimet ose jeni në ndjekje të studimeve.	Përfunduar	Jo
220	20.10.2024	1. Si mund të aplikoj për njohjen e diplomës nga nje universitet ne SHBA në Shqipëri? Cilat janë institucionet përkatëse ku mund te drejtohem? A njihet diploma a Punonjese Sociale nga SHBA? Cfar Kerkesash ka shteti shqiptar per te lejuar mundesin e punesimit e praktikimit te profesjonit te Punonjese sociale ne Shqiperi? 2. Cilat janë kërkesat për licencim në Shqipëri? A janë të nevojshme trajnime shtesë apo provime? 3. Ku mund të informohem për rregulloret lokale për praktikën profesionale, të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale?	29.10.2024	Në vijim të kërkesës suaj, të paraqitur në adresën e koordinatorit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) sa i takon kërkesave që lidhen me fushën e përgjegjësisë shtetërore të MAS ju bëjmë me dije si më poshtë: Bazuar në udhëzimin nr. 21, datë 15.10.2021 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar”, të ndryshuar parashikohet se Qendra e Shërbimeve Arsimore është institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të “Diplomave profesionale/certifikatave profesionale”, diplomave “Bachelor”, diplomave “Master i shkencave”, “Master i arteve” dhe “Master profesional”, “Master ekzekutiv”, “Diploma të specializimit afatgjatë”, të fituar jashtë vendit. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve që i përkasin nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare, Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, si dhe titujve akademikë kryhet Online nëpërmjet portalit e-Albania në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=853	Përfunduar	Jo

221	21.10.2024	Kam bere nje kerkese para pak ditesh tek ju mbi rregjistrimin tim tek Universiteti Aleksander Moisiu ne degen administrim biznesi anglisht.Problemi qendron tek crregjistrimi im nga kjo dege.Me telefonuan per te me bere me dije qe isha e vetmja ne kete klase dhe qe duhej te crregjistrohesha .Per arsye shendetesore une nuk u paraqita dhe nuk munda ta kryeja si procedure.Nga ju kerkoj nje menyre zgjidhjeje ose nje udhezim se cfare duhet te bej ne menyre qe te vazhdoj kete vit akademik.	25.10.2024	Në vijim të kërkesës suaj të përcjellë në adresën e koordinatorit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ju bëjmë me dije se bazuar në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar dhe në urdhrin e përbashkët të QSHA dhe RASH nr. 112, datë 05.07.2024 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2024-2025” parashikohet si vijon: Pas përfundimit të raundit IAL-të brenda datës 8 tetor 2024 përcaktojnë me vendim të Senatit Akademik, programet e studimit që nuk aktivizohen në atë vit akademik për shkak se nuk plotësojnë numrin minimal të studentëve të regjistruar për aktivizimin e programit, sipas parashikimeve në aktet e brendshme të IAL-ve. Vendimi i njoftohet ministrisë përgjegjëse për arsimin, QSHA-së dhe studentëve të regjistruar në këto programe, afishohet në mjediset e tyre dhe publikohet në faqen e tyre zyrtare. Sekretaritetë mësimore kryejnë çregjistrimin e këtyre studentëve në datën 9 tetor 2024. Kandidatët e çregjistruar sipas pikës 1 dhe kandidatët që janë pjesë e portalit U-Albania që rezultojnë të pa regjistruar në asnjë program studimi, kanë të drejtën e regjistrimit në programe studimi ku ka kuota të paplotësuara në të gjitha IAL-të, pavarësisht aplikimeve në raundet e mëparshme, në periudhën 10-25 tetor 2024. Sekretaritetë mësimore kryejnë regjistrimin e këtyre studentëve brenda datës 25 tetor 2024 në portalin UAlbania. Për më shumë informacione lutem drejtohuni institucionit të arsimit të lartë ku jeni regjistruar.	Përfunduar	Jo
222	22.10.2024	Kërkesë për informacion se si mund të pajiset me vertetim për njësimin e diplomës të kryer jashtë vendit në Minitrinë e Arsimit dhe Sportit.	24.10.2024	Në vijim të kërkesës suaj, ju bëjmë me dije se për t'u pajisur me një kopje vërtetimi të njësimi të diplomës duhet të përcillni një kërkesë zyrtare me postë drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, shoqëruar me një kopje ID.	Përfunduar	Jo
223	22.10.2024	Tani kemi ardhur nga Turqia jetoj ne Tiran me 2 femijet. Kam vajzen dua ta regjistroj per shkoll te lart eshte me mesatare 9.5 me thon jan plotesuar vendet nuk dua qe vajza ta humbas vitin shkollor ju lutem me informoni.	28.10.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se për ndjekjen e studimeve në institucionet e arsimit të lartë, duhet të aplikoni për formularin A1Z. Sipas urdhrin të përbashkët nr. 661, datë 1.12.2023 të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e maturës shtetërore në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se plotësimi i formularit A1Z për kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit bëhet në shkollën e caktuar në nivel ZVAP-je. Gjithashtu bazuar në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë” parashikohet se: “Për kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit dhe që kanë aplikuar me formularin A1 dhe A1Z, drejtoritë e institucioneve arsimore përkatëse, të caktuar nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, nga ku ata kanë kryer aplikimin, hedhin në sistemin SMIP të dhënat e lidhura me rezultatet e njehsuara të shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë.” Sa më sipër, ju informojmë se me urdhrin nr. 160, datë 25.10.2024 të Qendrës së Shërbimeve Arsimore "Për miratimin e periudhës së aplikimeve me formularin AIZ për MSH 2024" është përcaktuar miratimi i periudhës së aplikimeve me formularin AIZ, për MSH 2024, në datën 28 Tetor 2024, ora 08.00 - 16.00.	Përfunduar	Jo

224	23.10.2024	Informacion lidhur me diplomën.	28.10.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se bazuar në pikën 1, të nenit 124, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" parashikohet se: "Diplomat e programeve të studimit, që kanë zgjatur 3 vite (6 semestra), janë ekuivalente me diplomat "Bachelor". Sipas kopjes së diplomës bashkëlidhur, programi rezultoi të ketë pasur kohëzgjatje 3-vjeçare. Për të konfirmuar/verifikuar autenticitetin e diplomës, formën e studimeve, si dhe kohëzgjatjen zyrtare normale të programit të studimit përkatës, duhet t' i drejtoheni institucionit të arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën.	Përfunduar	Jo
225	25.10.2024	1. Cili ka qenë sipas Ministrisë suaj afati i fundit për mbrojtjen e Doktoraturë për të regjistruarit në vitin akademik 2012-2013 (lutem referohuni nenit specifik të kuadrit ligjor në rregulloren përkatëse të asaj periudhe kohore, përfshirë rastet përjashtimore nisur nga bllokimi i përkohshëm i tyre).	15.11.2024	Në nenin 134 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" citohej se: "1. Studentët, të cilët kanë nisur programet e studimit të doktoratës para hyrjes në fuqi të këtij ligji, i përfundojnë ato sipas kriterëve dhe modaliteteve të legjislationit të kohës kur këta studentë janë pranuar. 2. Përcaktimet e këtij ligji mbi kohëzgjatjen e programeve të studimit zbatohen për studentët që nisin studimet pas hyrjes në fuqi të ligjit." Për sa më sipër, ligji nr. 80/2015 ka përcaktuar se aspektet që lidhen me programet e doktoratës që kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të trajtohen nga kuadri rregullator që ka qenë në fuqi para hyrjes në fuqi të ligjit 80/2015, përkatësisht do të rregullohet nga ligji nr. 9741 datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet nënligjore për zbatim të tij dhe aktet e brendshme (statute, rregullore të programeve të studimit, etj.) të institucioneve të arsimit të lartë që i ofronin këto programe studimi.	Përfunduar	Jo
226	27.10.2024	Po ju shkruaj për të kërkuar një informacion në lidhje me përfundimin e gjimnazit. Kam përfunduar vetëm 2 vite nga gjimnazi dhe jam shkeputur në vitin 2017 për arsye emigracioni. Me ka mbetur pa përfunduar viti i 3 dhe dua ta përfundoj. Gjimnazin e kam bërë në gjimnazin Partizani në Tiranë. Mund të kem një informacion nga ju se si mund ta përfundoj ose ku duhet të drejtohem për përfundimin e gjimnazit? Do isha shumë mirënjohës nëse mund të më jepni detaje për tu orientuar se ku duhet të drejtohem.	28.10.2024	Deleguar nga AKAP. Në përgjigje të kërkesës suaj në lidhje me informacionin që ju kërkoni, për sa i përket procedurave për regjistrimin në shkollë dhe përfundimin e arsimit të mesëm, Zyra Vendore Arsimore Tiranë ju bën me dije sa më poshtë vijon: Në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi, të Ligjit Nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, të urdhërit Nr. 31, datë 28.01.2020 "Për miratimin e rregullorës për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit Nr.21, datë 18.08.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e gjimnazit me kohë të pjesshme", dhe të Udhëzimit Nr.23, datë 26.09.2016 "Për një ndryshim në udhëzimin Nr.21, datë 18.06.2016" në nenin 3 (mbi 18 vjeç). Referuar informacionit zyrtar marrë nga stafi drejtues i gjimnazit "Partizani" Tiranë konfirmojnë gjeneralitet tuaja, numrin e amzes dhe vitet shkollore kryer nga ana juaj, përkatësisht (klasa e X -të në vitin shkollor 2015-2016, dhe klasa e XI-të në vitin shkollor 2016-2017). Nisur nga këto të dhëna, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, ju bëjmë me dije se ju keni të drejtë të përfundoni arsimin e mesëm me kohë të shkurtuar (mbi 18 vjeç) pranë institucionit shkollor "Kostandin Kristoforidhi" Tiranë. Kërkesë e cila duhet të ishte deleguar nga ana juaj për t'u trajtuar pranë ZVA Tiranë, për të caktuar ekuivalencat, detyrimet shkollore, klasën etj, sipas afatve kohore të përcaktuara për regjistrimin në shkollë me kohë të shkurtuar. Në këto kushte, kur kanë kaluar shtatë javë mësimore, regjistrimi në këtë institucion arsimor për vitin shkollor 2024-2025 është i pamundur ligjrisht.	Përfunduar	Jo

227	28.10.2024	Me duhet vetem per nje vule ne vertetimin e shkolles qe e kam mbaruar ne vitin 2001 .	06.11.2024	<p>Në vijim të kërkesës suaj të përcjellë në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ju bëjmë me dije se është i paraqartë dokumenti për të cilin kërkonti vulën e MAS.</p> <p>Gjithashtu ju informojmë se sipas urdhrit nr. 16, datë 11.01.2018 të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për legalizimin e dokumenteve të shkollimit parauniversitar” parashikohet se legalizimi i dokumentave të përfundimit të shkollimit të arsimit parauniversitar, kryhet nga QSHA-ja. Dokumentat e përfundimit të shkollimit të arsimit parauniversitar, që do të pranohen për legalizim në QSHA janë:</p> <p>Dëftesa e arsimit bazë Diploma e Maturës Shtetërore Certifikata e notave të Maturës Shtetërore Dëftesa/t e klasës Diplomat e përfundimit të shkollave private të arsimit të mesëm të lartë të licencuar, të cilat mund të jenë të një institucioni të huaj ose të ngjashëm me të.</p> <p>Dokumentin që kërkonti të legalizoni duhet ta dorëzoni pranë zyrës vendore arsimore përkatëse që e dërgojnë me postë në QSHA. Legalizimi kryhet brenda 5 ditëve nga momenti i protokollimit në QSHA</p>	Përfunduar	Jo
228	28.10.2024	<p>A e ka ndjekur Ministria e Arsimit dhe Sportit, denoncimin tim publik organ i MAS —it mbi abuzimet me dëftesat për nxënësit braktisës, në shkollën 9 vjeçare Androkli Kostallari” Tiranë (emërtuar më pas ” Marie Logoreci”), nga ana e drejtorit në atë kohë, më pas emëruar nëndrejtor po aty, në vitin 2014, për që kurrë nuk u shpall konkursi për emërimin e tij si nëndrejtor.</p> <p>A është informuar MAS, nga Inspektoriati Shtetëror Arsimit (ISHA), mbi një denoncim që unë kam bërë në vitin 2017, tek Kryeinspektori, duke ftuar të verifikonin rastin, "për shitjen nxënësve në klasat ku unë jepja mësim, të Fletëve të Punës së Matematikës", të cilat ishin jashtë Katalogut të miratuar nga MAS (sigurisht pa pullë), pasi të gjithë nxënësit e nxorrën këtë në orë të mësimit, duke deklaruar se ua shisnin si pjesë e paketës.</p> <p>Nwse keni inspektuar shkollat për "Braktisjen e shkollës" / nëse është</p>	25.1.2024	<p>Referuar shkresës me lëndë “Kërkesë për informacion”, ju bëjmë me dije se:</p> <p>Në vijim të pyetjes së parë bëjmë me dije se bazuar në vendimin nr. 99, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar”, të ndryshuar, KREU III, “Organizimi dhe funksionimi Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar”, pika 9, gërma a “Drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar janë përgjegjëse për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tyre, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar në nivel rajonal dhe kryejnë këto detyra:</p> <p>a) Menaxhojnë, mbikëqyrin, vlerësojnë dhe kontrollojnë institucionet</p>	Përfunduar	Jo
229	29.10.2024	Ne baze te plotesimit te formularit A1/A1Z qe kishte qene dje interesohem nese eshte e mundur te realizohet sot, ose nese do te kete date tjeter per aplikim per kete vit akademik?	11.06.2024	<p>Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se plotësimi i formularit A1Z kryhet vetëm në datat e përcaktuara me urdhër të Qendrës së Shërbimeve Arsimore.</p> <p>Urdhri i QSHA-së për hapjen e aplikimeve për formularin A1Z publikohet në faqet zyrtare të QSHA-së dhe MAS.</p>	Përfunduar	Jo
230	29.10.2024	Ju lutem isha e interesuar nese eshte e mundur dikush qe ka mbaruar ekonomik mundet te punoj ne sektorin e arsimit. Cfar kriteresh duhen qe te jesh pjes e arsimit.	06.11.2024	<p>Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije si më poshte:</p> <p>Bazuar në pikën 4, të nenit 57 të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar parashikohet se profesioni i mësuesit mund të ushtrohet edhe nga individë që zotërojnë diplomë universitare të ciklit të parë dhe të dytë ose diplomë universitare të integruar, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar, dhe njohuri të certifikuar në formimin psikopedagogjik nga institucione të arsimit të lartë, që ofrojnë programe të studimeve të formimit të vazhduar.</p> <p>Në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2023 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike”, të ndryshuar, parashikohen diplomat e njëvlershme, të ngjashme ose përafërta për ushtrimin e profesionit të mësuesit dhe kriteret për ushtrimin e profesionit të mësuesit.</p> <p>Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2023 të ministrit të Arsimit dhe Sportit, të ndryshuar e gjeni të publikuar në Qendrën e Botimeve Zyrtare në linkun https://ëëë.qbz.gov.al/previeë/ecf050ca-3113-45a7-a913-9109e4ff425d/cons/20230327</p>	Përfunduar	Jo

231	1.11.2024	Informacion lidhur me pagën dhe nivelin e diplomës për pozicionin "Përgjegjës Sektori" në Qendrën Kombëtare të Fëmijëve.	06.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj të përcjellë në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ju bëjmë me dije se pagat e punonjësve të arsimit parauniversitar përllogariten dhe paguhen mbështetur në kriteret e miratuara me vendimin nr. 425, datë 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar". Grupi i diplomës dhe paga e pozicionit për "Përgjegjës sektori në Qendrën Kulture të Fëmijëve", është përcaktuar në lidhjen nr.3. të këtij vendimi.	Përfunduar	Jo
232	1.11.2024	Desha të interesohen për atë se si bëhet seleksionimi i përfaqësuesve të Shqipërisë në olimpiadat ndërkombëtare të informatikës (si IOI, BOI etj.) dhe për atë se a ka mundësi të konkurroj si shtetas i një shteti tjetër (si një Shqipëtar nga Republika e Maqedonisë së Veriut). Shpresoj se mund të më ndihmoni sepse nuk isha në gjendje të gjej asnjë informatë online.	07.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se bazuar shkronjën "a", pika 1, e nenin 8, të rregullores për zhvillimin e olimpiadave kombëtare në arsimin parauniversitar dhe pjesëmarrjen e nxënësve në olimpiadat ndërkombëtare, miratuar me urdhrin nr. 24, datë 23.01.2020, "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e olimpiadave kombëtare në arsimin parauniversitar dhe pjesëmarrjen e nxënësve në olimpiadat ndërkombëtare", përcaktohet se: "Nxënësit që kanë fituar tre vendet e para në olimpiadat kombëtare, në lëndët përkatëse në arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë parauniversitar, kanë të drejtë të marrin pjesë në olimpiadat ndërkombëtare, të shoqëruar nga mësuesit/trajnerët, të caktuar me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit (MAS)." Për më shumë informacion urdhrin nr. 24, datë 23.01.2020 e gjeni të publikuar në linkun https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2020/11/URDH%C3%8BR-NR.-24-DAT%C3%8B-23.01.2020.pdf	Përfunduar	Jo
233	04.11.2024	Desha të pyes nëse ka shkolla gjimnaz part-time në vendin tonë. Nëse po, do të isha mirënjohës nëse mund të më ofroni ndonjë kontakt për të pyetur rreth rregjistrimeve.	06.11.2024	Deleguar AKAP. Kthimi i përgjigjes si vjon: "Në përgjigje të emailit tuaj lidhur me regjistrimin në gjimnazin me kohë të pjesshëm, Ju informojmë se në vendin tonë ka 4 institucione arsimore me kohë të pjesshme dhe 12 institucione arsimore të cilët përfshijnë dy cikle (gjimnaz të përgjithshëm dhe gjimnaz me kohë të pjesshëm) në juridiksionin e Zyrës Vendore Arsimore Tiranë; Durrës; Fier; Berat; Dibër; Krujë; Gjirokastrë; Vlorë; Elbasan; Korçë; Librazhdë; Skrapar-Polican; Kukës; Lezhë; Pukë. Lutem drejtohuni pranë Zyrës Vendore Arsimore ku ju keni qendrën e banimit (ose pranë saj) për të marrë informacionin e nevojshëm."	Përfunduar	Jo

234	04.11.2024	Jam i interesuar te di nese me duhete ndonje vule ne diplomen e shkolles se mesme pasi tani jane elektronisht , per te aplikuar ne universitet jashte shteti (Bullgari), Une kam mbaruar shkollen profesionale kamez , dhe tek universiteti ku do aplikoj me kane kerkuar nje leter qe une jam i afte te vazhdoj arsimin e larte me kete diplome , dhe do doja te dije nese kjo letra merret tek shkolla ose tek ministria e arsimit .	19.11.2024	Sipas vendimit nr.134, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në republikën e shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit”, të ndryshuar me qëllim përdorimin e dokumentit jashtë vendit duhet ta dërgoni për vullë në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Gjithashtu sqarohet se lidhur me formën se si kërkohet dokumentacioni për të aplikuar në një institucion të arsimit të lartë jashtë vendit duhet t’i drejtoheni institucionit ku aplikoni. Lidhur me pranimin në programet e studimit në arsimin e lartë bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se: “ 1. Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. 2. Institucionet e arsimit të lartë mund të vendosin edhe kritere shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilat shpallen nga institucioni i arsimit të lartë dhe vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.” Me vendimin nr. 436, datë 3.6.2020 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, parashikohet kriteri i notës mesatare. Institucionet e arsimit të lartë mund të vendosin edhe kritere shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve.	Përfunduar	Jo
235	05.11.2024	Kerkoj informacion ne lidhje me njohjen e diplomes. Kam diplome masteri te leshuar nga Anglia dhe vulen Apostille mund ta marr online duke marre konfirmimin nga Shkolla. Pyetja ime eshte a pranohet apostille online sepse me thane qe tani kjo eshte menyra qe merret vula Apostille dhe ka te njejten vlere me ate te stampuar pasi merret konfirmimi i shkolles.	07.11.2024	Deleguar për trajtim Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Kthim përgjigje me datë 13.11.2025 si vijon "QSHA pranon dokumentet me vullë apostile elektronike, por ju sugjerojmë që më parë të interesoheni pranë një noteri në Republikën e Shqipërisë nëse i noterizon dokumentet me këtë "Iloj" vule apostile, pasi ka pasur raste që noterët kërkojnë vullë apostile tradicionale që merret pranë noterit në Angli dhe nuk i noterizojnë dokumentet me vullë apostile elektronike."	Përfunduar	Jo
236	05.11.2024	Mund të bëj një pyetje për njohjen e diplomave të huaja për ciklin e parë.Unë kam diplomë te ciklit e parë nga Universitet grek në Athinë.Dua të njoh diplomën time në Shqipëri. Ne e-Albania shkruan: - Diploma/certifikata, ose dokumenti zyrtar përkatës në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, të pajisur me vullë apostile dhe të noterizuar, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë Unë i kam pajisur me vullë apostile , diplomën, certifikatën e diplomimit dhe listën e notave të mia , nga zyra kompetente e Rajonit Administrative të Atikës në Athinë. Unë dua te pyes Diploma, certifikata e diplomimit dhe lista e notave duhet të jene e noterizuar nga noter në Shqipëri apo nga noter ose avokat ne Greqi.	06.11.2024	Deleguar për trajtim Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Kthim përgjigje me datë 13.11.2025 si vijon "Diploma dhe lista e notave duhet të përkthehet nga një përkthyes zyrtar në Republikën e Shqipërisë dhe më pas të noterizohet nga një noter në Republikën e Shqipërisë. Pra diploma dhe lista e notave duhet të pajisjen me "Vërtetim përkthimi" (përkthimi) dhe "Vërtetim njësia me origjinalin" (noterizimi) në Republikën e Shqipërisë."	Përfunduar	Jo
237	05.11.2024	Sa shkolla 9-vjeçare dhe gjimnaze kemi në Tiranë? Në cilat shkolla bëhet mësimi me dy turne? Në cilat shkolla kemi numër më të lartë të nxënësve që duhet të jenë në klasa? Shkollat me numër nxënësish mbi standarden, sa ndikon në cilësinë e mësimdhënies? A janë pajisur shkollat me njetet didaktike për procesin e mësimdhënies? A kemi shkolla që kanë probleme me mungesë stafi?	13.11.2024	Kthim përgjigje ga Agjencia Kombetare e Arsimit Parauniversitar (AKAP).	Përfunduar	Jo
238	06.11.2024	Doja tju beja nje pyetje dhe kam nevoj per pergjigjen tuaj, u rregjistrova dje ne degen profesionale 1 vjecare Per Udherrefyes turistik per zonen e jugut Ne universiten e vlores dhe sot dua te crregjistrohem prej atje, a kam mundesi te crregjistrohem?	06.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se datat për kryerjen e ç’regjistrimeve, pas çdo rraundi regjistrimesh janë të përcaktuara në urdhrin e përbashkët të QSHA dhe RASH nr. 112, datë 05.07.2024 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2024-2025”, të ndryshuar. Për më shumë informacion lutem drejtohuni institucionit të arsimit të lartë ku jeni regjistruar.	Përfunduar	Jo

239	06.11.2024	1. Ju lutem na vendosni ne dispozicion sa shkolla profesionale jane shtuar nga viti 2017 deri me tani(nentor 2024)? 2. Cila bashki aktualisht ka shkolla profesionale (Lutemi, specifikoni bashkite)? 3. Sa profile janë gjithesje ne shkollat profesionale ne te gjithë vendin?	06.11.2024	Deleguar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.	Përfunduar	Jo
240	06.11.2024	Ne rast se nuk kemi nje kopje te defteses se gjimnazit mund te kerkojme nje dublikate dhe cfare rruge duhet ndjekur?	06.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se nuk lëshohet dublikatë diplome, por mund t'i drejtoheni shkollës që keni ndjekur për tu pajisni me vërtetim mbi përfundimin e arsimit të mesëm të lartë.	Përfunduar	Jo
241	06.11.2024	Sapo kam përfunduar studimet Bachelor dhe jam regjistruar për programin e Masterit Shkencor në Universitetin Politeknik të Tiranës. Megjithatë, për arsye personale dhe profesionale, kam vendosur të ndërpres regjistrimin në këtë program. Pavarësisht përpjekjeve të mia për të kryer çregjistrimin, sekretaria e programit nuk e ka miratuar kërkesën time, duke më lënë në një situatë të pasigurt. Unë besoj se kam të drejtë të kryej këtë çregjistrim, ndaj po ju drejtohem për të kërkuar mbështetjen tuaj në zgjidhjen e kësaj çështjeje. Ju lutem të më ndihmoni për të realizuar procedurën e çregjistrimit sipas rregulloreve në fuqi. Nëse është e nevojshme, jam e gatshme të dorëzoj dokumentacionin përkatës dhe të ndjek çdo udhëzim shtesë për të përmbushur kërkesën time.	20.11.2024	Deleguar Universitetit Politeknik të Tiranës.	Përfunduar	Jo
242	07.11.2024	Do te doja nje informacion per Diplomen e Arsimit te Mesem! Me ka humbur Diploma edhe nuk di se cfare procedurash duhet te ndjek per ta rimare serish, pasi ne portalin e-Albania nuk mund ta marr si sherbim. Kam qene Matura 2008!	07.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se nuk lëshohet dublikatë diplome, por mund t'i drejtoheni shkollës që keni ndjekur për tu pajisur me vërtetim mbi përfundimin e arsimit të mesëm të lartë.	Përfunduar	Jo
243	07.11.2024	Une jam e punesuar me kontrate si psikologe ne shkolle. Kam nje bebe 3 javeshe, por nuk kam marr raport lindje dhe kam dal ne pune. Pergjegjesja e ZVAP, me thote ose te kaloj ne raport 6 muaj ose nese zgjedh punen te mos shkeputem asnje minute per te shikuar bebin. Ju lutem , a ka ndonje VKM ose udhezim qe lejon nenat e punesuara ne arsim te largohen gjate orarit te punes per pak minuta, deri sa femija te mbush 1 vjec.	18.11.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj nëpërmjet së cilës kërkonti informacion nëse nënat e sapolindura të cilat nuk kanë marrë raport lindje, mund të shkëputen gjatë orarit të punës për t'u kujdesur për fëmijën, ju bëjmë me dije se sipas pikës 2 dhe 3 të nenit 105 të ligjit nr . 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar parashikohet se: “2. Pas periudhës 63 ditore të paslindjes, gruaja vendos vetë nëse dëshiron të punojë ose të përfitojë nga sigurimet shoqërore. 3. Nëse gruaja vendos, me dëshirën e saj, të punojë pas periudhës 63 ditore të paslindjes, në marrëveshje me punëdhënësin, për ushqyerjen e fëmijës ka të drejtë që, deri sa fëmija të mbushë 1 vjeç, të zgjedhë: a) një pushim të paguar, prej 2 orësh, brenda kohëzgjatjes normale të punës; ose b) kohëzgjatje pune, të reduktuar me 2 orë, me pagë të njëjtë, sikur të kishte punuar për kohëzgjatjen normale ditore të punës.”	Përfunduar	Jo
244	08.11.2024	A mund të lëshojë ministria dublikatë dilome.	13.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se nuk lëshohet dublikatë diplome, por mund t'i drejtoheni shkollës që keni ndjekur për t'u pajisur me vërtetim mbi përfundimin e arsimit të mesëm të lartë.	Përfunduar	Jo
245	08.11.2024	Po kërkoj informacion mbi procedurat për marrjen e një vërtetimi që dëshmon përfundimin tim të arsimit të mesëm (gjimnazit) në Shqipëri. Aktualisht posedoj certifikatën e pjekurisë, por më duhet një dokument shtesë që vërteton përfundimin e shkollës së mesme (gjimnazin). Do të isha mirënjohës nëse mund të më informoni mbi hapat e nevojshëm për të përfituar këtë vërtetim dhe për dokumentacionin e kërkuar për të përfunduar procesin.	15.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj të paraqitur në adresën e koordinatorit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ju bëjmë me dije se për tu pajisur me vërtetim mbi përfundimin e arsimit të mesëm të lartë duhet t'i drejtoheni shkollës që keni ndjekur.	Përfunduar	Jo

246	08.11.2024	Informacion lidhur me përfitimin e bursës për studentët që kanë njërin prind invalid.	15.11.2024	<p>Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se bazuar në pikën 5 të vendimit nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar parashikohet se:</p> <p>“5. Studentë në nevojë konsiderohen:</p> <p>a) studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike;</p> <p>b) bashkëshortët që kanë fëmijë dhe janë të dy studentë, përfitojnë secili bursë financiare;</p> <p>c) studentët, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;</p> <p>ç) studentët që i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;</p> <p>d) studentët që i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton;</p> <p>dh) studentët, të tretët në radhën e fëmijëve e lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë;</p> <p>e) studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;</p> <p>ë) studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç;</p> <p>f) studentët që janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç;</p> <p>g) studentët që janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat të</p>	Përfunduar	Jo
247	08.11.2024	Sa prej objektivave të Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026, janë zbatuar gjatë 3-vjeçarit të parë të implementimit të kësaj strategjie, për sa u përket shkollave fillore dhe 9-vjeçare? (cikël i ulët dhe i lartë)	15.11.2024	<p>Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se grupet tematike vijojnë monitorimin e zbatimit të masave periodikisht. Aktualisht jemi në fazën e vlerësimit të zbatimit të ndërmjetëm të strategjisë, me mbështetjen e konsulentëve ndërkombëtarë. Konkluzionet do të publikohen së shpejti në faqen eeb të MAS.</p>	Përfunduar	Jo
248	08.11.2024	Kam mbaruar studimet ne degen e Fizikes ne Fakultetin e Shkencave te Natyres, master shkencor MSC ne vitin 2018. Mund t'ju pyes: A mund te jap mesim ne "arsimin parauniversitar" me master MSC? Nese jo, cfare procedurash duhet te ndjek? Nese po, a duhet te bej praktike fillimisht? Te lutem a mund te kem nje informacion ne lidhje me kete	14.11.2024	<p>Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se bazuar në nenin 57 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar parashikohet se “Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët dhe për arsimin e mesëm të lartë duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë “Bachelor” në fushën/lëndët e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë dhe diplomën e ciklit të dytë “Master” me 120 ECTS në fushën e mësuesisë, që lidhet me programin e studimit të ciklit të parë.” Nëse, diploma master që zotëroni nuk është në fushën e mësuesisë ju bëjmë me dije se në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2023 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike”, të ndryshuar, parashikohen diplomat e njëvlershme, të ngjashme ose përafërta për ushtrimin e profesionit të mësuesit dhe kriteret për ushtrimin e profesionit të mësuesit. Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2023 të ministrit të Arsimit dhe Sportit, të ndryshuar e gjeni të publikuar në Qendrën e Botimeve Zyrtare në linkun https://ëëë.qbz.gov.al/previeë/ecf050ca-3113-45a7-a913-9109e4ff425d/cons/20230327</p>	Përfunduar	Jo

249	08.11.2024	Une qe po ju shkruaj jam nje Oficer Sigurie ne pritje. Doja te dija, do emerohen oficeret te tjere te rinj? Se kryeministri tha qe do emerohen edhe 40 oficeret te rinj.	27.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se sipas vendimit nr. 600, datë 9.10.2018 e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në institucionet e arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerë të sigurisë”, të ndryshuar parashikohet si më poshtë: Miratimi i shërbimit të sigurisë publike në institucionet e arsimit parauniversitar të mesëm të lartë, që kanë jo më pak se 80 nxënës, dhe në institucionet e arsimit parauniversitar bazë, që kanë jo më pak se 600 nxënës. Institucionet e arsimit parauniversitar, që kanë shërbim të sigurisë publike, përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.	Përfunduar	Jo
250	09.11.2024	Jam nje ish-maturant i diplomuar ne vitin shkollor 2023-2024. Pasi kam lexuar udhezimet tuaja per kushtet e nevojitura qe duhen plotesuar per nje maturant qe te jete maturant ekselent e per rrjedhoje ne fitimin e nje medaljeje vura re qe i plotesoja keto kushte. Pasi u informova me tej plotesova te dhenat e mia qe u derguan ne ZVA dhe jam ne pritje te nje pergjigje nga ju per daten e zhvillimit te ceremonise. Do te doja te pyesja paraprakisht per nje date te perafert te zhvillimit te kesaj ceremonie per arsye organizimi dhe pergatitjeje.	15.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju informojmë se procedurat e “Medaljes së artë” janë në proces. Kandidatët që përfitojnë “Medaljen e artë” do të njoftohen përmes postës elektronike për datën e zhvillimit të ceremonisë së shpërndarjes së “Medaljeve të arta”.	Përfunduar	Jo
251	12.11.2024	1-Sa shkolla 9-vjecare dhe gjimnaze shtetërore janë mbyllur nga periudha 2013-2024? Ju lutem, më specifikoni dhe qytetet, komunat, apo fshatrat ku janë mbyllur këto shkolla? 2- A mund të më vendosni në dispozicion, numrin e nxënësve për cdo shkollë të vendit 9-vjecare dhe gjimnaz? Numri në klasa do të ishte perfekt, por është shumë mund për ju, kam përshtypjen.	19.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se të dhënat lidhur me institucionet e arsimit parauniversitar dhe numrin e nxënësve, i gjeni të publikuara në vjetarin statistikor në faqen zyrtare të MAS dhe në faqen zyrtare të Institutit të Statistikave (INSTAT). https://arsimi.gov.al/statistika-2/ https://ëëë.instat.gov.al/al/publikime/librat/2023/vjetari-statistikor-rajonal-2023/ https://ëëë.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/arsimi/#tab2	Përfunduar	Jo
252	13.11.2024	Si kërkesë për informacion për situatën zgjedhore do të dëshironim nga MAS pse një pjesë nga federatat sportive ende nuk i kanë caktuar datat e asambleve zgjedhore dhe kur janë afatet e fundit ligjore për ti zhvilluar ato? Në pritje të përgjigjes tuaj, ju falenderojmë paraprakisht!	27.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se bazuar në pikën 1, të nenit 16 të ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”, të ndryshuar përcaktohet se Federata shqiptare është person juridik që organizohet dhe funksionon në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe kuadrit ligjor për organizatat jofitimprurëse dhe ushtron veprimtarinë në një sport të caktuar në përputhje me statutin e saj. Sa më sipër, zgjedhjet për organet drejtuese zhvillohen nga federatat përkatëse bazuar në aktet e tyre të brendshme.	Përfunduar	Jo
253	13.11.2024	Kërkesë për informacion lidhur me nivelin he certifikatën e njohjes së gjuhës së huaj si kriter pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë”	14.11.2024	Në vijim të email-it tuaj ju bëjmë me dije se bazuar në udhëzimin nr. 52, datë 3.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimit në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar parashikohet se: “Për pranimin në programet e studimeve të ciklit të tretë, kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj të paktën në nivelin B2. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në rregulloret e tyre të brendshme nivelin e gjuhës së huaj, që do të jetë kriter hyrës në programet e studimit të ofruara prej tyre, në ciklin e dytë dhe të tretë, në përputhje me nivelet e cituara në këtë pikë të udhëzimit.” Dokumenti i njohjes së gjuhëve, mund të jetë një certifikatë, diplomë apo dëshmi, e lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për ofrimin e testeve ndërkombëtare. Certifikata, diploma apo dëshmia e lëshuar nga subjektet që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale për ofrimin e testeve ndërkombëtare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, njihen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, pas konfirmimit të secilit dokument nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që kanë nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për testin përkatës, sipas tabelës 1 bashkëngjitur këtij udhëzimi.	Përfunduar	Jo

254	14.11.2024	Në vitin 2005 kam mbaruar klasën e tetë në Vlorë. Më duhet dëftesa e notave bashkë me vërtetimin që kam mbaruar shkollën tetë vjeçare për të vazhduar shkollën ktu në shtetin ku ndodhem. A mund të më thoni ku mund të marr vërtetimin e shkollës.	14.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se lidhur me vërtetimin dhe listën e notave të arsimit bazë duhet t'i drejtoheni shkollës që keni ndjekur.	Përfunduar	Jo
255	14.11.2024	Kopje të transkriptit të fundit akademik ["Transcript of Academic Records"], përcjellë në MAS nga Universiteti i Neë Yorkut Tirana [University of Neë York Tirana, UNYT] lidhur me Doktorantin LEIDA RUVINA, Nr. Matr. 2973 [Student code], regjistruar prej vitit akademik 2012-2013, Dega "Shkenca politike / Marrëdhënie ndërkombëtare" [Major "PhD in Hum. & Soc. Sc. / Pol. Sc. & IR"]. Transkripti (2 faqe) përmban notat e 10 provimeve doktorale, 3 konferenca ndërkombëtare, 3 publikime shkencore në revista peer-reviçë shkencore ndërkombëtare."	15.11.2024	Në vijim të kërkesës së paraqitur në adresën e koordinatorit në MAS, ju bëjmë me dije se nga verifikimet e kryera në dokumentacionin dhe regjistrat që janë mbajtur në MAS, lidhur me regjistrimin e gradës shkencore sipas legjislacionit të kohës, nuk rezulton emri juaj.	Përfunduar	Jo
256	14.11.2024	Do te doja nje informacion ne lidhje me programin 2 vjecar profesional akuakulture ne universitetin ismail qemali vlore.doja te dija kjo dege 2 vjecare a eshte akredituar? dhe ky program a njihet nga shteti ose administrata shtetorere per punesim?a eshte e njojtur nga drejtoria e arsimit te larte ky program .dhe njihet ky program per tu punesuar ne ndonje pozicion si psh ne aku si specialist?	27.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se informacionin lidhur me akreditimin e programeve të studimit e gjeni të publikuar në adresën zyrtare të ASCAL në linkun https://ëëë.ascal.al/sq/akreditimi/programe-te-akredituara Lidhur me informacionin mbi kriteret e punësimit dhe nivelin e diplomës për pozicione të caktuara duhet t'i drejtoheni institucionit ku do të aplikoni për punë	Përfunduar	Jo
257	15.11.2024	Kërkoj të më vihen në dispozicion, nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit, gjithë të dhënat për shkollat fillore dhe ato 9-vjeçare (cikël i ulët dhe i lartë), sipas qarqeve dhe bashkive, për vitet 2019, 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, si vijon: 1. Numri i shkollave. 2. Numri i nxënësve në shkollë. 3. Numri i mësuesve në shkollë. 4. Numri i shkollave të bashkuara. (që bashkojnë në një godinë filloren, 9-vjeçaren dhe të mesmen) 5. Numri i shkollave që aplikojnë klasat kolektive. 6. Mungesat e mësuesve në nivel rajonal	27.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se të dhënat e kërkuara i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Institutit të Statistikave (INSTAT), në linkun https://ëëë.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/arsimi/#tab1 , si dhe në vjetarin statistikor të publikuar në faqen zyrtare të MAS, në linkun https://arsimi.gov.al/statistika-2/ .	Përfunduar	Jo
258	15.11.2024	Po iu shkruaj lidhur me nje detyrim qe une si studente duhet te kryej kundrejt fakultetit per leshimin e diplomes se Masterit Shkencor, ne programin Sisteme Inofrmacioni ne Ekonomi. Diten e dorezimit te dokumentave perkates per marrjen e kartonit te diplomes, mua me eshte thene qe certifikata e mbrojtjes se gjuhes Angleze (APTIS certification), te cilin e kam te leshuar nga British Council ne Poloni (ku une jetoj prej gati 2 vitesh) nuk me njihet nga fakulteti dhe Ministria e Arsimit dhe e Sportit ne Shqiperi. Nepermjet ketij email dua te verifikoj me ju si institucioni pergjegjes, nese realisht ky certifikim internacional i gjuhes Angleze nga British Council per APTIS nuk njihet per leshimin e kartonit te diplomes?	27.11.2024	Në vijim të email-it tuaj ju bëjmë me dije se bazuar në udhëzimin nr. 52, datë 3.12.2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar parashikohet se: "Për pranimin në programet e studimit të ciklit të dytë kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj të paktën në nivelin B1. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në rregulloret e tyre të brendshme nivelin e gjuhës së huaj, që do të jetë kriter hyrës në programet e studimit të ofruara prej tyre, në ciklin e dytë dhe të tretë, në përputhje me nivelet e cituara në këtë pikë të udhëzimit." Dokumenti i njohjes së gjuhëve, mund të jetë një certifikatë, diplomë apo dëshmi, e lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për ofrimin e testeve ndërkombëtare. Certifikata, diploma apo dëshmia e lëshuar nga subjektet që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale për ofrimin e testeve ndërkombëtare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, njihen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, pas konfirmimit të secilit dokument nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që kanë nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për testin përkatës, sipas tabelës 1 bashkëngjitur këtij udhëzimi.	Përfunduar	Jo
259	18.11.2024	Ju lutem, a mund të më informoni mbi: 1. Datat e hapjes së aplikimeve për kuotat e doktoraturës në Stomatologji? 2. Kushtet dhe kriteret e pranimit? 3. Dokumentacionin e nevojshëm dhe afatet për dorëzim? 4. Çdo informacion shtesë mbi procesin e aplikimit ose mbështetjen për kandidatët?	27.11.2024	Në vijim të email-it tuaj, ju informojmë se: Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", institucionet e arsimit të lartë publik dhe jopublik gëzojnë liri akademike dhe autonomi në përcaktimin e kuotave të pranimit për çdo program studimi që ofrojnë, në përputhje me standardet shtetërore në fuqi për kapacitetet akademike dhe infrastrukurore. Kuotat për çdo program studimi, përcaktohen me Vendim Senati Akademik dhe afati, dokumentacioni dhe kriteret e pranimit përcaktohen nga Institucioni i Arsimit të Lartë.	Përfunduar	Jo

260	19.11.2024	Doja te informohesha per konvertimin e diplomes shqiptare Bachelor dhe Master per ne Shtetet e Bashkuara te Amerikes, konvertimi behet ne Ministrine e Arsimit ne Shqiperi apo ndiqet nje procedure tjeter permes e-albania?	19.11.2024	Deleguar Qendrës së Shërbimeve Arsimore	Përfunduar	Jo
261	20.11.2024	Doja te informohesha ne lidhje me specializimet mjekesore ne Universitetin Mjekesor te Tiranës per nivelin specializim deshta te pyes per kushtet te cilat duhet ti plotesoj per te qene pjes e Universitetit	27.11.2024	Lutem lidhur me kriteret dhe procedurat e aplikimit/pranimit në specializimet afatgjata drejtoheni Universitetit të Mjekesisë Tiranë, ku jeni i interesuar të aplikoni.	Përfunduar	Jo
262	21.11.2024	Un kam diplomën e shkollës së mesme ne mbiemrin e vajzëris dhe doja ta ktheja në mbiemrin qe kam marrë mbas martesë si mund ta bëj, dhe doja të dija nëse është e vlefshme në itali .	27.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj të paraqitur në adresën e koordinatorit në MAS sqarojmë se diploma e Maturës Shtetërore është dokumenti i përfundimit të arsimit të mesëm të lartë që lëshohet nga institucioni përgjegjës për shërbimet arsimore pasi nxënësi është kalues në provimet kombëtare, të detyruara dhe me zgjedhje, të maturës shtetërore. Ky dokument nuk mund të modifikohet, me të dhënat personale të ndryshuara pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë dhe lëshimit të këtij dokumenti. Lidhur me procedurat që duhet të ndiqni për njohjen e diplomës jashtë vendit duhet t'i drejtoheni për informim autoriteteve kompetente në shtetin përkatës.	Përfunduar	Jo
263	25.11.2024	Kerkese per kopje zevendesuese te diplomes se demtuar.	27.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj të përcjellë në adresën e koordinatorit në MAS ju bëjmë me dije se bazuar në pikën 4, të nenit 91 të ligjit nr. 80/2015“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se “Institucionet e arsimit të lartë nuk mund të lëshojnë dublikatë diplome, por mund të lëshojnë dokument të barasvlershëm me diplomën në formën e vërtetimit, i cili duhet të përmbajë emrin e institucionit që ka lëshuar diplomën, numrin e diplomës origjinale, datën e lëshimit të saj, ciklin dhe programin e studimit.” Sa më sipër, lutem drejtoheni institucionit të arsimit të lartë ku keni përfunduar studimet për t’u pajisur me vërtetim.	Përfunduar	Jo
264	25.11.2024	1. Çfarë dokumentesh dhe kërkesash duhet të paraqes për njohjen e krediteve dhe kalimin në një program Bachelor? 2. Cilat janë procedurat për të aplikuar dhe sa mund të zgjasë ky proces? 3. A mund të përfundoj Bachelor-in brenda një viti, nëse kreditet e diplomës profesionale njihen plotësisht? 4. Nëse kreditet nuk njihen plotësisht, sa lëndë do të duhet të ndiqni dhe sa kohë mund të zgjasi ky proces? 5. A ka mundësi për të vazhduar studimet në universitetet publike dhe private që ofrojnë programe për Teknologji Informacioni në Tiranë?	27.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se bazuar në pikën 2, të nenit 72 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se kreditet e grumbulluara gjatë studimeve profesionale të larta mund të transferohen në studimet e ciklit të parë, që referohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas kriterëve të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë. Sa më sipër, lutem për më shumë informacion drejtoheni institucionit të arsimit të lartë përkatës ku do të ndiqni studimet.	Përfunduar	Jo
265	25.11.2024	Ne studentët të cilët plotësojmë kriteret e pikës 1 të Vendimit Nr.39 datë 23.1.2019 me mesatare mbi 9 dhe që jemi në program Erasmus + , a e përfitojmë bursën me vlerën 10.000(dhjetë mijë) lekësh sic e përcakton pika 13 e Vendimit Nr.39 datë 23.1.2019?	27.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se bazuar në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, te ndryshuar parashikohet si vijon: “ 1. Përfitojnë bursë nga fondi i mbështetjes studentore, në masën e përcaktuar në këtë vendim, studentët e pranuar në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve, programet e integruara të studimeve, si dhe studentët e shtresave sociale në nevojë, që plotësojnë kriteret, si më poshtë: a) studentët e pranuar në vitin e parë akademik, në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve dhe programet e integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, me notë mesatare vjetore nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, që përlloragitet si mesatare e thjeshtë e treguesve, si më poshtë: i) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë; ii) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore.”	Përfunduar	Jo

266	26.11.2024	Jam një qytetare që jetoj në Greqi dhe dua te vazhdoj studimet e larta këtu. Më kërkojnë që diploma ime origjinale ose fotokopje të marrë vulë apostile. Ju lutem me ktheni një përgjigje nëse bëhet që të dërgoj diplomën apo jo.	27.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se për t'u pajisur me vulë apostile për dokumentet e lëshuara në Republikën e Shqipërisë bazuar në vendimin nr.134, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave "Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit", të ndryshuar duhet t'i drejtoheni Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Nga kërkesa juaj është e paqartë diploma për të cilën kërkonti të pajiseni me vulë. Dokumentet e përfundimit të arsimit të mesëm, sipas urdhrin nr. 16, datë 11.01.2018 të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për legalizimin e dokumenteve të shkollimit parauniversitar" duhet t'i përcillni në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar, që i dergojne me postë në QSHA për të kryer legalizimin. Në vijim pasi të merrni dokumentet e legalizuar në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar, me qëllim përdorimin e dokumenteve jashtë vendit duhet t'i përcillni për t'i vulosur edhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.	Përfunduar	Jo
267	26.11.2024	Jam nje ish student i Universitetit "Pavaresia" Vlore ne vitet 2010-2015. Me duhet te di te sakte ne qofte se ekziston nje numer matrikullimi per diplomen time !	27.11.2024	Deleguar Qendrës së Shërbimeve Arsimore.	Përfunduar	Jo
268	26.11.2024	Kërkesë për informacion lidhur me shërbimin elektronik mbi vlefshmërinë e diplomës.	27.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se mund të aplikoni në shërbimin elektronik "Informacion mbi licencimin dhe akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit" që ofrohet vetëm online në portalin e-albania në adresën eeb: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14163 . Në këtë shërbim përfshihen edhe institucionet e mbyllura të arsimit të lartë dhe programet e studimit që ato kanë ofruar. Institucioni përgjegjës për ofrimin e këtij shërbimi është Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.	Përfunduar	Jo
269	27.11.2024	Kërkesë për informacion lidhur me ndjekje e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" në Republikën e Shqipërisë, në rastet kur disponon një diplomë të ciklit të parë të studimeve "Bachelor", të lëshuar nga Universiteti i Tetovës.	27.11.2024	Në vijim të kërkesës suaj të paraqitur në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit lidhur me ndjekjen e ciklit të dytë të studimeve ju bëjmë me dije si më poshtë: Bazuar në nenin 76, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" parashikohet se pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të institucionit të arsimit të lartë ku ata aplikojnë. Sipas udhëzimit nr. 12, datë 30.6.2023 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar parashikohet se aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, për çdo vit akademik të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, në institucionet e arsimit të lartë në datat e përcaktuara në kalendar. Sa më sipër, me qëllim ndjekjen e programeve të ciklit të dytë të studimeve "Master Profesional" siç kërkohet nga ana juaj, duhet të aplikoni pranë institucioneve të arsimit të lartë përkatës sipas datave të përcaktuara në kalendarin e RASH dhe QSHA për çdo vit akademik. Gjithashtu në kushtet kur keni përfunduar ciklin e parë të studimeve jashtë Republikës së Shqipërisë, për efekt të vijimit të studimeve të ciklit të dytë duhet të kryeni njohjen dhe njehsimin e diplomës pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore.	Përfunduar	Jo

270	28.11.2024	Kërkesë për informacion lidhur me kushtet që duhen plotësuar për t'u përjashtuar nga detyrimi për zhvillimin e praktikës profesionale për mësuesin me qëllim pjesëmarrjen në provimin e shtetit.	31.12.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se bazuar në rregulloren "Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit", miratuar me urdhrin nr. 100, datë 25.2.2022 të ministrit të Arsimit dhe Sportit, të ndryshuar parashikohet se përjashtohet nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale personi që ka kryer të paktën një vit mësimor punë si mësues në një institucion arsimor dhe ka fituar diplomën, sipas pikës 1 të këtij nenit 4, të kësaj rregulloreje.	Përfunduar	Jo
271	01.12.2024	Më duhet një diplomë e shkollës së Mesme pasi diploma që kam më është dëmtuar. Ku mund ta tërheq një të tillë.	10.12.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se nuk lëshohet dublikatë diplome, por mund t'i drejtoheni shkollës që keni ndjekur për t'u pajisur me vërtetim mbi përfundimin e arsimit të mesëm të lartë.	Përfunduar	Jo
272	02.12.2024	A ka ndonjë rregullore zyrtare që përcakton standardet për transportin e nxënësve në shkollat publike dhe private? Sa shkolla publike në Tiranë aktualisht ofrojnë shërbimin e transportit për nxënësit? Cilat janë kërkesat e licencimit për kompanitë ose individët që ofrojnë shërbime transporti për shkollat? Si garantohet siguria e fëmijëve gjatë transportit dhe a ekzistojnë mekanizma kontrolli për mjettet dhe shoferët?	30.12.2024	Në vijim të kërkesës suaj për informacion ju bëjmë me dije si më poshte: Standardet për transportin e nxënësve përcaktohen në vendimin nr. 89 datë 14.02.2018 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional, parauniversitar dhe të studentëve" të cilin e gjeni të publikuar në Qendrën e Botimeve Zyrtare në linkun https://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/02/14/89/1385e417-798d-4cdc-937d-2e2d37153b92 Sipas vendimit nr. 119, datë 1.3.2023 të Këshillit të Ministrave "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit" parashikohet përballimi nga fondet publike të shpenzimeve për transportin e: a) punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare publike (në vijim IAP publike), ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator, oficerë sigurie, punonjës të shërbimit psiko-social), që punojnë larg vendbanimit të përhershëm të tyre, jashtë qendrave urbane dhe kthehen brenda ditës në vendbanim, në distancën mbi 5 km deri në 50 km; b) nxënësve që ndjekin procesin mësimor në IAP-të publike të arsimit bazë ose kopshtet publike, që udhëtojnë nga vendbanimi i përhershëm në një vendbanim tjetër, mbi 2 km larg IAP-ve publike më të afërta (shkollë/kopsht); c) nxënësve që jetojnë në qendra rezidenciale, të krijuara me vendim të Këshillit të Ministrave, për grupe të nxënësve/fëmijëve/familjeve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë dhe që udhëtojnë mbi 2 km larg për të ndjekur mësimin në IAP-të publike më të afërta (shkollat e arsimit bazë ose kopshtet publike); d) nxënësve të arsimit parauniversitar me aftësi të kufizuara që qëndrojnë	Përfunduar	Jo
273	02.12.2024	Jam një mësuese në arsimin 9 - vjecar , vendbanimin e kam mbi 50 km dhe në një rreth tjetër por brenda qarkut nga vendi i punës . Ju lutem a përfitoj pagesën e transportit ?	30.12.2024	Në vijim të kërkesës suaj të përcjellë në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit ju bëjmë me dije se bazuar në vendimin nr. 119, datë 1.3.2023 të Këshillit të Ministrave "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit" parashikohet përballimi nga fondet publike të shpenzimeve për transportin të : "a) Punonjësve mësimorë të arsimit parauniversitar, ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimit fillor, arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator, oficerë sigurie, punonjës të shërbimit psiko-social) të institucioneve arsimore publike, që punojnë jashtë qendrave urbane, qytetit/fshatit, larg vendbanimit të përhershëm të tyre, në largësinë mbi 5 (pesë) km deri në 50 (pesëdhjetë) km dhe kthehen brenda ditës në vendbanim.	Përfunduar	Jo
274	02.12.2024	Lutem nese mund te kem ndihmen tuaj, pasi kushërira kerkoi te regjistrohej ne shkolle ne part time, por ne kohen qe ishin aplikimet, kishte djalim me probleme shendeti dhe nuk arriti te bente regjistrimin. Nese eshte mundesia, mund te behen tani veprime qe te vazhdoje shkollen part time? Shpresoj qe do te kem ndihmen tuaj pasi kishte deshire te kryente gjimnazin part time pasi tani i ka mundesite.	10.12.2024	Deleguar për trajtim AKAP.	Përfunduar	Jo
275	03.12.2024	Jam e interesuar për të bërë shkollën e lartë në Tiranë por kam disa probleme dhe nuk ju kontaktoj dot.	10.12.2024	Ju lutem specifikoni informacionin që kërkoni t'u vihet në dispozicion nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.	Përfunduar	Jo

276	03.12.2024	Kam qenë studente në Universitetin Nderkombëtar të Tiranës dhe e kam lënë në vitin 2014, por më duhen transkriptet e krediteve të klasave që kam pasë atje, që të rregjistrohem ktu në Amerikë. Universiteti këtu i kërkon rekordet direkt nga ministria e Arsimit ose Universiteti. Problemi është që Universiteti është mbyllur dhe nëse është e mundur që ju ti dërgoni. Më njoftoni ju lutem si mund t'ja bëj.	11.12.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se për t'u pajisur me programet mësimore të programit të studimit, duhet të dorëzoni një kërkesë zyrtare pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, (me postë fizike) të shoqëruar me kartën e identitetit ku të përcaktoni edhe programin e studimit që keni ndjekur.	Përfunduar	Jo
277	03.12.2024	Bazuar në parashikimet ligjore mbi Arsimin e Lartë, cilat janë politikat e edukimit në të cilat studentët e universiteteve kanë vendimmarrje apo abshkëvendimmarrje në jetën studentore të universiteteve? Cilat janë rastet që është aplikuar vendimmarrja e studentëve në praktikë në vitet e fundit? A ka Ministria e Arsimit një rregullore të brendshme apo kuadër rregullator i cili të parashikojë pjesmarrjen, praktikat dhe procedurat për pjesmarrjen në vendimmarrje të trupave studentore në universitetet përkatëse? Nëse po, kërkoj të më vihet në dispozicion dokumenti përkatës.	31.12.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se sipas shkonjës “c” të nenit 98 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se studentët kanë të drejtë të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes së institucionit të arsimit të lartë, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe statutin e institucionit. Gjithashtu bazuar në pikën 1, të nenit 90 të ligjit nr. 80/2015 përcaktohet se studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentore. Në institucionet publike të arsimit të lartë, votat e studentëve në përzgjedhjen e rektorit dhe dekanit llogariten në masën dhjetë për qind të totalit të përgjithshëm të votave. Në Senatin Akademik përfaqësohen edhe studentët në institucionet publike, në masën dhjetë për qind, ndërsa në institucionet jopublike përfaqësohen në masën e përcaktuar në statutin e institucionit. Në përbërje të komisioneve të përhershme përfaqësohen dhe studentët, sipas përcaktimeve të statutit të institucionit të arsimit të lartë, me përjashtim të Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” dhe Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik. Bazuar në nenin 3 të ligjit nr. 80/2015 parashikohet se IAL-të kanë autonomi organizative që garantohet nëpërmjet së drejtës për t'u vetëqeverisur, për të zgjedhur organizmat drejtues, për të organizuar strukturat dhe rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të tyre të brendshme, të hartuara në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi. Sa më sipër, lidhur me rastet konkrete të përfshirjes së studentëve në procesin e vendimmarrjes, lutem drejtohuni institucioneve të arsimit të lartë përkatës.	Përfunduar	Jo
278	04.12.2024	Çfarë masa janë marrë nga Ministria e Arsimit për përfshirjen e personave me çrregullime mendore në arsim të detyruar? 2. Cilat janë mundësitë për mbështetje dhe shërbime psikologjike për nxënësit që kanë çrregullime mendore? 3. Si trajtohen nxënësit me çrregullime mendore në shkolla dhe cilat janë politikat për arsimimin e tyre? 4. A ka institucione shkollore që ofrojnë mbështetje speciale për personat me çrregullime mendore që janë në moshë për arsim të detyruar? 5. Si është organizuar bashkëpunimi ndër-institucional për mbështetje të këtyre nxënësve (mes Ministrisë së Shëndetësisë, Arsimit dhe Shërbimit Social)? 6. Sa nxënës me çrregullime mendore janë regjistruar dhe përfshirë në shkolla për arsim të detyruar në vitet e fundit?	30.12.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe në zbatim ligjit nr.119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, ju informojmë se institucionet arsimore të arsimit parauniversitar dhe sidomos ato të arsimit të detyruar kanë qasje mbështetëse, gjithëpërfshirëse dhe integruese ndaj të gjithë individëve me aftësi të kufizuara. Në Shqipëri, përfshirja në arsimin e detyruar e nxënësve me çrregullime të shëndetit mendor dhe atyre me aftësi të kufizuara është një prioritet kombëtar, i mbështetur nga politika dhe masa të ndryshme institucionale. Por kjo nuk përjashton nga marrja e shërbimeve arsimore individë të rritur të cilët janë pjesë e këtyre kategorive dhe për arsye të ndryshme nuk kanë mundur të ndjekin apo të përfundojnë arsimin e detyruar. Në vijim gjeni përgjigje për pyetjet tuaja. Ministria e Arsimit dhe Sportit ka hartuar dhe ndërmarrë politika dhe nisma mbi përfshirjen dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor parauniversitar duke siguruar ofrimin e shërbimeve arsimore për këta individë, duke përfshirë: - Hartimin e politikave dhe strategjive që synojnë integrimin e nxënësve me aftësi të kufizuara, përfshirë ata me çrregullime të shëndetit mendor, në sistemin arsimor publik. - Trajnimin e mësuesve për të zhvilluar aftësitë e nevojshme në mbështetje të këtyre nxënësve. - Përmirësimin e infrastrukturës shkollore për të siguruar akses dhe mjedis të përshtatshëm për të gjithë nxënësit. - Ofrimin e tekseve mësimore falas për të gjithë nxënësit përfshirë nxënësit me aftësi të kufizuara Aktualisht në sistemin arsimor parauniversitar ushtrojnë detyrën e tyre 850 punonjës të shërbimit psikosocial të cilët kanë në fokus ofrimin e një shërbimi i cili synon zhvillimin e potencialit akademik por në të njëjtën	Përfunduar	Jo

279	04.12.2024	Kisha nevojë për një informacion. Ju lutem mundëni të me thoni cilet janë noteret tuaj për të përkthyer e noterizuar diplomën pasi kam marrë përgjigje pozitive nga arkiva e shtetit dhe dua të marr vullen apostile .	31.12.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se informacioni që kërkontë nuk është në fushën e përgjegjësisë shtetërore të MAS. Lidhur me listën e noterëve dhe përkthyesve të certifikuar mund t'i referoheni faqes zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ose t'i drejtoheni këtij institucioni për më shumë informacion.	Përfunduar	Jo
280	04.12.2024	1. Në sa shkolla në Tiranë zhvillohet mësim me turne? Ju lutem, specifikoni emrat e shkollave. 2. Sa shkolla janë shembur dhe janë në proces ndërtimi në Tiranë? Ju lutem, specifikoni emrat e shkollave. 3. Ku janë zhvendosur nxënësit e këtyre shkollave?	15.01.2025	Vwnia nw dispozicion e tw dhwnave tw kwrkuara	Pwrfunduar	Jo
281	05.12.2024	Doja informacion duke qenë se periudha e gjimnazit ka qenë gjatë trazirave të viteve 1997, nëse i kam dhënë provimet e maturës dhe ku mund të kërkoj për diplomën, dhe nëq nuk i kam dhënë, ka mundësi të kryej tani?	12.12.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju lutem fillimisht drejtohuni shkollës që keni ndjekur për t'u informuar mbi të dhënat tuaja dhe nëse i keni përmbyllur detyrimet për përfundimin e arsimit të mesëm.	Përfunduar	Jo
282	05.12.2024	Jam nga Kosova dhe më duhet të kryej procesin e nostrifikimit për diplomat e mia të Bachelor-it dhe Master-it në Shqipëri. Ju lutem më ndihmoni me informacion mbi procesin: A duhet të aplikoj online apo duhet të paraqitem fizikisht në ministri? A kërkohet vula apostile për dokumentet? Sipas informacionit që kam, për Shqipërinë nuk është e nevojshme, por dëshiroj ta konfirmoj.	10.12.2024	Deleguar Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Kthim përgjigje nga QSHA me datë 11.12.2024 si vijon "Informacionin e detajuar e gjeni në linkun më poshtë: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=853 Përsa i përket pyetjeve tuaja: Aplikimi bëhet on line në portalin e-albania në linkun më sipër. Edhe pse jeni shtetase kosovare, portali ju lejon të aplikoni duke klikuar te "PËRDOR" dhe më pas të rrethi "Shtetas të huaj. Dokumentacioni nuk ka nevojë të dërgohet me postë. Për dokumentet e lëshuara në Republikën e Kosovës nuk ka nevojë që të pajisen me vullë apostile."	Përfunduar	Jo
283	06.12.2024	1. A ka akses Ministria e Arsimit në databazën kombëtare për monitorimin e të miturve në konflikt me ligjin? 2. A regjistrohen rastet e të miturve që rifillojnë arsimin në databazë? 3. Si koordinohen shkollat me institucionet e tjera për ndjekjen e masave rehabilituese për të miturit? 4. Cilat janë politikat e ministrisë për parandalimin e kriminalitetit tek të miturit? 5. A ka programe edukimi ose ndërgjegjësimi në shkolla që synojnë të parandalojnë përfshirjen e të miturve në konflikte me ligjin? 6. Sa të mitur që janë në shërbim prove ose masa alternative marrin akses në arsimim? 7. A ekziston një plan për krijimin e një shkolle riedukimi për të miturit në konflikt me ligjin? Nëse po, në çfarë faze është ky projekt? 8. A ka programe edukimi dhe ndërgjegjësimi në shkolla për parandalimin e përfshirjes së të miturve në aktivitete kriminale? 9. Cilat janë investimet në trajnimin e stafit arsimor për të identifikuar dhe adresuar fëmijët në rrezik?	31.12.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, dërguar nëpërmjet koordinatorit për të drejtën e informimit ju informojmë si më poshtë: Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur funksionon dhe administrohet sipas ligjit nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur", (neni 137) dhe vendimin nr. 149, datë 20.3.2019 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikat e përdorimit e aksesimit, të dhënat parësore e dytësore dhe dhënësien e informacionit të sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur". Për më shumë informacion lidhur me funksionimin e këtij sistemi duhet t'i drejtoheni Ministrisë së Drejtësisë. Për shkak të ndikimit dhe rëndësisë që ka procesi arsimor në rehabilitimin dhe riintegrimin e të burgosurve, mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit janë nënshkruar ndër vite marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e procesit arsimor për të burgosurit. Procesi arsimor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP) përmbush në praktikë të drejtën kushtetuese për arsimim të shtetasve shqiptarë, përfshirë edhe personat e dënuar me një vendim penal apo në proces hetimi, brenda sistemit të burgjeve. Aktualisht, shërbimi arsimor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ofrohet sipas Urdhrit të Përbashkët nr. 3348/1 prot., datë 18.04.2018 të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për rregullimin e procesit arsimor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur" dhe marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 4137/2 prot., datë 18.07.2024. https://ëë.drejtësia.gov.al/ëp-content/uploads/2018/10/Urdher_i-perbashket_rregullimin_e_procesit_arsimor_ne_institucionet_e_ekzekutimit_te	Përfunduar	Jo
284	07.12.2024	Jam e interesuar për pozicionin si oficer sigurie në qarkun e Tiranës. Jam 46 vjeç. E diplomuar në shkencat sociale. Kam nevojë për mbështetjen tuaj për të ndjekur hapat.	11.12.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se dokumentacioni dhe procedurat e aplikimit parashikohen në udhëzimin nr. 593, datë 06.12.2024 të cilin e gjeni të publikuar në linkun https://arsimiparauniversitar.gov.al/ëp-content/uploads/2024/12/Urdher-nr.593date-06.12.2024.pdf	Përfunduar	Jo

285	09.12.2024	Ju lutem me duhet ndihme perse i perket programit mesimor per vitin 2006-2009 te Universitetit Kristal dega Infermieri.	11.12.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se për t'u pajisur me programet mësimore të programit të studimit, duhet të dorëzoni një kërkesë zyrtare pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. (me postë fizike) të shoqëruar me kartën e identitetit, ku të përcaktoni edhe programin e studimit që keni ndjekur.	Përfunduar	Jo
286	10.12.2024	1.Sa është zbatuar Udhëzimi MAS për ndalimin e celularëve në institucionet arsimore parauniversitare? 2.A janë të pajisuara shkollat me infrastrukturën e nevojshme për të kontrolluar nxënësit që përdorin celularë në shkolla? 3.Nga raportimet, cilat janë shkollat më problematike në lidhje me përdorimin e celularëve në shkolla nga nxënësit? 4.Ku ka çaluar puna për zbatimin e Udhëzimit të MAS për ndalimin e celularëve në institucionet arsimore parauniversitare? 5.Sa masa përjashtimore janë marrë ndaj nxënësve problematikë në vitin shkollor 2023-2024 dhe vitin shkollor 2024-2025?	31.12.2024	Në vijim të kërkesës suaj dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar ju bëjmë me dije si më poshtë: Në zbatim të udhëzimit të nr.34, datë 16.11.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për ndalimin e telefonit celular në institucionet arsimore parauniversitare” institucionet arsimore kanë detyrimin për zbatimin e tij nga punonjësit mësimor dhe nxënësit. Mësuesit janë informuar për përcaktimet e udhëzimit nga drejtori i shkollës ndërsa nxënësit e marrin këtë informacion nga mësuesit kujdestar dhe mësuesit lëndor. Parësore në edukimin e nxënësve në institucionet arsimore është informimi dhe ndërgjegjësimi që bën stafi mësimdhënës dhe drejtues në shkollë për zbatimin e detyrimeve që kanë gjatë frekuentimit të shkollës, ndërkohë që janë informuar mbi penalitetet në rastin e konstatimit të përdorimit të telefonit celular. Në zbatim të udhëzimit nr.34, datë 16.11.2018, institucionet arsimore kanë rishikuar rregulloren e brendshme të shkollës dhe në takimet e zhvilluara në fillim të vitit shkollor mësuesit kujdestar informojnë prindërit për rregulloren e shkollës dhe masat e ndërmarra në rast konstatimi . Masa disiplinore “përjashtim nga shkolla” jepet vetëm për nxënësit e arsimit të mesëm të lartë për shkelje të rëndë të disiplinës në shkollë dhe përpara marrjes së këtij vendimi, IA në bashkëpunim me psikologun e shkollës apo dhe oficerin e sigurisë (në shkollat që kanë OS) ezauron të gjitha format e disiplinimit pozitiv. Përjashtimi i nxënësit nga institucioni arsimor konsiderohet si mënyra më ekstreme dhe mund të aplikohet nga Komisioni i Disiplinës vetëm pasi janë shfrytëzuar në mënyrë shteruese cdo mënyrë tjetër për të evituar procesin e përjashtimit dhe vetëm ky komision ka kompetencë për marrjen e një mase të tillë	Përfunduar	Jo
287	12.12.2024	Jam e interesuar per nje informacion per OS.Per vendet vakante mund te kem nje informacin?	13.12.2024	Deleguar për trajtim AKAP.	Përfunduar	Jo
288	12.12.2024	Une kam mbaruar gjimnazin ne 2009 tek shkolla messme e pergjithshme “Aleks Buda”.Une tashme kam humbur diplomen e matures dhe jam e interesuar ta kem serisht. Si mund ta kem.? Nepermjet E albania apo nga shkolla direkt.	13.12.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se nuk lëshohet dublikatë diplome, por mund t'i drejtoheni shkollës që keni ndjekur për t'u pajisur me vërtetimin mbi përfundimin e arsimit të mesëm të lartë	Përfunduar	Jo
289	12.12.2024	Ju drejtohem me këtë kërkesë për ndihmë lidhur me gjetjen e listës së notave të klasës së 8-të për vitin shkollor 1995-1996. Ju lutem të më asistoni në gjetjen e këtij dokumenti ose të më udhëzoni për hapat e mëtejshëm që duhet të ndjek. Nëse ju nevojiten informacione të tjera shtesë, jam i gatshëm t'i ofroj menjëherë.	30.12.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se amza e shkollës dhe regjistrat e notave mbahen nga institucioni arsimorë parauniversitar, shkollat përkatëse. Sa më sipër, lidhur me këtë dokumentacion/informacion duhet t'i drejtoheni shkollës që keni ndjekur.	Përfunduar	Jo
290	12.12.2024	Jam studente në vitin e pestë , fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës (Universiteti Politeknik i Tiranës). Do të marr në studim Burgun a Krujë (Zaharia) për temë diplome (Pjesë e procesit akademik). Si duhet të procedoj për të pasur akses te ajo godinë? (Vizitë në terren)	30.12.2024	Kërkesa juaj për t'u pajisur me leje hyrje në institucionin e vuajtjes së dënimit nuk është në fushën e përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit sipas vendimit nr. 523, datë 22.9.2021 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, të ndryshuar. Shënim: Kërkesa i është përcjellë njëkohësisht edhe Ministrisë së Drejtësisë	Përfunduar	Jo
291	13.12.2024	Jam nxenes ne vitin e trete gjimnazit. Dy vitet e meparshme kam patur rezultate te larta. Kam deshire per te vazhduar studimet e larta ne degen e inxhinierise elektronike ne nje univeristet privat. A ka ndonje program ministria e arsimit qe ofron bursa studimore per nxenesit ekselente te cilet deshirojne te studiojne ne universitete private brenda Shqiperise, nese po si mund te aplikojë.	14.01.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë se bazuar në vendimin nr. 386, datë 1.6.2022 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar parashikohet mbështetja financiare nga buxheti i shtetit ose të ardhura të tjera të ligjshme, të studentëve shtetas shqiptarë, të pranuar në institucionet publike të arsimit të lartë që plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë vendim. Nga ky vendim nuk përfitojnë studentet e pranuar në institucionet jopublike të arsimit të lartë.	Përfunduar	Jo

292	14.12.2024	<p>Në vitin akademik 2010-2011 kam fituar të drejtën për të ndjekur studimet e larta në degën "Teknologji Informacioni" pranë Universitetit të Vlorës. Vitin e parë të studimeve e kam përfunduar në Universitetin e Vlorës, ndërsa më pas, në vitin 2011, jam transferuar në Universitetin privat "Kristal". Gjatë periudhës 2011-2013 kam ndjekur vitin e dytë dhe të tretë të studimeve në këtë universitet.</p> <p>Për arsye personale nuk kam arritur të përfundoj vitin e tretë dhe të diplomohem. Që nga ajo kohë kam jetuar jashtë shtetit dhe nuk kam pasur mundësi të tërheq dokumentet e mia personale nga Universiteti "Kristal", i cili tashmë është mbyllur. Dokumentet e mia përfshijnë edhe diplomën e shkollës së mesme.</p> <p>Ju lutem, a mund të më informoni mbi vendndodhjen e këtyre dokumenteve dhe se ku janë transferuar arkivat e Universitetit "Kristal"? Nuk kam asnjë informacion për ndonjë kontakt zyrtar të vlefshëm të këtij universiteti.</p>	31.12.2024	<p>Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se pas heqjes së licencës së SHLUIP "Universiteti Kristal" në vitin 2014 ky institucion ka depozituar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit regjistrat të cilët janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave si edhe dosjet e studentëve që kanë qenë në proces studimit.</p> <p>Për sa më sipër, ju informojmë se nga verifikimi që u krye në arkivin e MAS nuk rezulton që SHLUIP "Universiteti Kristal" të ketë dorëzuar në MAS dosjen e Znj Cepele.</p> <p>Megjithatë sugjerojmë që t'i drejtoheni Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave për një informacion më të plotë.</p>	Përfunduar	Jo
293	16.12.2024	<p>Në rubrikën "Aplikim për provimin e shtetit" rezulton "Nuk ka sezon aktiv". Si mund te aplikojme ?</p>	18.12.2024	Deleguar për trajtim QSHA-së.	Përfunduar	Jo
294	16.12.2024	<p>Ne kuader te aplikimit per provimin e shtetit Dega Fizioterapi doja tju pyesja nese ne mungese te diplomes e cila akoma nuk esht leshuar nga institucioni Arsimor a mund te bashkangjisim vertetim diplome te noterizuar</p>	18.12.2024	Deleguar për trajtim QSHA-së.	Përfunduar	Jo
295	16.12.2024	<p>Kerkoj ne rruge elektronike informacion per vendndodhjen e institucioneve arsimore (per te gjitha kategorite) sipas dokumentit elektronik bashkengjitur.</p>	08.01.2025	<p>Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se adresat e institucioneve të arsimit të lartë janë publike në faqet zyrtare ëeb të këtyre institucioneve dhe në faqen e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) https://ëëë.ascal.al/sq/lista-e-ial</p>	Përfunduar	Jo
296	16.12.2024	<p>Kam mbaruar gjimnazin tek Naim Frasheri Durrës në vitin 2016 dhe kam studiuar 2 vite në "Fakultetin e Studimeve Profesionale" në degën asistent ligjor viti 2017-2019 Durrës.</p> <p>Jetoj ne Itali dhe doja të bëja njohjen e dëftesës së pjekurisë dhe diplomës së shkollës së lartë.</p> <p>I kam noterizuar të gjitha dokumentat por me mungonin vetëm pulla apostile dhe vula e ambasades Italiane që të më njihen ketu.</p> <p>Në mungesë të këtyre vulave më kërkuan një email të juajin që të verifikojnë që këto diploma nuk janë fallso.</p>	14.01.2025	<p>Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije si më poshtë:</p> <p>Për legalizimin (vertetimin) e dokumentit të përfundimit të arsimit të mesëm sipas urdhrin nr. 16, datë 11.01.2018 "Për legalizimin e dokumenteve të shkollimit parauniversitar", duhet të përcillni dokumentin pranë zyrës vendore arsimore (ZVAP) përkatëse. Dokumentet në vijim përcillen me postë nga ZVAP, në Qendrën e Shërbimeve Arsimore. Legalizimi kryhet brenda 15 ditëve nga data e protokollimit në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.</p> <p>Ndërkohë lidhur me diplomën për programin 2 vjeçar me karakter profesional për të verifikuar autenticitetin e kësaj diplome duhet t'i drejtoheni institucionit të arsimit të lartë që e ka lëshuar diplomën.</p> <p>Gjithashtu në vijim bazuar në vendimin nr.134, datë 7.3.2003 të Këshilit të Ministrave "Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit", të ndryshuar, për pajisjen e dokumenteve me vulë apostile duhet t'i drejtoheni Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.</p>	Pwrfunduar	Jo
297	17.12.2024	<p>Kam qene studente e Universitetit Nderkombetar te Tiranës por universiteti u mbyll . Kam ber dy vite te Universiteti Nderkombetar . Dhe ate kohe un ika ne Amerike . Tani jetoj ne Neë York dhe Ministria ktu deshiron qe ju ta kontaktoni per ti dorzuar kreditet e mia origjinale te atyre dy viteve qe kam bere te Nderkombetari</p>	30.12.2024	<p>Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk disponon të dhënat që ju kërkoni. Lidhur me regjistrat e notave të programeve të ofruara nga ish-Institucioni privat "Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës" duhet t'i drejtoheni Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (DPA).</p>	Përfunduar	Jo

298	17.12.2024	Jam e interesuar per dicka dua te vazhdoj universitetin te ufo per dentiste mund te me thoni sa vite esht sa lek esht sa esht mesatarja qe mund t futem edhe vitin e 2,3 e kam ber ne greqi a ka naj problem dhe cfare lendesh bejn edhe cfare duhet t marr nga shkolla.ku jam per.tu regjistruar dhe kur esht afati i	30.12.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë kryhen sipas udhëzimit nr. 12, datë 30.6.2023 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, të cilin e gjeni të publikuar në linkun https://ëëë.qbz.gov.al/previeë/184dd31d-d357-4585-a33b-7002e2b8d22f/cons/20241015 Kalendari i procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë miratohet çdo vit akademik me urdhër të përbashkët të Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqipar (RASH) dhe publikohet në faqe zyrtare të këtyre institucioneve. Lidhur me informacionet e tjera që lidhen me tarifën e studimeve duhet t’i drejtoheni institucioni të arsimit të lartë përkatës.	Përfunduar	Jo
299	17.12.2024	Ju lutem mund te me vini ne dispozicion Udhëzimi nr.5, datë 18.02.2009 “Për përmbajtjen dhe formën e diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë si dhe udhëzimin 585/30.01.2007 mbi përmbajtjen dhe formën e diplomes	31.12.2024	Në vijim të kërkesës suaj me anë të së cilës kërkonti të pajiseni me udhëzimin nr. 5 date 18.2.2009 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës “Për përmbajtjen dhe formën e dipomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë” ju përcjellim një kopje të skanuar të këtij udhëzimi. Lidhur me dokumenten tjetër të cituar “udhëzimi 583/30.01.2007” bazuar në referencat e dhëna ky dokumentacion nuk rezulton të jetë në arkivin e MAS për vitin arkivor 2007.	Përfunduar	Jo
300	17.12.2024	Kërkoj të më vihet në dispozicion informacioni sa më poshtë: Sa ka qenë numri i studentëve të regjistruar në Universitetin Luigj Gurakuqi, në bazë vjetore për 8 vitet e fundit? Sa ka qenë numri i studentëve të diplomuar nga Universitetin Luigj Gurakuqi, në bazë vjetore për 8 vitet e fundit? Sa degë aktive ka gjithsej universiteti dhe a është mbyllur ndonjë prej tyre në 10 vitet e fundit? A janë hapur degë të tjera në të njëjtin afat kohor? Sa është numri i studentëve të regjistruar ndër vite në degën e gazetarisë pranë Universitetit Luigj Gurakuqi, për çdo vit, për 10 vitet e fundit? Sa është numri i studentëve të diplomuar ndër vite në degën e gazetarisë pranë Universitetit Luigj Gurakuqi, për çdo vit, për 10 vitet e fundit?Sa është numri aktual i studentëve në degën e gazetarisë?	15.01.2025	Në vijim të kërkesës suaj të përcjellë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, lutem mbi të dhënat e kërkuara drejtoheni Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.	Pwrfunduar	Jo
301	18.12.2024	Me duhet te bej njohjen e diplomes se universitetit qe kam bere ne Shqiperi per t'u regjistruar ne urdhrin e arkitektit te Milanos. Kam arritur te bej Dichiarazione di Valore ne ambasaden italiane ne shqiperi por me kane njoftuar qe duhet ti drejtohem Ministrise per te marre miratimin dhe vulat e nevojshme per konvertimin e plote te diplomes dhe njohjen e saj per shtetin italian. Do t'ju lutesha te me orientonit se cfare hapash duhet te ndjek ose kujt mund t'i drejtohem.	30.12.2024	Në vijim të kërkesës suaj ju lutem specifikoni dokumentacionin që kërkonti apo dokumentacionin për të cilin kërkonti të pajiseni me vulë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Gjithashtu ju bëjmë se dije se për të konfirmuar/verifikuar autenticitetin e diplomës për programet e studimit të arsimit të lartë, duhet t’i drejtoheni institucionit të arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën.	Përfunduar	Jo

302	19.12.2024	A ka dalë njoftimi për programin e bursave stipendium hungaricum? Nese po, me jepni linkun.	30.12.2024	<p>Informacionin e plotë lidhur me programin e bursave shtetërore “Stipendium Hungaricum” të ofruara nga Qeveria e Hungarisë, përmes Fondacionit Publik Tempus (Tempus Public Foundation) në kuadër të bashkëpunimit me Hungarinë në fushën e arsimit dhe shkencës, për shtetasit e huaj të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet pranë universiteteve publike të Hungarisë, për vitin akademik 2025-2026, mund ta gjeni në faqen ëeb të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ëëë.arsimi.gov.al në menu-në: Program/Bursa dhe programe studimi (https://arsimi.gov.al/bursa-dhe-programe-studimi/).</p> <p>Afati i fundit i aplikimit online në faqen ëeb të Fondacionit Publik Tempus për këto bursa studimi është data 15 janar 2025 ora 14:00 (Ora e Evropës Qendrore), https://ëëë.apply.stipendiumhungaricum.hu.</p> <p>Gjithashtu, duhet të dërgoni detyrimisht nëpërmjet postës në adresë të Drejtorisë së Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit deri në datën 15 janar 2025 (afati i fundit i postimit) të gjithë dokumentet e ngarkuara në sistemin online sipas kriterëve të përcaktuara nga Fondacioni Publik Tempus.</p> <p>Lutemi për çdo paqartësi lidhur me aplikimin dhe për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit për bursat e ofruara nga qeveria hungareze, referojuni me vëmendje materialeve informues të publikuara ëëbsite si më poshtë: ëëë.stipendiumhungaricum.hu https://stipendiumhungaricum.hu/study-finder/ https://stipendiumhungaricum.hu/apply/ https://stipendiumhungaricum.hu/about/</p>	Përfunduar	Jo
303	20.12.2024	Bazuar ne ligjin për të drejten e informimit publik, deshirojme te kemi nje ze perfaqesues nga Ministria Arsimit ne lidhje me interpretimin e ketyre te dhenave apo edhe politikat e Ministrise se Arsimit per ta reduktuar kete fenomen ne vijim.	31.12.2024	<p>Në vijim të kërkesës suaj të përcjellë në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit ju bëjmë me dije se: Bazuar në pikën 1, të nenit 11 ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, parashikohet se “Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij”. Sa më sipër, në vijim të përcjelljes nga ana juaj të kërkesës për informacion, Ministria e Arsimit dhe Sportit është e gatshme t’u vendosë në dispozicion informacionin e kërkuar bazuar në parashikimet e ligjit nr. 119/2014, të ndryshuar.</p>	Përfunduar	Jo
304	20.12.2024	Jam nje nxenes ne gjimanz ne republiken e shqiperise dhe dua te hedh kartat per universitet jashte shtetit cfare duhet te ndjek qe ti bej.	30.12.2024	<p>Në vijim të kërkesës suaj ju lutem qartësoni informacionin që kërkonti t’u vihet në dispozicion nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Lidhur me kriteret, dokumentacionin dhe procedurat që duhen ndjekur për të vazhduar studimet jashtë vendit duhet t’i drejtoheni institucionit të arsimit të lartë ku do të aplikoni.</p>	Përfunduar	Jo
305	20.12.2024	Jam nji ish student i universitetit të medikomit të cilët është mbyllur dhe jetoj në Hungari dhe jam në procesin e njohjes së diplomës këtu po me kanë kërkuar orët e praktikës . Ju si ministri keni ndonjë informacion se ku duhet të pyes un për t’i mar si dokument orët e praktikës.	23.12.2024	<p>Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se është e paqartë cilat orë praktike kërkonti t’u vihen në dispozicion, por nëse kërkonti t’u vihet në dispozicion plani mësimor i programit që keni ndjekur (pjesë e të cilit mund të jenë edhe orët e praktikës), duhet t’i drejtoheni Ministrisë të Arsimit dhe Sportit me kërkesë me shkrim të përcjellë në rrugë zyrtare.</p>	Përfunduar	Jo

306	21.12.2024	Djali im ka qënë student në universitetin ëisdom, ku ka përfunduar bachelorin,por nuk e mbrojti diplomën. Nga informacionet që mora,më thanë,se lista e notave është në Ministrin tuaj. Si mund të më ndihmoni për ta marrë ju lutem?	31.12.2024	<p>Në lidhje me rastin e përcjellë në adresën e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit sqarojmë si më poshtë vijon: Në zbatim të shkronjës “b” të pikës 2, të vendimit nr. 588, datë 25.09.2024 të Këshillit të Ministrave, “Për mbylljen e veprimtarisë së Kolegjit Universitar “ëisdom””, përcaktohet se Kolegji Universitar “ëisdom”, ka detyrimin e përgatitjes së dosjes për çdo student që nuk ka përfunduar programin përkatës të studimit, me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit të lartë, që plotëson kriteret ligjore për transferimin e studimeve dhe t’ia vërë atë në dispozicion vetë studentit, pa asnjë detyrim financiar shtesë nga ana e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit nr. 588, datë 25.9.2024, të Këshillit të Ministrave (botuar në Fletoren Zyrtare në datë 26.09.2024).</p> <p>Kolegji Universitar “ëisdom”, ka njoftuar të gjithë studentët të cilët kanë qenë të regjistruar në programe studimi pranë këtij institucioni, për tërheqjen e dokumentacionit të tyre për transferim nga data 14.10.2024 - 26.10.2024.</p> <p>Sa më sipër, në lidhje me kërkesën tuaj, sqarojmë se sipas procesverbalit nr. 9369/1 prot., datë 06.12.2024 është finalizuar dorëzimi i 19 regjistrave themeltar të Kolegjit Universitar “ëisdom” pranë Arkivit Qendror Shtetëror dhe për rrjedhojë kërkesa juaj nuk mund të shqyrtohet nga ana e MAS, për sa kohë nga ana e ish -Kolegjit Universitar “ëisdom” ka pasur një afat për tërheqjen e dokumentacionit nga ana e studentëve që vijonin studimet pranë tij.</p>	Përfunduar	Jo
307	23.12.2024	Persa i perket njehsimit te diplomes se huaj , une kam bere aplikim para 2 muajsh ,mirepo kam kaluar afatin 1 mujor te plotesimit te dokumentave pas emailit tuaj,pasi diploma nuk ishte e apostiluar. Dokumentat i kam te skanuara nga aplikimi i pare per te bere perseri aplikimin ne e-albania. Fizikisht i kam derguar prane jush me poste. Mundet qe me poste te nis vetem dokumentin qe mungon nga dorezimi i pare,pasi pjesa tjeter eshte tek ju?	26.12.2024	Deleguar për trajtim QSHA-së.	Përfunduar	Jo
308	30.12.2024	Cilat janë rastet e evidentuara të përdorimit të armëve dhe drogave në shkolla (9 vjeçare dhe gjimnaze) gjatë 5 viteve të fundit, të ndara sipas qarqeve, shkollave dhe moshës së të miturve të përfshirë?Sa oficer sigurie ka aktualisht në gjimnazet dhe shkollat 9 vjeçare në Shqipëri, dhe në cilat shkolla janë? Cilat janë gjimnazet dhe shkollat 9 vjeçare në Shqipëri të cilat nuk janë të paisura me oficer sigurie dhe pse? Në cilat shkolla funksionon aktualisht projekti “Shkolla qendër komunitare” dhe projekti “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, po tek të tjerat pse nuk funksionon? A ka projekte të tjera për angazhimin e nxënësve edhe pas orarit zyrtar mësimor? Sa psikolog dhe punonjës social ka aktualisht në gjimnazet dhe shkollat 9 vjeçare në Shqipëri, të ndara sipas shkollave? A ka shkolla të pa paisura me psikolog ose punonjës social dhe pse ka ndodhur kjo? Sa raste incidentesh me armë dhe drogë në shkolla janë parandaluar ose trajtuar në 5 vitet e fundit, sipas qarqeve dhe shkollave, nga oficerët e sigurisë ose psikologët/punonjësit social? Cilat janë procedurat dhe protokollet që ndjek institucioni arsimor pas evidentimit të një rasti të përdorimit të armëve apo drogave nga nxënësit në shkolla apo brenda perimetrit të sigurisë?Cilat kanë qenë arritjet konkrete përballë fenomeneve si përdorimi i drogave dhe armëve nga nxënësit në shkolla, pas implementimit të Paketës së Sigurisë në Shkolla? A ka vërë re Ministria e Arsimit dhe Sportit mungesa apo keqfunksionime/difekte në etapat të cilat duhet të garantojnë sigurinë në shkolla dhe cilat kanë qenë ato? Si mendohet të përmirësohen?	29.01.2025	<p>Institucionet e arsimit parauniversitar, qe kane sherbim te sigurise publike, përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, në zbatim të pikës 1, të vendimit nr. 433, datë 26.6.2024 “Për një ndryshim në vendimin nr. 600, datë 9.10.2018, të Këshillit të Ministrave,“Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në institucionet e arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, të ndryshuar, pika 1: “Miratimin e shërbimit të sigurisë publike në institucionet e arsimit parauniversitar të mesëm të lartë, që kanë jo më pak se 80 nxënës, dhe në institucionet e arsimit parauniversitar bazë, që kanë jo më pak se 600 nxënës”.</p> <p>Numri i institucioneve arsimore që kanë oficer sigurie është 240.</p> <p>Për vitin shkollor 2024-2025, nisma “Shkolla Qendër Komunitare” funksionon në 541 institucione arsimore sipas klubeve dhe fushave të përzgjedhura nga vet nxënësit. Ndërkohë që nxënësit janë të angazhuar dhe në Programin Kombëtar Jashtë Orarit Mësimor “ Art, Zeje, Sport” i cili po zbatohet në 200 institucione arsimore dhe pritet të zgjerohet dhe në 100 shkolla të tjera për vitin shkollor 2024-2025?</p> <p>Numri punonjësve të shërbimit psikosocial është 850 gjithsej për vitin shkollor 2024-2025, të cilët kanë në fokus ofrimin e një shërbimi i cili synon zhvillimin e potencialit akademik por në të njëjtën kohë dhe promovimin e zhvillimit mendor dhe fizik të nxënësve.</p> <p>Të gjitha institucionet arsimore në vend janë të mbuluara me punonjës të shërbimit psikosocial sipas numrit të nxënësve në mbulim.</p> <p>Procedurat dhe protokollet e ndjekura nga institucionet arsimore për raste të shkeljeve të kryera nga nxënësit konsistojnë në: Raportimin e monitorueshëm në drejtorinë e shkollës dhe strukturat përkatëse të sigurisë</p>		

309	30.12.2024	Sa është numri aktual i nxënësve që përfitojnë subvencionin e transportit për në shkollë në Republikën e Shqipërisë? Sa është buxheti i akorduar për këta nxënës për vitet akademike 2022-2023, 2023-2024 dhe 2024-2025? Sa është distanca minimale në kilometra që duhet të kalojë një nxënës për të përfituar nga ky subvencion? Sa është pagesa mujore e subvencioneve për nxënësit për transportin në ambientet shkollore?	30.01.2025	<p>Bazuar në Vendimin nr 119, datë 01.03.2023 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, pika 1. është përcaktuar përballimi nga fondet publike të shpenzimeve për transportin e:</p> <p>a) punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare publike (në vijim IAP publike), ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator, oficerë sigurie, punonjës të shërbimit psiko-social), që punojnë larg vendbanimit të përhershëm të tyre, jashtë qendrave urbane dhe kthehen brenda ditës në vendbanim, në distancën mbi 5 km deri në 50 km;</p> <p>b) nxënësve që ndjekin procesin mësimor në IAP-të publike të arsimit bazë ose kopshtet publike, që udhëtojnë nga vendbanimi i përhershëm në një vendbanim tjetër, mbi 2 km larg IAP-ve publike më të afërta (shkollë/kopsht);</p> <p>c) nxënësve që jetojnë në qendra rezidenciale, të krijuara me vendim të Këshillit të Ministrave, për grupe të nxënësve/fëmijëve/familjeve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë dhe që udhëtojnë mbi 2 km larg për të ndjekur mësimin në IAP-të publike më të afërta (shkollat e arsimit bazë ose kopshtet publike);</p> <p>ç) nxënësve të arsimit parauniversitar me aftësi të kufizuara, që gëzojnë statusin ligjor të invalidit, që nuk shikojnë, që nuk dëgjojnë, invalidit paraplegjik dhe invalidit tetraplegjik;</p> <p>d) nxënësve që ndjekin procesin mësimor në IAP-të publike, të arsimit të mesëm të lartë dhe të arsimit profesional, godinat e të cilave kanë dalë jashtë funksionit apo janë në rikonstruksion/rindërtim, vërtetuar me aktet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi dhe që udhëtojnë mbi 5 km për të ndjekur procesin mësimor larg vendbanimit të përhershëm;</p>	Përfunduar	Jo